ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 23 DHJETOR 2023 | NUMËR 264 | VITI VI I BOTIMIT | ÇMIMI 50 LEKË | WWW.EXLIBRIS.AL | EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL | BOTIM I ONUFRI SHPK

Përkthyesja e njohur nga shqipja në turqisht

Ece Dillioğlu:

GJITHÇKA BËJ ME GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPE NË TURQI E QUAJ SI NJË KTHIM NË VENDLINDJE

Bisedoi Andreas Dushi



Edipi mbret në Shqipëri

Nga Margaret Hasluck



Përmbledhja interesante e gjëegjëzave të incestit të zotit F. J. Norton në revistën "Folklor", mars 1942, më kujton katërvargëshin e mëposhtme në shqip:

Nina nina bir! / I biri i t'em bir! / I biri i s'em re! / S'ati vjehërr i ke le

Në përrallat popullore shqiptare ky katërvargësh i këndohet fëmijës së saj nga një grua ndërsa të dy vdesin nga dora e djalit të saj të madh, me të cilin është martuar pa e ditur. Në fakt është përfundimi i historisë së Edipit siç tregohet në Shqipëri.

Përktheu: Granit Zela

SHËNIME MBI LIBRAT

BOTA E AMAZONAVE NË PENËN E MIRA MEKSIT

Nga Eshref Ymeri (fq. 4)

Dashuria në penën e Mira Meksit është një e tillë ndjenjë e fuqishme që nuk kërkon asgjë në shkëmbim, që ekziston përkundër gjithçkaje tjetër, që është në gjendje të krijojë mrekullira dhe të dhurojë shpresë.

Përmbledhja me tregime/novela "Fajtori" të Besnik Mustafaj

MARRËZIA BALLKANIKE NË PËRMASAT E SAJ REALE DHE KOZMIKE

Nga Ballsor Hoxha (fq. 6)

...duhet pasur në mendje që këto novela, janë mjeshtëri e rrallë e teknikës postmoderne të trajtimit të psikologjisë, e me këtë të njerëzores së narratorit pjesëmarrës, edhe real dhe edhe fiksional, ndan një kozmosi të marrëzisë ballkanike, e shqiptare.

Në 80-vjetorin e rënies heroike

PAVDEKËSIA E ALI DEMIT

Nga Enver Kushi (fq. 8)

Libri i Luan Ramës "Pranvera dy hapa pranë" arrin të na japë Ali Demin e vërtetë, heroin me botë të madhe shpirtërore, njeriun që jetoi jo vetëm në rrethana të caktuara historike, por që përjetoi emocionalisht dhe shpirtërisht këto rrethana.

ARTI I RUAJTJES SË MASËS, ROMANI "NJË ENGJËLL VESHË ME FRAK" NGA STEFAN ÇAPALIKU

Dr. Belfjore Zifla (fq. 12)

Fjalë për letërsinë e Petro Çerkezit

RRITJA PREJ TEMËS DHE FORMËS

Nga Thanas Dino (fq. 11)

Takim me Viktor Eftimiun në kampin e të burgosurve politikë të Tërgu-Zhiut

Nga Kiril Ekonomu

Përktheu nga gjuha rumune Pandi Bello (fq. 23)

Më 1623 u botuan plot tridhjetë e gjashtë pjesë teatrale të Shekspirit, gjysma e tyre, për herë të parë

VITI 1623: NJË PËRMENDORE PËR SHEKSPIRIN



(fq. 20)

Nga Feride Papleka

BIBLIOTEKË

Xhevair Lleshi (fq. 13)
Ambasadori shëtitës

Roland Gjoza (fq. 14)
Të gjitha u thinjët ju dashnore të shirave

Odise Kote (fq. 16)
E diel Ballkani

Ylli Ajdini (fq. 17)
Hije dhe dritë

BOTIME TË REJA

"Bota shqiptare (e veçanta dhe universalja)", një kapërcim kontinental mbi hartat e ngushta etnike

Nga Emin Azemi (fq. 9)

Kujtim M. Shala: "Kënga e cjapit", studim mbi dramën klasike shqipe (fq. 7)

Shënime për ekspozitën e piktorit Bujar Luca

ANTROPOSEMIOTIKA E MORFOLOGJISË TË SË PADUKSHMES

Dr. Oltsen Gripshi (fq. 10)

Ece Dillioğlu

Gjithçka bëj me gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqipe në Turqi e quaj si një kthim në vendlindje

Bisedoi Andreas Dushi

A.D: Vitet e fundit, keni sjellë në turqisht dy prej shkrimtarëve më të njohur shqiptarë: Ismail Kadarenë dhe Mira Meksin. Nga pikëpamja dhe eksperienca juaj, ka lexuesi turk interes për letërsinë shqipe në përgjithësi, apo ka për autorë të veçantë? Pra ideja e Shqipërisë si vend, historia e tradita, kultura dhe letërsia krijon dot një gravitet që e tërheq publikun turk?

E.D: Lexuesit turq padyshim që janë të interesuar për letërsinë. Megjithatë, faktori "shkrimtar" ka filluar të dalë në pah në botën e globalizuar si një nga mjetet që e mbështet këtë. Sepse përtej rrëfimeve letrare, mediat e shkruara dhe rrjetet sociale nxjerrin në pah emrat e shkrimtarëve më shumë se sa rrëfimet letrare. Ndaj, nëse bëjmë një përgjithësim nga këndvështrimi i lexuesve turq bazuar në letërsinë shqipe, shohim se ata janë më të interesuar për emra të njohur si Ismail Kadare dhe Dritëro Agolli. Në këtë kontekst, duke parë këto rezultate kam dashur veçanërisht që lexuesi turk të takojë shkrimtarët e fuqishëm të letërsisë shqipe si Mira Meksi dhe Kim Mehmeti. Kështu, synova t'u jap lexuesve mundësinë për të bërë një krahasim duke parë shkrimtarë dhe këndvështrime të ndryshme në letërsinë shqipe. Parimi i parë këtu ka qenë që të sigurohemi që autorët t'i përcjellin ndjenjat dhe mendimet e tyre tek lexuesit në gjuhën e tyre amtare. Kështu, doja të thyeja disa tabu të keqkuptuara në Turqi dhe të rindërtoj lidhjet midis shoqërisë shqiptare dhe shoqërisë turke në një bazë më të fortë. Në shoqërinë turke, termi shqiptar nuk është aspak një fjalë e huaj. Është e mundur të gjesh pika të përbashkëta për kulturën dhe traditën shqiptare pothuajse në çdo cep të Turqisë. Po flasim për dy shoqëri të ndryshme në botë, ku asnjëra shoqëri nuk e përcakton veten si të huaj ndaj njëra tjetrës. Megjithëse origjina dhe gjuhët e tyre nuk kanë asnjë gjë të përbashkët, mund të themi se një lidhje e tillë vëllazërimi nuk ekziston në botë. Megjithatë, në Turqinë e sotme ka shumë dezinformata dhe keqkuptime për shoqërinë dhe kulturën shqiptare që mendohet se janë të vërteta. Natyrisht, kjo situatë ekziston edhe në perceptimin e turqve në shoqërinë shqiptare. Në këtë aspekt, edhe pse letërsia shqipe e takoi lexuesin turk shumë vonë me ndjenjat reale të përcjella nga gjuha e vet amtare besoj se do të krijojë një tërheqje më të shpejtë në të ardhmen shumë të afërt.

A.D: Thuhet shpesh se një përkthyes duhet që gjuhën pritëse ta ketë gjuhë amë. Për aq kohë sa ky pohim, në rastin tuaj, nuk qëndron, pasi gjuha juaj amë është shqipja, jo turqishja, si e shihni dhe përshkruani gjithë procesin e përkthimit?

E.D: Mendimi im për këtë temë është në të njëjtin drejtim. Kjo situatë është e vlefshme për sa i përket përcjelljes së ndjenjave dhe mendimeve një për një në përkthim. Megjithatë, situata ime është pak më ndryshe. Sepse edhe pse gjuha ime amtare është shqipja, në fakt e përshkruaj veten si dygjuhëshe (bilingual). Unë mund t'i kuptoj, interpretoj dhe transferoj lehtësisht ironitë, metaforat dhe veçanërisht diskurset e nënkuptuara që përmbajnë të dyja gjuhët. Në këtë pikë, ndonjëherë mund t'ia shpjegoj këtë lexuesit duke shkuar përtej përkthimit ose duke treguar guximin për të krijuar kushtet e nevojshme në përkthim. Prandaj i kushtoj rëndësi përkthimit të letërsisë shqipe në turqisht nga gjuha e saj amtare dhe e kryej punën time në këtë kontekst. Është e rëndësishme që qëllimet e mia të arrihen, aq më tepër që këto transferime ndjenjash dhe mendimesh duhet të jenë në formën e gjuhës amtare.

A.D: Disa vepra të Kadaresë, si për shembull *Pallati i ëndrrave* kanë një sfond të gjerë historik që përfshin gjithë Perandorinë Osmane. Mendoni se kjo shërben si një soj nxitjeje për lexuesit e atij vendi që pasoi këtë perandori, Turqisë së sotme?

E.D: Veprat e Ismail Kadaresë në përgjithësi tërheqin vëmendjen me pasurinë e tyre historike dhe kulturore. Mund të themi se shumë nga veprat e tij fokusohen në periudhën ose efektet e Perandorisë Osmane. Veçanërisht "Pallati i ëndrrave", ofron një vështrim të thellë në të kaluarën e gjerë historike dhe strukturën kulturore të perandorisë. Fundi i Perandorisë Osmane dhe periudhat pasuese të kësaj perandorie, kanë pasur një ndikim të thellë në Turqi dhe vende të tjera në rajon. Veprat e Kadaresë që përmbajnë temën e Perandorisë Osmane trajtojnë kompleksitetin, sfidat dhe ndryshimet e kësaj periudhe duke ofruar edhe një këndvështrim historik. Njëkohësisht këto vepra mendoj se mund t'u ofrojnë lexuesve mundësinë për t'u përballur me të kaluarën dhe për të kuptuar kohën e tyre brenda një konteksti historik. Një vepër ose një shkrimtar mund të jetë një burim inkurajimi për lexuesit e një vendi. Në këtë pikëpamje veprat e Kadaresë mund të nxisin përpjekjet për t'u përballur me të shkuarën, për të ringjallur kujtesën historike dhe për të kuptuar vështirësitë e shoqërisë në atë kohë. Mendoj se të kuptuarit se çfarë ndikimi patën periudhat e mëvonshme të Perandorisë Osmane në periudhën aktuale, ndonjëherë mund të jetë frymëzuese në trajtimin e sfidave aktuale. Megjithatë, mesazhet dhe efektet që do të marrë çdo lexues gjatë leximit të veprave të tilla mund të jenë personale dhe të ndryshme. Kështu që ndërsa këto vepra mund të jenë një burim inkurajimi për disa lexues, ato mund të ngjallin emocione dhe mendime të ndryshme për të tjerët. Prandaj e rëndësishme është të zbulosh pasurinë dhe thellësinë e veprave të tilla dhe të vlerësosh personalisht efektet e këtyre veprave tek individët.

A.D: Po në rastin e Meksit, fakti që një pjesë e ngjarjeve të romanit të saj *Kutia e Agatha Christe-s* a ka luajtur ndonjë rol në pritjen e tekstit prej lexuesit turk?

E.D: Duke qenë se libri sapo ka hyrë në procesin e botimit, nuk është e mundur të bëhet një përgjithësim bazuar në reagimet. Megjithatë, nëse bëjmë një vlerësim përsa i përket mendimeve dhe komenteve të disa lexuesve që e kanë lexuar romanin, kuptojmë se subjekti i romanit dhe heronjtë kanë krijuar emocion te lexuesi turk. Sidomos klasifikimi i Stambollit të vjetër dhe jetës përmes përshkrimeve të periudhës në Turqi është shumë i vlefshëm. Në të njëjtën kohë, vizitat burokratike të Mithad Beut në lidhje me shqiptarët e Çamërisë janë shumë tërheqëse. Këto shfaqen ndër komentet që vijnë në fillim të truallit që prek lexuesit që janë të interesuar për librin dhe kanë njohuri për migrimet shqiptare. Megjithatë, nuk kam asnjë dyshim se libri në përgjithësi, do të kuptohen në një dritë më ndriçuese pas një procesi më të gjatë leximi. Prandaj, ndonëse është shumë herët për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, mund të them se si përmbajtja ashtu edhe mesazhet e heronjve në kontekstin e identitetit të tyre kombëtar përcillen mjaft qartë në roman.

A.D: Sipas jush, a ka pikëtakime mes letërsisë shqipe dhe asaj turke, në të gjitha rrafshet, nga subjektet, deri tek format?

E.D: Letërsia shqipe dhe ajo turke i përkasin dy traditave letrare me kontekste të ndryshme kulturore dhe historike. Të dyja letërsitë kanë një trashëgimi të pasur dhe tema, stile dhe forma letrare të ndryshme.





Megjithatë, të dyja letërsitë herë pas here kanë trajtuar tema të ngjashme, kanë ndërvepruar dhe kanë ndarë disa elemente të përbashkëta. Ndryshimet në Ballkan dhe Anadoll pas Luftës së Parë Botërore, bën që tema të ngjashme të trajtohen në letërsinë shqipe dhe turke. Sidomos tema të tilla si betejat kombëtare, kërkimet për pavarësi dhe ndryshimet shoqërore janë trajtuar shpesh në të dyja letërsitë. Një tjetër pikë e rëndësishme e përbashkët është se ata kanë qenë nën ndikimin e Perandorisë Osmane. Gjatë periudhës osmane, shqiptarët dhe turqit kanë jetuar brenda kufijve të së njëjtës perandori. Kjo situatë ka mundësuar ndërveprime letrare dhe shkëmbime kulturore. Gjurmët e këtyre ndërveprimeve mund të gjenden në disa vepra letrare. Përveç kësaj, gjatë historisë, letërsia shqipe dhe ajo turke kanë jetuar në të njëjtin rajon gjeografik dhe kanë të njëjtën teksturë kulturore dhe historike. Kjo mund të tregojë ekzistencën e disa të përbashkëtave tematike dhe kulturore. Megjithatë, të dyja letërsitë kanë veçantinë e tyre dhe kanë zhvilluar një identitet letrar të veçantë. Prandaj, edhe pse ka ngjashmëri, letërsia shqipe dhe ajo turke kanë karakteristikat e tyre unike sepse kanë prejardhje, kultura dhe gjuhë të ndryshme.

A.D: Dua të kthehem sërish te romani i fundit i Meksit. Kur mora vesh lajmin për botimin në gjuhën turke, më erdhi në mendje një lloj deduksioni që mu duk i bukur dhe desha ta ndaja me ju e të dija mendimin tuaj për të. Në Palace Hotel zinin vend të gjitha delegacionet perëndimore në Turqi. Po në të njëjtin vend zhvillohet edhe një pjesë e ngjarjeve të romanit. Të jetë ky hotel, si të thuash, porta nëpër të cilën dikur kanë kaluar evropianët, edhe shqiptarët dhe tani, po nëpërmjet tij po kalon edhe letërsia evropiane, e si pjesë e saj edhe shqiptarja?

E.D: Po jam dakord me ty dhe ky koment mund të bëhet. Mund të them se Palace Hotel në romanin e Mira Meksit shërben si një portë apo urë simbolike. Sfondi historik i këtij hoteli mund të shihet si një vend ku letërsia evropiane dhe ajo shqiptare takohen në një terren të përbashkët, pasi është pikëtakimi i kulturave, njerëzve dhe letërsisë së ndryshme. Në fakt, e kaluara historike e hotelit, duke qenë pikëtakimi i evropianëve dhe shqiptarëve, dhe fakti që letërsia tani bashkohet në këtë vend, tregon se kulturat dhe letërsitë e ndryshme janë të lidhura me njëra tjetrën. Kjo situatë na tregon edhe një herë se letërsia nuk formohet vetëm nga kufijtë kombëtarë, por edhe nga ndërveprimi ndërkulturor. Prandaj, mendoj se është e mundur të interpretohet Palace Hotel në roman si një simbol që i kapërcen kufijtë e letërsisë, bashkon kultura të ndryshme dhe bashkon përvojat e shoqërive të ndryshme.

A.D: Po mirë, dua të dal pak nga ky kontekst i bisedës. Ndërkombëtarisht, e si rrjedhojë edhe në Shqipëri, shkrimtari më i njohur turk është Orhan Pamuk, edhe nobelist. Por ka shkrime, herëpashere që tregojnë se në fakt letërsia turke ka edhe shkrimtarë të tjerë? Ju si mendoni, me aq sa e njihni kontekstin e Shqipërisë, a njihet këtu aq sa duhet letërsia turke?

E.D: Po, padyshim, Orhan Pamuk është një nga shkrimtarët turq më të njohur ndërkombëtarisht. Megjithatë, letërsia turke nuk kufizohet vetëm në Orhan Pamuk-un. Letërsia turke ka një gamë të gjerë dhe në këtë traditë përfshihen shumë shkrimtarë, poetë dhe mendimtarë të njohur. Mendoj se në Shqipëri, nëse letërsia turke njihet gjerësisht, në përgjithësi varet nga numri i njerëzve të interesuar për letërsinë turke në atë rajon dhe nga sa gjerësisht promovohet kjo letërsi. Sipas meje shkrimet, përkthimet

dhe ngjarjet letrare për letërsinë turke në Shqipëri mund të kontribuojnë në promovimin dhe kuptimin e kësaj letërsie. Njohja dhe vlerësimi i letërsisë turke në kontekstin kulturor të Shqipërisë lidhet edhe me thellësinë e marrëdhënieve në kontekstin historik, kulturor dhe gjuhësor. Ndikimi i Perandorisë Osmane në Ballkan dhe marrëdhëniet historike në këtë gjeografi mund të kontribuojnë në kuptimin dhe vlerësimin e letërsisë turke në Shqipëri. Megjithatë, si në çdo vend, autorët apo veprat që janë më të njohura dhe periudhat që janë më të theksuara, janë përgjithësisht rezultat i qarqeve letrare dhe ndërveprimeve kulturore në atë vend.

A.D: Dhe në fund, romanet e Kadaresë janë përkthyer qysh herët në gjuhën turke. Duke parë ndryshimet dinamike që shoqëria dhe gjuha kanë pësuar dhe pësojnë, sa i nevojshëm është, sipas jush, ripërkthimi?

E.D: Unë e shikoj këtë çështje nga një këndvështrim tjetër për shkak të pyetjeve që kam hasur në jetën time akademike. Ismail Kadare është ndër të parët shkrimtarë shqiptarë që është përkthyer në turqisht. Megjithatë, siç e përmendët ju, ishte e pashmangshme që veprat e përkthyera të rishikoheshin pasi ato u përkthyen nga gjuhët "ndërgjuhësor" në periudhën e hershme. Në këtë drejtim, në vend që të filloja me vepra që nuk janë përkthyer në turqisht, synova që të zbuloja vlerën e vërtetë të autorit si në kuptim, ashtu edhe në teknikë duke i përkthyer fillimisht nga gjuha amtare veprat e përkthyera më herët. Në fakt, si rezultat i rishikimit të veprave të tij pas periudhës komuniste nga Ismail Kadareja dhe ideja se përkthimet ndërgjuhësore në disa raste nuk mun të përcjellin ndjenjat dhe idetë siç janë prandaj duhet t›u prezantohen lexuesve turq në një mënyrë më të kuptueshme më shtyu në këtë rrugë. Kjo ishte e rëndësishme për mua për sa i përket përcjelljes së saktë të gjuhës sime amtare dhe kulturës së vendit tim. Së fundi, dua të shtoj këtë. Për mua, përkthimi i veprave të Ismail Kadaresë në turqisht është më shumë se një përkthim. Prandaj idealet e mia përfshijnë përkthimin e të gjitha romaneve të tij në turqisht dhe pjesëmarrjen në këto përkthime.

A.D: Ka shumë shqiptarë që jetojnë në botë, janë natyralizuar në profesione të ndryshme dhe japin kontributin e tyre në vendet ku banojnë. Ndërsa ju, si pjesë e kulturës turke, vendosët të krijoni ura komunikimi mes saj dhe Shqipërisë. Si ju lindi dëshira, cila qe nxitja për të filluar më së pari përkthimin?

E.D: Mund të them se kjo është një nga pyetjet që më bëjnë më shumë. Këtë mund ta shpjegoj kështu. Nga njëra anë është një shprehje e bukur në turqisht, "fati i ka thurur rrjetat e tij", nga ana tjetër është motivimi për të qenë një shqiptar i brezit të parë që jeton në diasporë dhe ka përballuar të gjitha vështirësitë e migrimit. Edhe pse nuk vlen për të gjithë shqiptarët që jetojnë në diasporë, pasuria kulturore e Turqisë e bën shumë të vështirë për një shqiptar të lindur këtu dhe brezat pasardhës që të mbajnë gjallë kulturën e tyre dhe të mësojnë gjuhën e tyre. Pretendohet se sot në Turqi jetojnë miliona njerëz me origjinë shqiptare. Megjithatë, shumica e tyre janë njerëz të brezit të dytë apo të tretë të lindur këtu dhe nuk dinë as shqip. Ka shumë çështje historike për t'u shpjeguar për këtë temë. Situata ime është formuar nga fakti që kam mësuar gjuhën time amtare dhe turqishten në mënyrë sinkrone dhe se kam përqafuar një kulturë tjetër në kontekstin e partneriteteve pa e braktisur kurrë kulturën time. Dihet se zakonisht emigrantët gjithmonë presin kthimin e tyre me një valixhe gati. Kthimi im në vendin tim është realizuar me përpjekjet që kam bërë sot në lidhje me gjuhën amtare, letërsinë dhe kulturën shqipe. Edhe pse nuk mund të kthehem në vendlindje, unë kam vazhduar t'i ujit rrënjët duke i vënë vajzës sime emrin e qytetit ku kam lindur dhe duke vazhduar të shërbej për letërsinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare herë me përkthime e herë me punimet akademike. Mendoj se ky motivim do të vazhdojë i pandërprerë për sa kohë që këto rrënjë të ujiten.

Jeta e përditshme, familja, angazhimet e tjera... I shihni si një ndihmesë, apo pengesë në punën tuaj si përkthyese?

E.D: Unë jam një nga ata që mendoj se çdo gjë që përjetojmë në jetë ka një arsye

(Vijon në faqen 5)





Bota e amazonave në penën e Mira Meksit

Nga Eshref Ymeri

Shkrimtarja dhe përkthyesja e shquar Mira Meksi, me krijimtarinë e vet artistike ka bërë për vete një masë mjaft të madhe lexuesish. Në panairin e librit që organizohet në Tiranë çdo vit në muajin nëntor, gjithmonë bie në sy rituali i mikritjes së lexuesve nga ana e kësaj shkrimtareje, të cilët, të vendosur në radhë të gjatë, presin të afrohen pranë banakut për të marrë një autograf prej saj për romanin e ri që ka hedhur në qarkullim Shtëpia botuese "Onufri".

Në panairin e vitit të kaluar (nëntor 2022), Mira Meksi i gëzoi adhuruesit e krijimtarisë së saj me romanin me titull *"Puthja e Amazonës"*, një titull ky fort joshës për të ndezur fantazinë e lexuesve.

Përgjithësisht, proza e Mira Meksit është shullëri ku lind, ngrohet, rritet dhe hedh shtat afshi i dashurisë, ku shpalosen skenat e flatrimit shpirtëror dhe të rrëzimit të heronjve të saj në humnerat e dëshpërimit prej tradhtisë ogurzezë. Mjafton t'i kthehemi përmbajtjes së veprave të tilla të kësaj shkrimtareje, si "Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë", "Hakmarrja e Kazanovës", "Kutia e Agatha Christie-s", romani në fjalë dhe romani më i fundit, që ajo prezantoi në panairin e librit të këtij viti *"Parisi vret"*, për të parë se si shpërthejnë tallazet dashurore të heronjve të tyre. Subjektin qendror të këtyre veprave e përbën konflikti dashuror, kurse tema e dashurisë pothuajse përherë shpaloset si një skenë vuajtjesh.

Le të sjellim në kujtesë gjendjen shpirtërore të heronjve të veprave të lartpërmëndura, të cilët vuajnë nga dashuria: vetëdija e tyre është zënë ngushtë, vëmendja është përqendruar te një njeri i vetëm, mendimet vërtiten rreth të njëjtave situata, duke nxitur kohë pas kohe shpërthime emocionesh të plagosura.

Gjendjen emocionale të Teutës, heroinës së këtij romani, në marrëdhëniet e saj me të dashurin e zemrës, Skerdin (me të cilin pati përfunduar studimet universitare në Paris, ajo për letërsi kurse ai për pikturë), mund ta krahasosh me një flutur që vërtitet rreth flakës dhe që përfundon e djegur në të, e më pas vendin e saj e zë një tjetër flutur po me të njëjtin fat.

Në botën e heronjve të Mira Meksit, dashuria gjithmonë përballet me vuajtjen. Kjo për arsye se vëmendja e të dashuruarit është e përqendruar te objekti i dashurisë që stimulon faktorin stresiv. Pra, për heronjtë e Mira Meksit, të dashurosh do të thotë të vuash. Por edhe të mos dashurosh është e pamundur. Vuajtjet dashurore janë një shpagim i pranueshëm për një fund të lumtur.

Rydiger Dalke (1951), specialist gjerman në fushën e psikoterapisë, thekson se mendimet, emocionet, përjetimet e të dashuruarve ndikojnë në gjendjen e tyre shpirtërore. Sipas tij, ai që i ka të pazhvilluara pikëmbështetjet e brendshme të qëndresës, që dallohet për paaftësinë e vlerësimit të vetvetes, që është mësuar të gjuajë kënaqësi të atypëratyshme, kalimtare, ka shumë mundësi që të bjerë pre e lëndimeve që i shkakton dashuria. Psikoterapia, thekson ai, është një **qasje për trajtimin e çështjeve të shëndetit mendor, për të cilat duhet biseduar me një psikolog.** Gjatë psikoterapisë, çdokush që është i interesuar, mëson për çështjet e veta specifike dhe se si mendimet, tronditjet dhe sjelljet ndikojnë në gjendjen e tij emocionale.

Kur shkrimtarja i përshkruan pranë e pranë Teutën dhe Skerdin, këta janë të pushtuar aq shumë nga afshi i dashurisë, saqë janë gati ta përpijnë njëri-tjetrin. Secili është nën pushtetin e ndjenjave të fuqishme. Por, siç u theksua më lart, dashuria në penën e Mira Meksit është e shoqëruar përherë me vuajtje. Pikërisht atëherë kur Teuta priste ta kishte Skerdin pranë, për t'ia lehtësuar peshën e rëndë që ndiente në zemër për shkak të kancerit të gjirit që do ta operonte në spital, ai e braktisi aq pabesisht. Prandaj, shpërthen shkrimtarja, *"në vend të ngrohtësisë së dashurisë dhe vrundujve të shpirtit, ndjeu zemërthyerjen dhe një braktisje njerëzore absurde më të rëndë se vdekja"*.

Mendimtari i lashtë romak, Plauti, qetësinë shpirtërore e vlerësonte si lehtësimin më të mirë gjatë një vuajtjeje dashurore. Pikërisht gjatë vuajtjeve të tilla është shumë i rëndësishëm drejtpeshimi shpirtëror, të cilin ai e vlerësonte si një tipar të rëndësishëm të karakterit të njeriut.

Ndarja e dhimbshme e Teutës nga Skerdi nuk ishte aq shkak për rëndimin e sëmundjes së saj, sesa ndjesi e tmerrshme e përballjes me vetveten, vetëm për vetëm. Megjithatë, njeriu, për nga natyra e vet, është i vetëmjaftueshëm, i vetëplotësuar. Por në qoftë se në shpirtin e tij, për shkak të një tradhtie dashurore, krijohet një humnerë e frikshme, atëherë duhet menduar se ka mundësi që ai jo gjithçka është në gjendje ta vlerësojë brenda vetvetes, se ndien boshllëqe në personalitetin e vet, të cilat mundohet t'i shmangë përmes dikujt tjetër. Prandaj prishja e marrëdhënieve, tradhtia në dashuri sigurisht që përbëjnë një shqetësim të madh, krijojnë një situatë kritike, por duhet pasur parasysh se energjia që çlirohet me këtë rast, në varësi të forcës së karakterit të njeriut, mund të sjellë si pasojë ose vetëshkatërrimin ose vetëpërsosjen e personalitetit të tij.

Kur në faqet e romanit, lexuesi njihet me qëndrimin aq të pabesë të Skerdit ndaj dashurisë së Teutës, i cili i shmanget jo vetëm takimit me të, por edhe tingujve të zilkës së telefonit, ai, domosdo, do të shtrojë pyetjen?

Si duhet vepruar që dashuria të çojë drejt lumturisë së çiftit dhe të shmangen vuajtjet?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, është e domosdoshme të dihet se cilët janë ata gurë të nënujshëm që shkaktojnë dhembje, të cilët njerëzit i hasin më shpesh në rrugën drejt ngritjes së strehës së shëndetshme të dashurisë që është në gjendje të përballojë çdolloj stuhie?

Ngatërrimi i nocionit *dashuri* me nocionin *pasion dashuror* përbën çorientimin më karakteristik, pre e të cilit bien jo vetëm të rinjtë, por edhe të rriturit. Shpeshherë flitet për mendime të çoroditura, për shqetësime nervore, për pagjumësi dhe mungesë oreksi, për budallallëqe krejtësisht absurde që vihen re në prani të personit që përjeton tronditje dashurore.

Në këtë koleksion përjetimesh të çuditshme dhe "argëtuese", mund të përfshihen ndjenja të një euforie të papritur, të prirjes për t'u bërë me krahë, shpërthime të frymëzimit dhe dëshira për të përmbysur male.

Të gjitha këto janë momente të bukura, të cilat, me të vërtetë, do të thonë shumë në jetë, por megjithatë ato nuk janë tregues të dashurisë. Ato, realisht, janë vetëm tregues të pasionit dashuror, i cili bazohet në të tjera reaksione kimike në trurin e njeriut. Dhe një situatë e tillë mund të mos përbënte asnjë shqetësim, por, fatkeqësisht, pasioni dashuror nuk vazhdon gjatë. Kjo për arsye se, së pari, organizmi nuk mund ta ndiejë veten normal në kushtet e një deficiti të përhershëm gjumi dhe ushqimi dhe, së dyti, është e pamundur të ruhet për një kohë të gjatë niveli i domosdoshëm i hormoneve.

Në kushte të tilla, pasioni dashuror vjen e shuhet gradualisht dhe me kalimin e një kohe të caktuar, zhduket përfundimisht.

Pikërisht jo dashuria, por pasioni dashuror ishte ai që zbuloi pabesinë flagrante të Skerdit ndaj dashurisë së pastër të Teutës, të cilën e braktisi atëherë kur ajo nuk e priste kurrë. Sëmundja e Teutës shërbeu si "letër lakmusi" për dashurinë e rreme të Skerdit.

Me pabesinë e Skerdit në qëndrimin ndaj dashurisë së çiltër të Teutës, Mira Meksi ka stigmatizuar të tillë meshkuj pa karakter, për të cilët *Fransua Tryfo (François Roland Truffaut - 1932-1984)*, regjisor, skenarist, producent, aktor francez, kritik filmash, thotë:

"Në dashuri femrat janë profesioniste, kurse meshkujt janë amatorë".

Gjatë përjetimit prej dikujt të pasionit dashuror shfaqen nostalgjia, keqardhja, dhembja dhe akuza e vetvetes për të gjitha mëkatet. Por a mund të mendohet që ai ka pasë kaluar nëpër shtigjet e një ndjenje të pastër dashurie, si në rastin e Skerdit? Sigurisht që jo, sepse ndjenjat e tij kanë çarë jo shtigjet e dashurisë, por shtigjet e pasionit dashuror, i cili s'është gjë tjetër, veçse një vrundull ere në një fushë të hapur, që ndërron drejtim aty për aty.

Pra, që marrëdhëniet e një çifti të çojnë drejt lumturisë së tyre, duhet bërë dallimi prerazi mes dashurisë dhe pasionit fluturak.

Teuta, si heroinë e romanit, mbart me vete çelësin, me të cilin shkrimtarja Mira Meksi hap portën e mistereve të amazonave. Gjatë një skene romantike, Skerdi, i përhumbur nga afshi dashuror, kur po zbulonte magjinë e gjinjve të Teutës, vëren një tatuazh në zverk apo në prapaqafën e saj. Kërshëria e nxiti për të mësuar nga Teuta "historikun e gdhendjes" së atij tatuazhi. Para se të niste rrëfimin, Teuta i tregoi varësen që e kishte vendosur mbi komodinë. Pikërisht ajo varëse lidhej me tatuazhin.

Gjatë viteve studentore, së bashku me një shoqen e saj spanjolle, Teuta kishte shkuar në Spanjë, nga e cila ruante mbresa të pashlyeshme për Toledon, një qytet i vogël ky që shtrihet në pjesën qendrore të vendit, i njohur si kryeqytet i provincës Toledo dhe i bashkësisë autonome *Kastila-La-Mança (Castilla-La Mancha).*

Në njërën nga ato ditë të qëndrimit në Toledo, Teuta, tek po ecte pa e ditur as vetë se për ku, fare rastësisht u ndodh ballë për ballë me një të panjohur, i cili. iu prezantua me emrin Jorgos Theotokopoulos, me prejardhje greke, i cili mbante mbiemrin e piktorit, skulptorit dhe arkitektit po me prejardhje greke *El Greko (El Greco 1541-1614),* njërit nga mjeshtërit më të mëdhenj të Rilindjes së vonë spanjolle. Prej vitit 1567 deri në vitin 1577, ky personalitet i shquar i artit dhe i arkitekturës punoi në Venecia dhe në Romë. Paskëtaj ai u shpërngul në Toledo, ku punoi për 37 vjet, deri sa ndërroi jetë.

El Grekoja i ri i propozoi Teutës t'i bënte një tatuazh, ndërkohë që i mbetën sytë të varësja që ajo mbante në qafë. Pasi e këqyri mirë e mirë me syrin e një piktori të talentuar, Teutës iu shpreh i mahnitur për vlerat e jashtëzakonshme të asaj varëseje, e cila duhej të ishte mbi dymijëvjeçare. Domosdo që Teuta mbeti e shtangur aty për aty nga ato fjalë, sepse nuk dinte kurrgjë për lashtësinë e asaj varëseje. Mandejpiktori e këqyri varësen me monokël dhe gati mbeti pa mend nga personazhet e gdhendura në të, për të cilat Teuta nuk dinte asgjë. Dy personazhet e gdhendura ishin *Pentesilea* dhe *Akili,* - e sqaroi piktori. Atëherë Teuta i ra në të: ajo varëse ishte e trashëguar brez pas brezi që nga stërgjyshi deri te ëma e saj dhe fjala ishte për mbretëreshën e amazonave dhe heroin e lashtësisë greke.

Po kush ishin ato amazona dhe cila ishte e kaluara e tyre plot mistere dhe të panjohura?

Në historinë e kulturës botërore, amazonat njihen si një bashkësi e lashtë mitike, e përbërë nga gra-luftëtare. Ato hasen në mitologjinë e shumë popujve, përfshi grekët, romakët, skandinavët dhe popuj të tjerë të periudhës së lashtësisë.

Që në fillim lind pyetja: si është krijuar fjala *"amazonë"?* Mendohet se kjo fjalë e ka prejardhjen nga iranishtja *"ha-mazan"* që do të thotë *"luftëtare"*. Në qoftë se në shprehjen e greqishtes *"a mazos"* pjesëzën *"a"* do ta quajmë përforcuese, atëherë ajo, afërsisht, përkthehet *"gjinjplotë"*. Por është i përhapur edhe një variant tjetër, sipas të cilit shprehja *"a mazos"*, me pjesëzën mohuese *"a"*, do të thotë *"pa gjoks"*. Ka pasur mendime se amazonat e prisnin me thikë gjirin e djathtë, në mënyrë që ta përdornin më me lehtësi harkun për lëshimin e shigjetave. Në pikturat antike amazonat paraqiteshin gjithmonë me dy gjinj, herë-herë njëri gji ishte i mbuluar nga veshja.

Ekzistojnë edhe variante të tjera të prejardhjes së fjalës *"amazonë"*. Në gjuhët e Kaukazit Verior është ruajtur fjala *"maza"*, që do të thotë *"hënë"*, çka mund të shërbejë si jehonë e asaj kohe të lashtë, kur banorët e atij rajoni e himnizonin Hënën si perëndi të gjuetisë, e cila në Greqinë e lashtë quhej Artemida.

Në nderim të këtyre luftëtareve të mitologjisë kështu është quajtur njëri nga lumenjtë më të mëdhenj të botës në Amerikën Latine - Amazona, Dhe kjo nuk është e rastësishme. Lumin Amazona e pati zbuluar *konkuistadori (conquistador* - në spanjisht dhe në portugalisht do të thotë *pushtues* në shek. XV-XVI të territoreve të Botës së Re në epokën e kolonizimit të Amerikës) spanjoll *Françesko de Oreliani (Francisco de Orellana - 1505-1546),* i cili, i pari nga evropianët, e pati përshkuar në krejt gjatësinë e tij. Në verën e vitit 1542, grupi shoqërues i tij, si kalimtarë të parë, gjoja pati vënë re amazonat legjendare, me të cilat hyri në luftim. Sot mendohet se ato kanë qenë ose femra indiane të Amerikës së jugut, që luftonin përkrah meshkujve, ose thjesht indianë me flokë të gjatë, të cilët spanjollëve iu dukën si femra. *Françesko de Oreliani,* fillimisht, deshi ta quante lumin me emrin e vet, por pas asaj përplasjeje, ai vendosi që lumin ta quante *Amazona.*

Në njërin nga lundrimet e veta, Kristofor Kolombin (1451-1506) e patën njoftuar disa indianë për disa ishuj, në të cilët banonin vetëm gra. Ai pati dëshirë të kapte disa prej tyre, për t'ia çuar mbretëreshës spanjolle, por s'doli gjë: kur marinarët e Kolombit u munduan të zbrisnin në breg, ata i priti një turmë grash të tërbuara, të zbukuruara me pupla dhe të armatosura me harqe. Marinarët u tërhoqën dhe Kolombi vendosi që ata ishuj t'i quajë ishujt Virxhinia, domethënë "ishujt e virgjëreshave".

Mbi bazën e miteve dhe legjendave, këto gra-luftëtare qenë kthyer në simbol të pavarësisë, të forcës dhe të trimërisë. Ato kanë pasë tërhequr vëmendjen e breznive me aftësitë e veta fizike dhe luftarake, si edhe kanë pasë personifikuar lirinë dhe barazinë. Shquheshin për përdorimin e harkut, të heshtës dhe të parzmores. Amazonat vazhdojnë të mbeten figura të tilla, të cilat ngallin interesimin e njerëzve dhe nxisin fantazinë e tyre. Kësisoj ato vlerësohen si një nga elementet e rëndësishme të kulturës dhe të historisë botërore.

Sipas mitologjisë greke, amazonat banonin nëpër pyje të virgjëra, në brigjet e lumit Termodont. Grekët e lashtë besonin se amazonat ishin pasardhëse të Aresit, perëndisë së luftës dhe të nimfës Harmonia. Mënyra e tyre e jetesës ishte e pazakontë: ato nuk vareshin nga meshkujt dhe jetonin në bashkësi femërore. Sipas një legjende, amazonat patën marrë pjesë në një betejë kundër heronjve të Akilit dhe te Herakliut. Tezeu, heroi i Athinës, pati rënë në dashuri me amazonën me emrin Hipolita.

Romakët i përshkruanin amazonat si luftëtare të egra dhe të panënshtrueshme, të cilat luftonin me trupin lakuriq. Disa historianë janë të mendimit se amazonat ishin një bashkësi që jetonte në brigjet veriore të Detit të Zi dhe ndërmerrnin operacione luftarake kundër legjioneve romake.

Në veprën me titull *"Historia"*, Herodoti (484-425 p.e.r.) thotë se kryeqyteti i amazonave ishte Themiskira, që ndodhej në jug të Detit të Zi (Turqia e sotme). Sipas një të dhëne tjetër, amazonat patën ardhur në Greqi nga Deti Azov. Prej andej ato patën nisur marshime ushtarake në gjithë hapësirat e Azisë së Vogël, duke arritur deri në Siri dhe Egjipt. Sipas legjendave, ato patën themeluar qytetet Efes, Smirna (Izmir), Sinop dhe Pathos. Diodor Siciliani (90-30 p.e.r.) ishte i mendimit se amazonat patën jetuar në brigjet e lumit Tanais (Doni i sotëm).

Sipas të gjitha legjendave, në bashkësinë e amazonave nuk kishte vend për meshkujt. Gjeografi i famshëm, Straboni (64 p.e.r.-24 e.r.), shkruante se amazonat, një herë në vit, ndërmerrnin sulme kundër pararendësve të kaukazianëve çeçenë me një qëllim tepër

specifik; të hynin në kontakte seksuale me ta për të mbetur shtatzana. Djemtë e lindur nga ky kontakt, në rastin më të mirë, ua kthenin etërve, në rastin më të keq - i vrisnin, kurse vajzat i mësonin të punonin në fushë, të merrëshin me gjueti dhe të luftonin.

Sipas një legjende, amazonat patën marrë pjesë në luftën e Trojës, në anën e trojanëve. Aty rrëfehet se si njëherë, gjatë gjuetisë, Ipolita, udhëheqësja e amazonave, qe vrarë rastësisht nga e motra, Penfesilea. E torturuar nga pendesa, udhëheqësja e re, pra, Penfesilea, vendosi të ndahej nga jeta ashtu siç i takonte një amazone të vërtetë, domethënë në luftim e sipër. Sulmi që ndërmori ajo kundër grekëve, në fillim qe i suksesshëm, por në luftim u fut Akili, i cili e rrëzoi Penfesilean nga kali dhe e shpoi me heshtë.

Temës së amazonave i kanë kushtuar veprat e veta shumë autorë të lashtësisë, si Hipokrati (470-356 p.e.r.), Lysiasi (459-380 p.e.r.), Palefati (shek. 3 p.e.r.), Straboni (68 p.e.r.-20 e.r.), Diodor Siciliani (90-30 p.e.r.), Pompei Trog (shek. I p.e.r.), Plutarku (50-125 e.r.) dhe të tjerë.

Rrëfenjat për amazonat kanë zënë vend si në letërsi, ashtu edhe në artet figurative. Vepra më e shquar që u kushtohet amazonave është eposi "Iliada" e Homerit. Në këtë vepër rrëfehet për betejën e grekëve me amazonat, të cilat i patën ardhur në ndihmë Trojës.

Amazonat patën frymëzuar shumë shkrimtarë dhe piktorë edhe të periudhave shumë të vona Ndër ta mund të përmendim *Herbert Xhorxh Uellsin (Herbert George Wells - 1866-1946),* shkrimtar dhe publicist anglez.

Tepër prekëse janë skenat që Mira Meksi përshkruan për tronditjen e thellë që po përjetonte kryeheroina e amazonave, Glaukia, tek po ndiqte me ankth skenën e dyluftimit të nënës së saj, Pentesileas, me Akilin. Pas vrasjes së Pentesileas, mbretëreshës së amazonave, Glaukia zuri këmbën e saj.

Ashtu si amazonat e Strabonit, edhe amazonat e Mira Meksit vazhdonin traditën e bujtëseve të dashurisë te bashkësia mashkullore që ndodhej në Kolkidë (në latinisht *Colchis*), një krahine historike kjo në bregun lindor të Detit të Zi).

Amazonat e moshës së re kishin shumë dëshirë të shkonin të shikonin kolkidasit. Por, sipas një rregulli kanonik, ato nuk mund të shikonin meshkuj para se të ndesheshin me ta në një betejë të vërtetë. Por mbretëresha e tyre, Glaukia, vendosi që të niseshin për në Kolkidë.

Pas një udhëtimi të gjatë, ato, të fshehura prapa një brezi pemësh, arritën t'i dallonin së largu kolkidasit, të cilët demonstronin forcën e muskujve dhe mundeshin me njëri-tjetrin. Udhëtimin e amazonave të reja, me Glaukian në krye, soditjen e skenave të dashurisë së kolkidasve me amazonat e tyre, shkrimtarja i përshkruan me tërë forcën e magjisë së fjalës artistike, me një figuracion mahnitës që të lë pa frymë me bukurin e stili të saj.

Si gjithmonë, Mira Meksi nuk ndahet dot nga magjia e dashurisë së heronjve të veprave të veta. Glaukia, gjatë kohës që bashkë me amazonat e reja po sodisnin kolkidasit së largu, mendjen ia pati tërbuar njëri prej tyre, Amorgesi, biri i vetëm i prijësit të tyre.

Në vlugun e përpëlitjeve të zemrës së saj për Amorgesin, Glaukia vendosi t'i hapej nimfës Cirena, sepse kishte humbur mendjen, kishte humbur tërësisht pushtetin mbi vetveten për dashurinë që ushqente ndaj tij. Nga Cirena Glauka mëson se dashuria është zjarr pëvëlimtar, ndaj e kështillon që ta djegë fitilin që po ia pëvëlon zemrën për Amorgesin.

Në njërën nga skenat e gjuetisë së amazonave, Glauka takon Amorgesin. Pas atij takimi, shkrimtarja e magjeps lexuesin me skenat e dashurisë së tyre, të cilat i ka skalitur aq mjeshtërisht, saqë lexuesi mbetet pa mend.

Glaukën shkrimtarja e vendos para një mëdyshjeje shpirtsfilitëse: të braktisë gjithçka dhe të martohet me Amorgesin, apo, mendjembledhur, të respektojë me vendsmëri "kushtetutën amazoniane": të mos shkelë betimin e amazonave, duke mbetur mbretëreshë e tyre.

Në kulmin e epsheve dashurore, të cilat kishin arritur në një gjendje "inkandeshente", "ia behu" tragjedia: Glaukia i preu fytin Amorgesit me një thikë dytehëshe, duke mbetur besnike e kanonit amazonian - ritualit të heqjes së gjirit të djathtë në bregun tjetër të Thermodonit.

Kur e mbarova leximin e këtij romani, më erdhi ndër mend *Kenet Berku (Kenneth Burke - 1897-1993),* shkrimtar, gazetar, filozof amerikan, studiues i letërsisë, teoricien i komunikimit, i cili thotë:

"Ngjarjet jetësore na përgtitin për jetën në një botë reale, duke na njohur me të tjerë njerëz, por, më kryesorja, për të na njohur me vetveten".

Shkrimtarja Mira Meksi e edukon, e mëson lexesin se si ta stërvitë veten me armën e mbijetesës dhe të optimizmit edhe në çastet e aksidenteve dashurore. Ajo krijon metafora për natyrën e njeriut, për ata njerëz që në letërsi quhen heronj. Ajo studion mjeshtërisht psikologjinë e personazheve të veta dhe nxjerr në spikamë dëshirat, pikësynimet dhe pasionet e tyre, të mbrujtura me apo pa vetëdije, të cilat i nxisin për të vepruar. Me shtegtimet e veta në botën e personazheve, dëshirat e tyre përvëluese ajo i flak në prushin e konflikteve të papritura. Skenat zëvendësojnë njëra-tjetrën, stili rrëfimtar i shkrimtares i përcjell lexuesit veprimet dhe reagimet e personazheve ndaj njëri-tjetrit, të cilat ndërthuren, pleksen në pika kthese kur dialogu mes tyre shoqërohet me shpërthime ndjenjash të harbuara.

Dashuria në penën e Mira Meksit është një e tillë ndjenjë e fuqishme që nuk kërkon asgjë në shkëmbim, që ekziston përkundër gjithçkaje tjetër, që është në gjendje të krijojë mrekullira dhe të dhurojë shpresë. Por duhet pasur parasysh edhe diçka tjetër që nënvizon *Frojdi (Sigmund Freud - 1856-1939):*

"Ne nuk jemi kurrë aq të dobët, sa kur dashurojmë, dhe kurrë aq të palumtur e pa shpresë, sesa kur humbasim objektin e dashurisë".

Në këtë roman, Mira Meksi përmend një mori emrash të vendeve, të maleve, të lumenjve, të perëndive apo të personazheve legjendarë, çka lexuesit mund t'i interesojë etimologjia e tyre.

Hulumtuesi i njohur i arkivave franceze, Aurenc Bebja, ka zbuluar veprën me titull *"Une race oubliée; les Pélasges et leurs descendants (Një racë e harruar; Pellazgët dhe pasardhësit e tyre")* të autorit francez Edouard Schneider (1880-1960), në të cilën theksohet se emrat e zotave, e perëndive, e heronjve shpjegohen vetëm me gjuhën shqipe. Këtë informacion shkencor ai e ka botuar në internet, me titullin *"Kur Edouard Schneider i dedikonte vajzës së tij librin "Pellazgët": Mos harro kurrë gjakun tënd shqiptar".* Faqja e internetit e gazetës *"Dita".* 14 janar 2018). Po këtë informacion e ka botuar edhe Sefedin Krasniqi *("Emra perëndish greke që shpjegohen vetëm në shqip, ja pse".* Faqja e internetit *"Albspirit".* 16 maj 2016).

Të njëjtin informacion ka dhënë edhe një tjetër autor francez - *Luis Benloew* (1818-1900), dekan i fakultetit te letrave ne Paris. Në vitin 1877 ai pati botuar veprën me titull *"La Grèce avant les Grecs" (Greqia përpara ardhjes së grekëve),* ku shkruan:

"Shumë emra të vendeve, të maleve, të lumenjve, të personazheve legjendarë nuk mund të shpjegohen me etimologjinë greke. Vetëm një gjuhë ka qenë në gjendje të hedhë dritë mbi emrat e këtyre vendeve, e kjo gjuhë është shqipja".

Nuk mund të lihen pa përmendur vlerat e jashtëzakonshme të pasurisë leksikore të këtij romani. Përgjithësisht, proza artistike e Mira Meksit është një thesar i vërtetë, është një "minierë ari" për pasurimin e leksikut të gjuhës shqipe. Me këtë rast, dëshiroj të nëvizoj si më poshtë:

Së pari, shkrimtarja ka krijuar mjaft fjalë të reja, ndër të cilat mund të përmendim: arturinë, çukërmoj, djegurishtë, ëmbëlan, hënëzim, festare, hollërinë, i dielltë, i gurëzuar, leximtar, lëbardhë, ndërmendazi, përcikje, prushëtoj, riak (riake), rozak, vajzuke.

Së dyti, duke "i çiftuar" fjalët, ajo krijon kompozita fort të qëlluara: dritëvakët, dhomëgjumë, fatgremisur, fatpërgjues, fundbark, gurërëndë, guximdhënës, mespërmeskafka, pasdashuri, pasfurtunë, perëndimdiell, pllakëvarr, qepenmbyllur, tymtrashë, zemërthyerje, vrasjendërgjegje.

Së treti, mjeshtërinë e shkrimësisë e ka pasuruar me mjaft metafora dhe figuracione artistike: dritat ulëritëse të reklamave përloteshin të verbuara, dergjej në një lëmsh kohe, e kishte varur shpirtin në buzën e tij, greminat e kohës, mendja iu robëruar, kishin rrjedhur shumë ujëra kohe, i mend zjarrin, nuk i ka frerët e vetes në dorë, zgjedha e dashurisë, i zi si vdekja, rrëke që thernin tokën, hëna kishte hedhur grushte me dritë melankolike, një shigjetë zjarri theri qiellin, për të mos u rrëzuar greminave të frikës, si lulja e potisur nga vlaga e dashurisë, muzgu po vinte hapvogël, bisha e dashurisë, lëngata e dashurisë, greminat e kënaqësisë, mademet e çmuara të trupit, rrjeta ogurzezë e dashurisë, i potisur me ujë petalesh trëndafili, ra përnjëherë në krahët e Morfeut, u krodh dëndësive të gjumit si në një det paqeje, ngjante si një perëndi e dashurisë, e ndjeu veten robinë të ndjenjës, dielli ngjitej me përtesë të madhe kupës qiellore, pushimet çlodhëse të pasdashurisë, ankthet e liga i kafshuan zemrën, shtiza e zjarrtë e vrasjendërgjegjes, kur dashuria nuk vdes, vret; porta e buzëve të burbuqta.

Së katërti, përveç sinonimeve leksikore, autorja ka përdorur edhe një tjetër lloj sinonimi - sinonimin metaforik. Kështu, gjatë përshkrimit të skenave dashurore përvëluese të Teutës me Skerdin, në vend të fjalës *gjinj* ajo përdor sinonimin mjaft të goditur *"porta e dashurisë".*

Krijimtaria artistike e Mira Meksit zë një vend të nderuar në kulturën tonë mbarëkombëtare. Veprat e saj janë përkthyer në disa gjuhë të huaja. Edhe në Panairin e këtij viti ajo u nderua si shkrimtarja më e mirë për romanin me titull *"Parisi vret".*

Kaliforni, 17 dhjetor 2023

(Vijon nga faqja 3)

dhe se çdo gjë është e lidhur me njëra tjetrën. Unë mund të ndryshoj rendin e gjithçkaje në jetë, përveç familjes time. Por familja është gjithmonë në radhë të parë për mua. Para se të filloja karrierën time si përkthyese, kam qenë dhe jam akademik. Mendoj se nëse nuk do të kisha detyrimet e mia, nuk do të kisha identitet akademik dhe nëse nuk do të kisha identitet akademik, nuk do të kisha statusin si përktyese. Ndaj mendoj se jo, jeta e përditshme, familja dhe detyrimet nuk janë pengesë për mua si përkthyese, ato kanë qenë gjithmonë mbështetëse. Mendoj se do të jetë gjithmonë kështu për sa kohë që këndvështrimi im për jetën të jetë i tillë. Përderisa po flasim nga jeta dhe familja në këtë pikë dua të falënderoj bashkëshortin tim. Sepse ai ka qenë gjithmonë një forcë që më ka shtyrë një hap përpara në të gjitha këto procese që përmenda. Mbështetja, mendimet dhe idetë e tij kanë luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në jetën time. Për këtë arsye dhe me këtë rast dua ta falënderoj shumë.

A.D: E gjeni Shqipërinë e kujtimeve të fëmijërisë tuaj në veprat që përktheni? E shihni procesin e përkthimit edhe si një lloj çmalljeje me vendin amë?

E.D: Faleminderit shumë, Andreas, veçanërisht që më bëre këtë pyetje. Sepse përgjigja e kësaj pyetje mbulon një fushë shumë të gjerë për mua, por nëse më duhej ta përmbledhja, mund ta them kështu. Unë erdha në Turqi në moshë të re dhe prandaj fillova shkollimin këtu. Kuptohet që në këtë edukim nuk përfshihej letërsia apo kultura shqiptare. Angazhimi im me këtë fushë ka nisur që në vitet e universitetit. Këtu u njoha edhe me Ismail Kadarenë. Tezën e magjistraturës e kam bërë për letërsinë shqipe, jetën dhe romanet e Ismail Kadaresë. Për mua përgjigja e pyetjes së parë është qartësisht romani "Kroikë në gur". Ndërsa lexoja dhe përkthejja atë roman, isha ai fëmijë që endej rrugëve të Gjirokastrës, gratë fqinje që shkonin tek njëra-tjetra ishin tezet dhe të afërmit e mi që lashë pas. Fëmijët që vraponin nëpër rrugë dhe ngjiteshin në çatitë e shtëpive ishin shoqet dhe shokët e mi. Babai, nëna dhe gjyshja që i përshkruan Ismail Kadareja në shtëpinë e tij ishin të gjithë familja ime, ose ndoshta jeta që do të kisha jetuar nëse do të kisha jetuar atje. Prandaj, po, unë e gjej Shqipërinë në kujtimet e mia, strukturën e familjes shqiptare, marrëdhëniet farefisnore, ndonjëherë edhe një muhabet qesharak në veprat që përkthej. Në këtë pikë, përkthimi i romaneve nga letërsia shqipe nuk është për mua vetëm një punë përkthimi, por bëhet një përpjekje për të transferuar kulturën e origjinës sime te dikush tjetër ose më sakt te lexuesi. Sepse dua që lexuesit të ndjejnë atë që ndjej unë. Unë nuk dua që ata të lexojnë një roman dhe ta hedhin mënjanë, dua që ata të ndjejnë kulturën e romanit që lexojnë. Më besoni, ndonjëherë ngatërrohem nëse procesi i përkthimit ma lehtëson mallin për atdheun apo më bën të më mungoj edhe më shumë.

A.D: Mendoni se Kadare është i keqkuptuar në arealin e kulturës turke dhe nëse po, ka qenë ky një fakt që ju ka nxitur ta përktheni? Po nga ana tjetër, a ka qenë një fakt që për arsye nga më të ndryshmet jua ka vështirësuar punën?

E.D: Para së gjithash, mendoj se për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje është e nevojshme të njihet dhe të analizohet shumë mirë shoqëria dhe kultura turke. Shkurtimisht, mund të them se turqit e shohin komunitetin shqiptar si më shumë se thjesht vëllezër. Siç e përmenda edhe më parë, fakti që këto dy shoqëri, të cilat nuk kanë lidhje farefisnore për nga origjina, kanë aq shumë të përbashkëta, kërkon një shpjegim përtej sociologjisë. Nga ky këndvështrim, në kulturën turke nuk ka asnjë paragjykim për shoqërinë shqiptare. Është e vërtetë që në rastin e Ismail Kadaresë janë bërë vlerësime të ndryshme ose kanë dal në pah nga këto lloj perceptimesh. Në këtë mendoj se padyshim një peshë të madhe kanë veprat e para të përkthyera dhe përkthimi ndërgjuhësor. Sipas meje kritika i shërben qëllimit të saj vetëm kur shfaqet në një kornizë konstruktive ndërsa doza e kritikës është çelësi që ju çon drejt së vërtetës. Në këtë kontekst, situata që më shtyu te Ismail Kadareja si në aspektin akademik, ashtu edhe në fushën e përkthimit është sepse kam parë një dritë tjetër nga këndvështrimi i mazhorancës. Unë mund të shkruaj shumë gjëra për këtë. Për shembull, në shumicën e veprave të Kadaresë mund të gjesh imazhe turke. Por mendoj se e rëndësishme është që gjatë leximit dhe vlerësimit të këtyre veprave të mund të bëjmë edhe analizën psikologjike. Sepse çdo roman përmban trillim, por kujtimet e fëmijërisë dhe ndjenjat e asaj periudhe janë më realet. Nuk hezitoj ta ndaj me guxim këtë mendim që kam arritur bazuar në veten time në çdo fushë. Unë kam edhe studime akademike të shkruara për këtë temë në Turqi, në të cilat shpreh pikëpamjet e mia në këtë mënyrë. Kjo nuk ka qenë kurrë një situatë që më ka penguar në punën time. Përkundrazi, mund të them qartë se kam marrë mbështetje nga shumë fusha, sepse kam shprehur me guxim pikëpamjet e mia unike. Në këtë këndvështrim dua të theksoj se keqkuptimet për Ismail Kadarenë nuk janë në nivelin e ekzagjerimit. Nuk duhet harruar se tipari më i rëndësishëm i Ismail Kadaresë është pena e tij dhe lexuesit turq janë të interesuar në radhë të parë për këtë. Për këtë arsye, shtëpitë botuese më të dalluara të Turqisë botojnë veprat e Ismail Kadaresë.

Përmbledhja me tregime/novela "Fajtori" të Besnik Mustafaj

Marrëzia ballkanike në përmasat e saj reale dhe kozmike

Nga Ballsor Hoxha

Një hyrje e shkurtër

Në prozën e parë të kësaj përmbledhjeje, Fajtori, një shkupjan, dhe një ambasador "Shkelqësi" siç i thonë në Paris, të dy, pikërisht në këtë qytet gjenden në një telashe të paimagjinueshme. Nëse jo në emër të tij, së paku në lidhje me të derisa ai ka shikuar punët e tij për të mbijetuar, pra të shkupjanit, gurgdhendës i zakonshëm, vdekatar i zakonshëm pikërisht kështu siç e ka paramenduar jetën e tij, është rrënuar një gjeneratë e tërë e studentëve, të rinjve, shqiptarëve ngado e kahdo, dhe në këtë ka dalë dosja e tij në publik, në një mënyrë. Sa më shumë që thellohet "përfshirja" e tij tanimë në publik, marrëzia e tërë kësaj arrin përmasa kozmike. A ia vlen të merret njeriu me një kozmos marrëzie, a ia vlen të ballafaqohet po kjo. Por, ajme, asgjë nuk përfundon këtu, pikërisht me hapjen e dosjes së tij, si njeri tejet i përfshirë në majat e politikave të UDB-së jugosllave dhe të Maqedonisë atëherë (tash Maqedoni e Veriut), hapet dhe ana tjetër e marrëzisë së kësaj politike jugosllave e maqedonase të veriut, të hakmarrësve, dhe me këtë ai prapë është, tanimë njëlloj heroi, i përfshirë në ndëshkimin e politikës paraprake.

E si hyn këtu një "Shkelqësi", përpos përmes mallkimit që mbanë, është shkrimtarë, është shqiptarë dhe respektues edhe ndaj një qytetari të thjeshtë si gurgdhendësi shkupjan. Ai duhet ta bartë këtë marrëzi, t'ia mundësoj shkupjanit të ballafaqojë këtë marrëzi në publik, por vetëm përmes shkrimit. Dhe ky shkrim, me Mustafajn pjesëmarrës, ka dalë në librari, por ka dalë edhe kozmosi i marrëzisë ballkanike bashkë me të, në publik. Të na ruaj zoti, se kozmosi vazhdon e vazhdon.

Në prozën tjetër të kësaj përmbledhjeje, po ky kozmos marrëzie është saktë ndan vuajtjes njerëzore, duke e bërë edhe këtë të dytën marrëzi saktë për shkak të pashpjegueshmërisë së saj. Pikërisht në pakuptimësinë e saj, të shkaktuar dhe që ka përmbytur njeriun. Pattern (shtegu) i vuajtjes duke qenë i mbetur vetëm dhe vetëm subjektive, për shkak të pakapshmërisë së saj për tjetrin, dhe aq më shumë përmbytjen e njeriut në të. Dhe pikërisht kjo e shndërron tërë vuajtjen e njërit prej idhujve të të rinjve të Shqipërisë komuniste, njërit prej qëndresave më të thella ndaj kësaj tiranie, ndaj njërit prej heronjve më të mallkuar, në saktë marrëzi! Marrëzi duke qenë e pakufishme dhe e pakapshme, aq më shumë vetmi e pakalueshme, dhe e pabartshme. Pikërisht kur ky hero, ky idhull ka kaluar të tërën, i hapet urrejtja ndaj vetë babait të tij me të vetmen arsye të të qenit baba i tij, në mos të ketë arritur të qëndrojë e t'i bëjë ballë tërë katrahurë[s së tij përmes urrejtjes ndaj babit të tij. Aq më shumë shterpësia e një jete të pajetueshme, aq më shumë të papërjetushme, për shkak të të njëjtës marrëzi, për shkak të pakufishmërisë së lirisë pas kësaj vuajtjeje, dhe saktë pamundësia për të humanizuar këtë vuajtje, e çon atë vetë, dhe çdonjërin në afërsi të tij në skajet e kozmosit të kësaj marrëzie.

Në prozën e tretë të kësaj përmbledhjeje, kemi një kthesë tejet interesante të Mustafajt, ai në guximin më të madh përballë dhe ulet gju më gju me lexuesin duke e publikuar një prej novelave të gjata të tij të hershme në veprën e tij. Proza përmban një situatë e ngjarje monstruoze, të paimagjinueshme. Është vetë marrëzia në stratan (shtresën) e aktuales së saj, gjatë tiranisë së komunizmit të Shqipërisë. Është zanafilla e monstruozitetit, (lexo: marrëzisë së vuajtjes) që në dy novelat e para ka arritur përmasa kozmike.

Mirëpo, lexuesi duhet pasur në mendje që këto novela, (qoftë edhe e fundit në krahasim me dy të parat) janë mjeshtëri e rrallë e teknikës postmoderne të trajtimit të psikologjisë, e me këtë të njerëzores së narratorit pjesëmarrës, edhe real dhe edhe fiksional, ndan një kozmosi të marrëzisë ballkanike, e shqiptare (si në tregimin e dytë).

Po, Mustafaj është diplomat (e që në popull njihet si politikan) i rryer, dhe me përvojë edhe revolucionare , apo sido që trajtohet fundi i komunizmit tiranik në Shqipëri, aq më shumë duke pasur parasysh esetë në vijim mbi këtë përmbledhje të tij, gjë që mund të ketë edhe keqkuptimet pa të cilat nuk mundemi, si pjesëmarrës të këtij kozmosi, por ka një gjë që nuk bën të harrohet në këtë, dhe kjo është pikërisht ajo që u cek në vërejtjen për leximin postmodern të këtyre tregimeve e novelave.

Në trajtimin e dy tregimeve të para nga kjo përmbledhje, si ese, shfaqen dy fenomene të psikanalizës së Freud, e që janë vonimi i kënaqësisë, si marrje, apo, aq më shumë përpjekje e njeriut për të marrë pushtetin mbi kënaqësinë, e me këtë mbi vetë qeniesimin. E kjo në kënaqësinë e të vonuarit të kënaqësisë (paradoksalisht) shkakton impotencën, e kësaj marrëzie me përmasa kozmike -shih politikën ballkanike sot, e kurdo në historinë e saj.

Dhe fenomeni tjetër i psikanalizës, gjegjësisht në tregimin e dytë kësaj përmbledhjeje, ai i Kompleksit të Edipit, si pattern (shteg) dhe si e përhershme e pandryshueshme, dhe e pakthyeshme e çdonjërit, pikërisht për shkak të pamundësisë së ikjes nga ky pattern, qoftë të vuajturit e qoftë shkaktarët, apo, thënë më mirë, të gjithë ne që jetojmë post-tiranisë kozmike të kësaj marrëzie.

Dhe, para trajtimit eseistik të dy tregimeve të para të përmbledhjes Fajtori, këto dy fenomene të psikanalizës, impotenca kozmike dhe pattern i pakthyeshëm i saj (jo vetëm për shkak të atësores së këtij shtegu), pra vonimi i kënaqësisë dhe Kompleksi i Edipit, janë në të vërtetë të qenit në pakthim në afërsi reale dhe tronditëse ndaj atësisë sonë, jo vetëm si bijë e bija, por edhe prindër tanimë, të këtij kozmosi që duhet dekonstruktuar disi. Apo, siç u tha më lartë, në këtë impotencë qenisimi ballkanik, e jo vetëm shqiptarë, duhet të rikthejmë potencën, të ri-zbulojmë vetë kënaqësinë e të jetuarit.

Nji impotencë kozmike – vonimi Freudian

Një tregim/novelë si *Fajtori* e Besnik Mustafajt, të bën të pyetesh nëse politika dhe me këtë pushteti nuk janë aq ndyrësisht shprehje e kënaqësisë deri në impotencë të bartësve të saj. Nëse ato nuk janë shprehja ekzakte e njeriut në anal – sadizimin e tij, në pamundësinë për të shkarkuar kënaqësinë e tij/saj për të vonuar përfundimin e kënaqësisë deri në një kënaqësi kozmike. Nëse e tëra, politika pra, nuk është një inspirim për të fshehur deri në përmasa kozmike, kënaqësinë po ashtu kozmike, të qenit në pushtet.

Tregimi/novela Fajtori i autorit Besnik Mustafaj është një shembull klasik i asaj që Freud e njihte si pushteti i njeriut, apo në të vërtetë ankthi i njeriut për të pasur pushtetin mbi kënaqësinë – defer (shtyrje/vonimi i kënaqësisë!).

E më tutje, pushteti i njeriut mbi qeniesimin duke pasur pushtetin mbi kënaqësinë.

Tregimi/novela Fajtori është saktë paradoksi i zmadhimit gjigant të kënaqësisë, apo thënë më saktë të obsesionimit me vonimin e kënaqësisë, derisa ajo përfshinë në përmasën e rritur të saj kozmike (të gjeneratave, shteteve, politikave, historisë dhe të luftërave tmerrësisht të përgjakshme) një gurgdhendës rrënjësisht të padjallëzuar. Me ç'rast ai, në tërë përditshmërinë e tij të vdekatarit të zakonshëm, kalon nga bartësi i ndërtimit dhe veprimit të një sistemi historie, në bartës të një sistemi të një historie të re, të shumë e shumë gjeneratave, politikave, historive dhe shteteve.

Në paradoksin e vonesës, shtyrjes (delay, deference) sipas psikanalizës të Sigmund Freud, filozofi Jacques Derrida gjen çarjen e tërë bashkëkohësisë sonë, e që është – differance – kompozicion i fjalëve defer dhe difference (shtyrje dhe dallim). Përputhja dhe mospërputhja në të njëjtën kohë e fenomeneve të qeniesimit tonë, pranimi dhe vonimi i pakufishëm i çdo gjëje, deri në një shënjim të radhës që do të shënjojë, një shënjim tjetër, deri në pafundësi, dhe kjo, jo si dinamikë, por si pamundësi e të vërtetës, fizikes sonë të pandryshueshme, e të afeksionit tonë me veten tonë si njerëz në këtë botë dëshmuar vetëm dhe vetëm përmes fizikes.

Por, le t'i kthehemi fenomenit të defer, shtyrjes, Freud e farkëton këtë si kënaqësia e njeriut mbi vetë kënaqësinë. Kënaqësia e të vonuarit të kënaqësisë, apo thënë thjeshtë të shtyrjes së përfundimit të kënaqësisë.

Dhe nga kjo hyrje, të pyetemi, çka ndodhë në të vërtetë në tregimin/novelën e Besnik Mustafajt, Fajtori? Sigurisht ngjarja nuk mungon, e tëra tregohet, aksioni/situata janë hollësisht të shtruara, dhe në fund ka edhe një përfundim. Pse dhe të shfaqet apo të flitet fenomeni i vonimit/shtyrjes Freudiane, në tërë kohën e tregimit.

Në ngjarjen e tregimit/novelës së Mustafajt ka vetëm dy personazhe, ai i narratorit Besnik Mustafajt (vetë personit fizik) dhe të shkupjanit të padjallëzuar të formësuar e mbijetuar në Paris, Hamza Sinanit. Gjë që asgjë nuk ka të bëjë me vonimin/shtyrjen duke qenë se të dy kurthohen në një situatë në të cilën as nuk janë pjesëmarrës direkt, dhe as nuk bartin ndonjë rëndësi të dorës së parë. Kjo më tutje duke e bërë konfuze tërë këtë fenomen të vonimit.

Por, së pari, këtu nuk kemi të bëjmë me vonesë, le të themi sa zgjatë një kënaqësi çiftëzimi seksual, as edhe të ndonjë kënaqësie të paramendueshme direkt, në të vërtetë kemi të bëjmë me shtyrje dhe vonim të kënaqësisë për jetë dhe gjenerata të tëra, dhe aq më shumë për kolektive e shoqëri e shtete që përfshijnë një histori të tërë. Kemi të bëjmë me UDB-në e famshme të ish Jugosllavisë që ishte shërbimi sekret jugosllav. Kemi të bëjmë me lindjen e një shteti të ri, atë të Maqedonisë e më vonë Maqedonia e Veriut, kemi të bëjmë me kalimin dhe ndryshimin e raporteve ndër-etnike shqiptaro - maqedonase. Kemi të bëjmë me gjenerata të tëra, histori të gjeneratave të politikanëve, "Shkelqësive" të tyre në Paris, dhe me histori të politikave të shteteve e shoqërive. Ndërsa Mustafaj, po ashtu "shkëlqesi" dhe shkupjani i padjallëzuar bëhen pjesëmarrës të po të njëjtës.

Dhe së dyti, kemi të bëjmë me një gurgdhendës dhe një shkrimtar, i cili në të vërtetë përfshihet në këtë kozmos shndërrimesh e vonesash e shtyrjeve të kënaqësive, në mënyrë indirekte, që janë strumbullari i rrëfimit të këtij qarkimi të këtij kozmosi, gjithnjë duke e shtyrë dhe vonuar kënaqësinë. E paparamendueshme, një gurgdhendës shkupjan dhe një shkrimtar që mbeten bartës të shpartallimit të këtij qarku të vonimit të kënaqësisë të këtij kozmosi. Njëlloj kolaterali i tërë kësaj vonese.



Së treti, duke iu kthyer fenomenit të vonimit (defer) nga Freud, të kënaqësisë, kjo në të vërtetë shpjegohet, në prapakthim, si kënaqësi anal-sadiste, njëlloj mospajtimi me përfundimin e kënaqësisë. Njëlloj refuzimi për të shkarkuar kënaqësinë. Njëlloj obsesionimi për t'u kënaqur deri në vdekje.

Së katërti, kur tanimë i kthehemi fillimit të kësaj eseje, - differance – të Jacques Derrida, arrijmë në njëlloj përputhje të kësaj kënaqësie, dhe aq më shumë mospërputhje të kësaj kënaqësie derisa endemi në të gjitha rrjetat dhe bartëset (gjeneratat) e jo vetëm të vonimit/shtyrjes tanimë, por edhe të dallimit.

Kozmosi i vonimit të kënaqësisë së pushtetit, apo siç u tha në fillim, të pushtetit mbi kënaqësinë, në stilin ballkanas, në tregimin/novelën Faji të autorit Besnik Mustafaj, në të vërtetë është i ngujuar në një burim të vetëm, atë të humnerës së pafundme të motivit për këtë kënaqësi, e që është vetë pushteti, politik/shtetëror. Por, i cili është i ngujuar thellë në humnerën e të pabesueshmes, të pakontrollueshmes, dhe aq më shumë të po të njëjtës bërë të "kapshme", që do të thotë të pabesueshme pafundësisht, nga kalimi në impotencë të kësaj shtyrjeje. Sigurisht, kjo gjanë komplekse për t'u kapur, por nëse një histori e tërë, në vazhdim e sipër, reale dhe me së paku mijëra viktima e sakrifica, dhe shtyrja e pafundme ndër të gjitha këto gjenerata të kësaj kënaqësie të dhe për pushtetin, doemos do të kishte, do të ketë edhe pasojat e papërballueshmërisë së organizmit njerëzor, të bartësve të saj. Arritja e një kënaqësie kozmike, si kjo, aq më shumë ballkanase, kaluar në impotencë, është tërë pushteti i arritur i kësaj lufte gjigante për këtë differance.

Ndërsa, për përfundim, thënë shkurt- *differance* – e Derrida, shfaqet krejtësisht kthjellët në dy shtresat e situatës ku gjendet autori i kësaj novele: shtresa e parë ajo e dy pushteteve, atij paraprak me këtë aktual, në tentimin e tyre për lustrim, ndërsa tjetri, cilido nga këto të dy sisteme, është pakthyeshëm në përputhje me drejtësinë e vetë në emër të të cilës ndërmerret çdo gjë, por pakthyeshëm në mospërputhje me drejtësinë e vetë në emër të të cilës ndërmerret çdo gjë, po ashtu. Dhe më tutje, në shtresën e dytë: gurgdhendësi shkupjan dhe autori duke qenë pabesueshëm burim i të tërës, dhe në anën tjetër, paarritshëm të besueshëm në të qenit të përjashtuar nga çfarëdo burimësie e të tërës. Gjë që në fund del të jetë një impotencë kozmike, me përmasa kozmike, e me kah për në tërë universin!

Marrëzia e vuajtjes saktë përballë saj

Kur lexuesi takohet me një vepër si *O tempora!*, e autorit Besnik Mustafaj, ka një fatkeqësi, apo një fund të natyrshëm, por të cilën ne e quajmë ashtu, megjithëse kjo është vetëm fund i një kënaqësie të papërsëritshme, fund, edhe i natyrshëm, edhe i duhur, por në të vërtetë, në këtë, që përmban edhe një vdekje, të lehtë, të prekshme dhe të përjetuar, e që është fund i gjallërimit të një rrëfimi. E quajmë fatkeqësi, me ose pa të drejtë, nuk e di, megjithëse po e njëjta është qoftë shkëputja e gjërave, apo qoftë fundi i rrëfimit, e rrëfimi vetë jeta. Në të vërtetë, e përjetojmë fundin, qoftë vdekjen, ashtu të lehtë, të prekshme dhe të përjetuar në rrëfim, në përfundim të tij.

Nuk është e paqëllimtë teoria e personazhit të Kunderas për Edipianen në marrëzinë e vuajtjes së shkaktuar nga komunistët e shekullit të kaluar në romanin e tij më të njohur. Në të vërtetë ajo është tmerri i hakmarrjes së Edipit birë ndaj pakthyeshmërisë dhe të pandryshueshmërisë së të përhershmes së atësores, fatit dhe – pattern – (shtegut) të njerëzimit. Pattern i sjelljes njerëzore, dhe me këtë pattern i pandryshueshëm i pushtetit, të pushtetshmes dhe të pushtetarit.

Dhe në këtë, apo pas marrëzisë së tërë kësaj vuajtje, një shkrimtarë, dëshmitarë i saj, si Besnik Mustafaj është një Don Kishot i kronikës së saj, apo thënë më saktë ka kaluar në Don Kishot, përballë dhe në ballafaqim me mospërfundimin e kësaj marrëzie të vuajtjes.

O tempora, o Servantes, o Mustafaj, ç'është në këtë kozmike të marrëzisë ballkanike, vetë letërsisë ballkanike!, përballë dhe në ballafaqim me vuajtjen që ia shkaktojmë ne vetes! Një kozmos letërsie përballë kozmosit të marrëzisë ballkanike, vetë kotësia, vetë e paimagjinueshmja, vetë e papërjetueshmja, e papërsëritshme.

Po, është e papërjetueshme, e papërsëritshme. Qysh duke u nisur nga mëria, e pafalshmja e të qenit birë, fëmijë ballkanik. Impunity (mosgjykimi, apo gjykimi me mosjgjykim) e shpallur e të birit shqiptarë ndaj prindit shqiptarë. Nuk e di a është e lehtë të lexohet, apo ndoshta tejet komplekse në këtë tregim/novelë, efekti i kësaj Impunity të të birit Zenel Meça ndaj babait të tij, në narratorin - dëshmitarin real Besnik Mustafaj. Apo, që do ta quaja në këtë ese, vetë Don Kishotit e Servantesit bashkë të këtij tregimi/novele, të vetë Mustafajt.

Kompleksi i Edipit, i ashtuquajtur në psikanalizë është kthjellimi i njeriut në infantilen e tij/saj se bota është e mbetur dhe e lënë pakthyeshëm në përhershmëri nën pushtetit atësor, qoftë para, pas apo gjatë të qenit fëmijë i një babai. Është pushtet i pandryshueshëm, dhe për këtë në konflikt të patjetërsueshëm, dhe për këtë në – pattern - të Don Kishotit ndaj Servatesit, dhe të Servantesit ndaj atësores mbi të.

Apo, të Besnik Mustafajt ndaj atësores mbi të, të personazhit të tij Zenel Meça, në prapakthim, ndaj vetë Besnik Mustafajt si autor.

Letërsia është në të vërtetë skuta, qoftë edhe ajo mbledhësja e ujit të pikave të shiut në *Kronikë në gur* të Kadaresë, në të cilën ikim nga atësorja e trashëguar mbi ne, aty ku shtrijmë gjerë e gjatë një univers botë ndryshe, një botë tonën, vetëm tonën, për të ikur nga ky konflikt me atësoren mbi ne, nga kjo përhershmëri e atit, mbi atin, e atit të atit, të etërve, etj.

Dhe Mustafaj në këtë tregim/novelë *O tempora!*, dorëzohet, në mos është mundur, në mos është përmbytur, në mos është bartur nga vërshimi i letërsisë, qoftë asaj mediokre, e qoftë asaj si epitomë e vuajtjes së atësores, përballë marrëzisë së vuajtjes.

Është marrëzi, jo vetëm për shkak të pamundësisë së të bashkëndjerit (përdëllimit) ndaj një personazhi si Zenel Meça, është marrëzi vetë jeta, vetë pas-jeta, pas-tirania, pas-..., një vuatje si ajo e këtij personazhi.

Atësorja si pakthyeshmëri në përhershmëri e pushtetit të dhënë si pattern i njeriut nëpër të cilin do të jetoj përgjithmonë, në këtë tregim/novelë është disfata e njeriut për ta ndryshuar atë. Për të ikur nga ajo. Për të jetuar tej e tutje prej saj. Zenel Meça jeton, në të vërtetë ka jetuar marrëzinë e tërë vuajtjes. Zenel Meça është i pa fëmijë, pa familje, pa grua. Është i kastruar, jo në vuajtjen e tij, por saktësisht jashtë saj, në lirinë dhe demokracinë pas marrëzisë së vuajtjes. Është i pajetë, i pajetueshëm dhe i pa përjetueshëm qoftë për veten (aq më shumë në pamundësinë e përdëllimit të të tjerëve përreth tij). Sepse pikërisht, tutje jashtë marrëzisë së vuajtjes, ai përballet me të pandryshueshmen e atësores, vetë vdekjes së saj, dhe aq më shumë të pandryshueshmërisë së kësaj vdekjeje, këtij përfundimi.

Ky është konflikti i atësores dhe fëmijës. Pandryshueshmëria e pamundësisë së përmbysjes apo kalimit të atësores, qoftë edhe duke u bërë vetë baba, e kjo e fundit duke e tejçuar të njëjtën tragjedi, pikërisht të të pandryshueshmërisë.

Pikërisht kjo duke qenë qarku i mbyllur i kozmosit të ballkanases, në një marrëzi vuajtjeje në përhershmëri të pandryshueshme.

Ka vetëm një personazh tërë tregimi/novela, dhe njëlloj reflektimi të marrëzisë së vuajtjes së shkaktuar ndaj tij në personazhin e Besnik Mustafajt, derisa personazhi tjetër është edhe më periferik. Zenel Meça në këtë tregim/novelë është ngadhënjyesi më i thellë i mundshëm i po kësaj marrëzie të vuajtjes njerëzore – tiranisë shqiptare gjatë komunizmit. Por, ajme, vetëm ashtu siç e imagjinojmë ne. E për këtë kemi dëshmitarë edhe Besnik Mustafajn njeri Don Kishot e Servantes të përpjekjes për të bashkëndjerë me këtë ngadhënjim, dhe edhe Besnik Mustafajn autor për të ikur nga kjo, saktësisht për të ikur nga ky ngadhënjim, jo më për shkak të ndonjë humaneje, por pikërisht për shkak të pamundësisë për të arritur deri tek kjo marrëzi e vuajtjes, e me këtë pamundësisë së të kuptuarit të saj. Sepse jemi pikërisht armatë Don Kishotësh të gjithë ne në përpjekje për të hamendësuar këtë. Jemi të paaftë për të ikur po ashtu. E jemi në një univers të Kompleksit të Edipit.

Kujtim M. Shala: "Kënga e cjapit", studim mbi dramën klasike shqipe

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës sapo ka nxjerrë nga shtypi librin më të ri studimor të Kujtim M. Shalës, të titulluar "Kënga e cjapit", i cili është libri i pesëdhjetë me radhë i këtij autori.

Kënga e cjapit trajton *dramën klasike* shqipe, në radhë të parë *dram*ën *tragjike*, e cila njihet si *gjinia më e lartë* dramatike. Libri është strukturuar në tri pjesë, nga të cilat e para është teorike dhe titullohet *Kënga e cjapit*, ndërsa dy të tjerat, të titulluara *Drama klasike* dhe *Tragjedia shqipe*, janë studime empirike të dramës klasike shqipe.

Pjesët empirike të librit të Shalës nisin me kapitullin *Drama klasike*, mbështetur te vepra e Gjergj Fishtës, në të cilin studiohet e gjithë vepra dramatike e këtij autori, duke nisur nga evidencat për të kaluar te çështja e gjinisë dhe, përfundimisht, shtrihet si interpretim i veprave të veçanta dramatike të tij. Pjesa tjetër, *Tragjedia shqipe*, është qendrorja e librit dhe ka tre kapituj; sipas radhës, në kapitullin e parë trajtohen tragjeditë klasike të Fishtës, për nga gjinia e tyre, struktura dhe idetë themelore; kapitulli i dytë, më i gjeri i kësaj pjese dhe i gjithë librit, u kushtohet tragjedive klasiciste të Etëhem Haxhiademit; ndërsa kapitulli i titulluar *Drama fisnike* trajton vepra dramatike kushtuar Skënderbeut, heroit kombëtar të shqiptarëve. Te kapitulli *Drama fisnike* janë studiuar veprat e Andon Zako Çajupit, Anton Xanonit, Etëhem Haxhiademit, Mark Ndojës, Zef del Gaudios dhe të Gjon Shllakut.

Si tërësi, libri *Kënga e cjapit* studion dramën si *vepër letrare*, por duke ruajtur vetëdijen se vepra e tillë shkruhet për t'u shfaqur në skenë, prandaj dhe duke pasur parasysh pikërisht atë.

Kënga e cjapit është një studimi rrallë për dramën shqipe, libri më i plotë deri më tani që i kushtohet dramës klasike.

Libri ka 228 faqe.



Në 80-vjetorin e rënies heroike

PAVDEKËSIA E ALI DEMIT

Nga Enver Kushi



Qyteti i kujtesës që flet

Në fillimmajin e vitit 2013, me Luan Ramën, shkrimtarin dhe kulturologun e njohur dhe një nga miqtë e mi të vjetër, po ecnim në rrugën "Rishëlie".

Kisha ditë që isha në Paris, bashkë me regjizoren Donika Muçi, operatorin Spartak Papadhimitri dhe Kenon, për xhirimet e fimit dokumentar "Marko Boçari".

Parisi është ndoshta nga të rrallët qytete në botë, ku kujtesa merr frymë, sheh, dëgjon apo flet. Atë mund ta prekësh në çdo hap që hedh dhe me një lehtësi të pabesueshme ajo të flet.

Në Paris binte shi i qetë, nanuritës, si në romanet e Hemingueit. Dhe duke ecur nëpër shiun e qetë parisien, unë e pyeta mikun tim të vjetër për Dinot e mëdhenj nga Preveza e Çamërisë, aq të lidhur edhe me Parisin…. Ndjeja nën shiun që binte zërat e tyre e më shfaqeshin, si ëndërr portretet e Dinenjve. .. Kjo po më ndodhte në Paris e jo në Stamboll, ku kisha shkuar disa herë, ku edhe atje kujtesa historike është kudo e prekshme. Vetëm e prekshme, mendova e jo zëfolëse, siç është në Paris… Këtu në Paris, në vitin 1895, Abedin Pashë Dino ishte dekoruar nga Akademia Franceze me "Palmën" e saj. Këtu në Paris sikur më fliste zëri i Hasan Tahsinit, çamit tjetër, që ka jetuar gati 12 vjet (1857- 1869) e që ka takuar disa nga personalitetet e shquara parisian si filozofë, matematicienë, fizikantë, astronomë etj. ... Kujtuam Abedin Dinon (të riun), piktorin e madh, Xhemil Dinon dhe djalin e tij, Borisin, që jeton këtu, Azis Çamin që nga Parisi niste vullnetarët shqiptar për në Luftën e Spanjës, Rexhep Çamin, një idealist të kulluar, anëtar edhe i Partisë Komuniste Franceze, xha Mahmudin nga Margëlliçi i Çamërisë, që sipas kujtimeve të diplomatit Javer Malo, vullnetarisht kishte bërë roje në hotelin, ku ishte vendosur delegacioni shqiptar më 1946.... E më pas folëm edhe për Jusuf Vrionin, përkthyesin e shkëlqyer, dajot e të cilit ishin nga Dinejt e Prevezës e që në Paris kishte kaluar rininë e ku vdiq vite më parë. .. Çuditërisht kryeqyteti francez ruante dhe fliste me kujtesën e tij për shumë personalitete nga Çamëria... Ne kishim xhiruar varrin e Pukëvilit në një pasdite me diell të ngrohtë, konsullit të Republikës Franceze, në oborrin e Ali Pashë Tepelenës në Janinë dhe dy ditë më parë metronë, që mbanë emrin e Marko Boçar Çamërisë (siç thuhet në një këngë popullore çame ... Pikërisht në këtë qytet gjurmët e lavdisë së Marko Boçarit janë më shumë se të prekshme dhe zëfolëese, që nga fjalori greqisht- shqip" i arkivuar në Bibliotekën e Parisit dhe deri tek pikturat e Delakruase apo poemat e Viktor Hygoit...

Pastaj u ulëm në një nga kafenetë e shumta të rrugës "Rishëlie" dhe Luani më foli për librin e tij të fundit me një titull sa poetik, aq dhe si një trokitje në derën e një ëndrre të parealizuar: "Pranvera dy hapa pranë". Me të folurën e ngrohtë dhe timbrin e veçantë të zërit, frazat disi të shkëputura, ai më rrëfeu për dëshirën e kahershme për të shkruar për dajon, rrugëtimin në Filat para disa vitesh në një pasdite të paqtë, pastaj për gjyshen që e kishte rritur e që kishte ruajtur derisa vdiq pardesynë e të birit(që ruhet në Muzeun Historik Kombëtar), për nënë Ildizen, që kthehej e rikthehej në Filat apo Tiranë me imazhin e të vëllait, Aliut. Mbaj mend që folëm edhe për dy botime të Nekie Demit, motra tjetër e Aliut, njeri i botuar në vitin 1963 dhe tjetri në vitin 2004, ku ajo flet për jetën e të vëllai, si dhe rënien heroike të tij. Nekie Demin e kam takuar disa herë dhe ruaj për të respekt si një zonjë e vërtetë dhe e kulturuar. Librin e saj të parë për Ali Demin e kam lexuar, që kur isha në moshën 15 vjeçare. Dhe kur dolëm jashtë, nuk e di pse rrëfimi i mikut tim më solli ndërmend teorinë, sipas të cilës shpirti mund të transmigrojë nga një trup në tjetrin dhe që e kisha lexuar në një nga esetë e shkëlqyera të Borhesit. Në këtë ese Borhesi shkruan, se cili prej nesh është, në një farë mënyre, tërë njerëzit që kanë vdekur përpara... Dhe duke ecur nëpër shiun e qetë të Parisit, nuk e di pse më dukej sikur dëgjoja në zërin e Luan Ramës, atë të Ali Demit dhe ecja në qytetin e kujtesës që flet me Ali Demin, djalin nga Filati i Çamërisë time dhe Spatari i të parëve të mi, që shtrihet" dy hapa pranë Filatit"

Pavdekësia e heroit

Libri i Luan Ramës "Pranvera dy hapa pranë" është nga më të mirët kushtuar figurave të ndritura të Antifashizmit Shqiptar, atyre që u flijuan në altarin e lirisë. Autori i ka shpëtuar pllakatizmit dhe paraqitjes baladeske apo patetiko-foklorike, që rëndon e gjejmë në publikimet e këtij lloji në Shqipërinë e para viteve 90. Në shumë syresh, por edhe në disa filma dokumetarë apo artistikë, pikturë etj të socrealizmit duket sikur heroi është ndryshe nga njerëzit e tjerë dhe sikur jeton në një realitet tjetër. Edhe kolana "Yje të pashuar", nuk i ka shpëtuar patetizmit, deklaratizmit, duke zbehur kështu thelbin njerëzor dhe të vërtetat e atyre që dhanë jetën për liri. Do të veçoja ndoshta monografinë e Nasho Jorgaqit për Heroin e Popullit Qemal Stafa a ndonjë tjetër të këtij lloji, ku shpalosen krahas heroit edhe ana njerëzore e tij dhe që e bën këtë libër nga më të mirët në letrat shqipe.

Me të drejtë autori shkruan se "këtë libër e kisha të vështirë...." dhe se "kjo thjeshtë për t'u ruajtur nga një lloj subjketivizmi dhe për ta parë personazhin me ngjyra relaiste, për ta shikuar atë në dimensionet e veta reale historike, emocionale, pra gjithçka që përbënte thelbin e karakterit dhe të mendimit të tij, e ngjizur padyshim me kohën dhe atë trashëgimi familjare dhe historike që mbartëte brenda tij", duke shtuar se përsëri personazhin doja ta shihja sa më tokësor dhe njerëzor. Cili ishte ai? Çfarë mendonte ai për kohën dhe njerëzit që rrethonin? Ç'mendonte për jetën në tërësi dhe të ardhmen?

Luan Rama arrin të na japë Ali Demin e vërtetë, heroin me botë të madhe shpirtërore, njeriun që jetoi jo vetëm në rrethana të caktuara historike, por që përjetoi emocionalisht dhe shpirtërisht këto rrethana. Ai është i pa qetë, gjithmonë në lëvizje dhe imbrutjur me shpirt revolte. Ali Demi në këtë monografi jepet si pjesë i një brezi nga më idealistët në histroinë e Shqipërinë, i krahasueshëm ndoshta për nga fryma, përpjekjet për ndryshim dhe sakrificat, me rilindasit tanë. Shumë prej tyre kishin studiuar në shkollat më të njohura europiane, të tjerë zotëronin një kulturë të gjerë në të gjitha fushat. E tillë është edhe Ali Demi i librit "Pranvera dy hapa pranë" i Luan Ramës.

Qiejt e fëmijërisë, adoleshencës dhe rinisë së Ali Demit, në këtë libër lëvizin në kohë dhe hapësira të ndryshme. Ai lindi në qytetin e Filatit më 18 janar 1918. Në rrafshin historik jemi pesë vite, ku pas një qëndrese historike të çamëve, ka rënë Janina dhe bashkë me të është pushtuar Çamëria nga ushtritë greke. Janë vitet më dramatike për popullisnë e kësaj krahine. Jemi pesë vite pas një masakre nga më makabret, atë të përroit të Selamit, pranë Paramithisë, ku banda e Delijanaqit pabesisht dhe mizorisht masakroi 72 burra të parisë së Çamërisë. Jemi pesë vite pas Konferencës së Londrës, e cila në vendimet e saj shkëputi Kosovën e Çamërinë nga trungu amë. Pikërisht në këto momente të zymta historike për Çamërinë dhe Shqipërinë erdhi në jetë Ali Demi. Filati mbante gjurmët e rënda të luftës. Qielli i fëmijërisë së Ali Demit, krahas grisë së kohës dhe trazimeve të saj, ka edhe magjinë e brigjeve mitike të lumi Kalama dhe të qytetit me tradita mëmëdhetare, Filatit, ditët me diell dhe gjelbërimin e përhershëm të peizashit të Çamërisë, ngrohtësinë e erërave që vinin nga deti Jon, ëmbëlsinë e dialektit çam....

Luan Rama në këtë libër përshkruan bukur Filatin, traditat e këtij qyteti, fisin e madh të Dematëve e veçanërisht disa figura emblemtatike të këtij fisi si Musa Demi, Rexhep Demi, por edhe të fisit të Sejkatëvet. Me një kolor të veçantë jepen rrugët e ngushta të Filatit, dyqanet, burrat e qetë dhe trima, vajza dhe gra të bukura, dasmat me këngët e vallet levente çame, përrallat që të çojnë thellë në muzgjet e botës pellazgjike.

Edhe qiejt e adoleshencës e të rinisë së Ali Demit kanë ngjyrën e tyre të veçantë. Ata zhvendosen në hapësira të tjera, siç është Saranda, ku ai shkon për studime në konviktin "Çamëria", ku bashkë me fëmijë të tjerë çamë mëson gjuhën amtare. Më pas në kohë dhe hapësirë tjetër, shkon në qytetin e Gjirokastrës. Është viti 1932, kur Ali Demi hyri në gjimnazin e këtij qyteti dhe këtu, bashkë me shokun e tij të ngushtë Themo Vasi dhe kushuririn e tij Njazi Demi, organizuan revoltën e nxënësve për kushte më të mira jetese. Në këto vite më pas Ali Demi rrezaton mirësi, kulturë, dinjitet, krenari, të trashëguara këto nga rrënjët e fisit të tij. Nga ana tjetër qielli i adoleshencës dhe i rinisë së hershme i tij nis e trazohet. Në shpirtin e Ali Demit zë vend revolta ndaj padrejtësive dhe të keqes. Po të ndjekësh



itinerarin e jetës së heroit, një nga karakteristikat më spikatëse është gjendja e revoltës, shkruan autori i librit. Edhe pse i përjashtuar nga gjimnazi i Gjirokastrës Ali Demi në Tiranë, në prag të pushtimit fashist do të hidhet në rrugën e protestave kundër pushtimit italian dhe më pas në protesta e demonstrata të tjera. Kjo revoltë e lidhi me komunistët e parë shqiptarë dhe e bëri pjesë aktive të Partisë Komuniste Shqiptare. Kjo revoltë do ta ndiqte në aksionet e para, si dhe në burgun e Tiranës, duke organizuar grevat e urisë, protestat e mëdha deri edhe arratisjen e numrit të madh burgosurish politikë, më 29 prill të vitit 1943.

Ali Demi i përket brezit të ëndërrimtarëve të mëdhenj, jo ëndërrimtarë "tuafë", por atyre me këmbë në tokë dhe që ëndrrën e kanë konkrete dhe të prekshme. Këta ëndërritarë ruajnë në vetvete energji të pashtershme dhe vrulle që rrallë i gjen tek të tjerët.

Këtë ëndërr dhe vrull rinor paraqet Luan Rama në librin e tij për heroin Ali Demi. Për këtë ëndërr dhe realizimin e saj nuk është vetëm. Në këtë libër krahas Ali Demit, figurës qendrore të librit, dalin edhe emra të tjerë që nga Qemal Stafa, Perlat Rexhepi, Ramize Gjebrea, Vojo Kushi, Hajdar Dushi.

Me Ali Demin, për realizimin e kësaj ëndrre janë edhe djemtë e tjerë të Çamërisë, si Njazi Demi, Kasem Demi, Taho Sejko, Teme Sejko, Tahir Demi, Ilmi Seiti, Myfit Sejko, Muharrem Demi, Selim Islami, Qamil Buxheli etj. Në emër të kësaj ëndrre Ali Demi bie heroikisht, duke dhënë jetën në moshën 25 vjeçare, më 20 dhjetor të vitit 1943 në Kaninë të Vlorës. Në kujtimet e tij për vrasjen e Ali Demit, me origjinë nga Çamëria dhe lindur në Pandelejmon, shkruan për Sami Muratin, që në fshatin Pandelejmon, dha lajmin tronditës për Ali Demin, bir i Çamërisë, Sekretar Politik i Qarkorit të Vlorës, mbasi kishte çarë rrethimin, në një shtëpi të Kaninës, kishte rënë duke luftuar në Qafën e Dheut të Bardhë. Të gjithë ne mbajtëm një minutë heshtje në kujtim të tij dhe kënduam marshin funebër «Me dhimbje ju përcjellim në të varrit ftohtësi».

Libri "Pranvera dy hapa pranë" është ndërtuar mbi disa shtresëzime kujtesash. Pavdekësia, shkruan një nga mendjet gjeniale të botës, Borhes, është në kujtesën e të tjerëve, në veprën që ne lëmë. Përtej vdekjes sonë fizike mbetet kujtesa e përej kujtesës mbeten veprimet tona, mbeten gjestet tona, sjelljet tona. Mendoj se shtresëzimi i parë i kësaj kujtese në libër është e autorit. Kjo kujtesë nis që nga fëmijëria e Luan Ramës, e vazhdon e ndërthurur me kujtesa të tjera deri në fund të librit. Pastaj vjen kujtesa e nënës së heroit, Nazos, që ka një kolor tjetër dhe është zëfolëse. Ajo zhvendoset nga Filati, në Tiranë e më pas në Vlorë e në Kaninë. Një shtresëzim tjetër kujtese është e motrës së heroit, Ildizez, që është edhe nëna e autorit të librit. Kujtesa e saj lëviz që nga Filati, Tirana, rrugicat e këtij qyteti, shtëpia e vjetër (ku sot është lagjja "Ali Demi") apo burgun e Tiranës, duke ardhur deri në ditët tona. Mbaj mend, që në maj të vitit 2013, me t'u kthyer nga Parisi, me porosi të Luan Ramës shkova në shtëpi të nënës së tij, Ildizes, për t'i çuar disa libra. Shtëpia e saj ishte pas ish hotel «Pezës». Nuk do ta harroj kurrë takimin me të, sidomos bisedën që bëmë bashkë. Ajo ishte e shtrirë në krevat e paralizuar, në një krevat në këndin e dhomës. U ula pranë saj dhe duke parë fotografitë në murin përballë, sidomos ato të Filatit, babait dhe nënës së saj, atë të Ali Demit, ajo më tha, se jetonte dhe u fliste fotove të varura në mur. Kujtesa e saj ishte fenomenale. Duke më rrëfyer për qytetin e bukur të Filatit, Luftën Italo-Greke, miqtë e krishterë që kishin marrë në mbrojtje, Ali Demi, që ishte pro popullit grek, kundër fashizmit italian, rrugëtimin e gjatë për në Shqipëri në vitin 1942, shtëpinë ku u vendosën në rrugën e Shëngjergjit, burgun e Tiranës, kur shkonte për të takuar vëllanë, lajmin e kobshëm për vrasjen e të vëllait dhe nënën që vuri duart në kokë e pastaj i ra të fikët. Interesante janë kujtesat që vijnë nëpërmjet bashkëluftëtarëve të Ali Demit, si ato të Qamil Buxhelit, Kristo Frashëri, Rahman Parllakut e shumë të tjerë.

Ky është libri "Pranvera dy hapa pranë" i Luan Ramës. Ai është homazh për një nga djemtë idealistë të Çamërisë, për antifashizmin çam dhe kontributin e çamëve në Luftën Antifashiste këtej dhe andej kufirit, emrin e të cilit, pra të Ali Demit e mbante një batalion, me 500 djem dhe vajza nga Çamëria martire, pjesë e regjimentit të pesëmbëdhjetë të ushtrisë çlirimtare greke. Ali Demi i bën nder jo vetëm Çamërisë, por tërë Shqipërisë dhe libri është një homazh për një Hero të Popullit, që siç shkruan autori, i përket "i një rinie të kaluar vuajtjesh, vdekjesh dhe stuhish".

Ali Demi është i pavdekshëm, sepse pavdekësia është privilegj i pak njerëzve, është privilegj i të mëdhenjve.

Paris - Tiranë, 2013 - 2023





Në një shikim retrospektiv të gjërave, del që autori ka mbajtur llogari për temat dhe idetë e mbarështruara në libër, duke qenë gjithmonë koherent me kohën në një projeksion parashikues, vlerë kjo që atij i jep kredibilietin e vëzhguesit të politikës në prizmin historik e aktual.

"BOTA SHQIPTARE (E VEÇANTA DHE UNIVERSALJA)", NJË KAPËRCIM KONTINENTAL MBI HARTAT E NGUSHTA ETNIKE

Nga Emin AZEMI

Libri "Bota shqiptare (e veçanta dhe universalja)" i studiuesit dhe historianit Skender Asani përfaqëson mendimin e artikuluar intelektual mbi disa trajta të formimit dhe zhvillimit të botës shqiptare vizavi proceseve që kanë ndodhur në një të kaluar jo shumë të largët, por edhe në dimensionin aktual. Me këtë libër autori determinon nevojën e rishikimit të raporteve në mes të njerëzve, por mbi disa premisa krejtësisht humane e bashkëpunuese.

I ardhur nga bota shkencore e historisë politike, Skender Asani është një detektues preciz i proceseve, duke e shikuar të ardhmen në bazë të një empirizmi nga e kaluara por edhe të një deshifrimi të dritë-hijjeve nëpër të cilat po kalon aktualiteti dhe ngjarjet që e bëjnë këtë aktualitet të jetë fluid dhe herë herë i vendosur para sfidave të shumta vendore e rajonale, diplomatike e gjeopolitike.

Nga libri i Skender Asanit kuptojmë se BOTA SHQIPTARE nuk është hegjemoni e ndërtuar mbi elaborate për të pushtuar toka dhe popuj të tjerë. BOTA SHQIPTARE, sipas autorit, është integrim vlerash e idesh kulturore e shpirtëror mbi parimet e bashkëpunimit dhe bashkëjetesës me kulturat dhe etnitë tjera.

Vrapi për të vizatuar harta etnike në Ballkan, i kanë bërë elitat politike të pësojnë debakël para sfidave të reja që sjell shpopullimi. Në këtë kontekst, edhe shqiptarët nuk bëjnë përjashjtim nga ky proces degradues demogafik, social e etnik, prandaj jo ratësisht thuhet se në Amerikë mund të gjeni një Dibër të tërë, në Gjemani mund të gjeni fshatra të tëra të Pollogut që me dekada janë zhvendosur atje, apo në Greqi e Itali keni shqiptarë nga Hasi deri në Labëri, ndërkohë që fëmijët e lindur në diasporë po vuajnë pasojat e asimilimit dhe dezintegrimit kulturor e shpirtëror.

Libri "Bota shqiptare (e veçanta dhe universalja) i Skender Asanit është një ofertë idesh e pikëpamjesh për të gjithë ata që iu mungon vendlindja. Ky është një kapërcim kontinental mbi hartat e ngushta etnike, duke ofruar një vizion më pragmatik për të ardhmen e gjeneratave të reja, në kushtet kur ata ndodhen larg frymës dhe ndikimit kombëtar të vendlindjes.

Nëse disa popuj tjerë të Ballkanit ende jetojnë me mitet e shekujve të kaluar, BOTA SHQIPTARE të cilën e projekton Skender Asani në këtë liber është pikërisht antipodi i kësaj mitomanie mesjetare. Ky projeksion kulturologjik i Asanit përpos që është human dhe pragmatik, është edhe vizionar, sepse kauzat kombëtare nuk i mbyll brenda kornizave ideologjike e fetare, por përkundrazi ato i hap drejt horizonteve të reja bashkëpunuese me kulturat dhe etnitë tjera. Është pikërisht ky edhe vizioni i Nënës Tereze e cila ndonëse doli nga periferia (Shkupi), ajo e globalizoi dashurinë dhe mirëkuptimin në mes të njerëzve duke e vendosur fatkeqësinë e tjetrit para lumturisë vetanake.

"Bota shqiptare (e veçanta dhe universalja) mëton të jetë një përpjekje modeste e autorit për të hapur debatin mbi rolin faktorizues të shqiptarëve në procesin e rikonfigurimit gjeopolitkk të Ballkanit pas shembjes së Murit të Berlinit e deri në ditët e sotme. Koha ka dëshmuar se për herë të parë në histori ndodhi që shqiptarët të kenë aletatë më të fuqishëm perëndimor, sidomos pas çlirimit të Kosovës (1999), frymë kjo që kishte domino efekt pozitiv edhe në pjesët tjera të banuara me shqiptarë, përfshi edhe ata në Maqedoninë e Veriut. Në një shikim retrospektiv të gjërave, del që autori ka mbajtur llogari për temat dhe idetë e mbarështruara në liber, duke qenë gjithmonë koherent me kohën në një projeksion parashikues, vlerë kjo që atij i jep kredibilietin e vëzhguesit të politikës në prizmin historik e aktual.

Shkup, dhjetor 2023

Shënime për ekspozitën e piktorit Bujar Luca

ANTROPOSEMIOTIKA E MORFOLOGJISË TË SË PADUKSHMES

Dr. Oltsen Gripshi
Estet, kurator dhe historian arti

Shenja është gjesti identifikues i individualitetit të gjithkujt prej nesh, përballë së cilës e dukshmja dhe e padukshmja ka një rol thelbësor në këtë proces njohës. Shenjat në shumësinë e tyre shpërfaqin të pathënat dhe të padukshmet që flejnë në thellësi të nënvetëdijes tonë si qenie njerëzore. Janë pikërisht këto shenja, që zhvendosën ndjeshmërinë e artistit Bujar Luca nga konkretizimi i të figurshmes, që Realizmi Socialist i diktonte atij para viteve '90, tek abstragimi i realitetit bashkëkohës nëpërmjet antroposemiotikës së morfologjisë të së padukshmes, gjuhës së shpirtit.

Një kalim, i cili e udhëhoqi piktorin Luca drejt përmasës së një surrealizmi hibrid për nga përmbajtja e artit të tij. Zhvendosja në këtë përmasë është për piktorin rigjetja e një gjuhe pamore krejtësisht vetjake dhe rizbulimi i vetvetes, për sa i përket qasjes së tij në raport me mikro-makro antropologjinë urbane, pjesë e të cilës është edhe vetë ai. Kjo, pasi gjesti i tij krijues nuk është më mjeti për të shëmbëllyer realitetin me realizëm, por shndërrimin e tij nëpërmjet fuqisë së shenjës grafike, duke e personifikuar atë me shenjën dhe përmes shenjës.

Në thelb fuqia e shenjës është realiteti i kodifikuar në përfaqësimin e brendisë shpirtërore të piktorit Bujar Luca. Shenja "akrobatike" zëvendëson të perceptueshme me të papërcaktueshmen, ku imitimi i të vërtetës i lenë vend metaforës simbolike si shkallë sipërore e interpretimit semiotik. Shpejtësia e ekzekutimit e bën sipërfaqen e pikturës ndërvepruese mes piktorit dhe vëzhguesve, nga ku lexohet qartë një shfaqje instinktive e atij automatizmi të pastër psikik, që Breton besonte se ishte mjeti më i drejpërdrejt për të shprehur fuqinë e mendimit.

Në këtë këndvështrim është e kotë të mendojmë se në pikturën e Lucës do të gjejmë ndonjë referencë me realitetin, në aspektin e figurshëm të tij. Kjo, sepse piktori tashmë realitetin nuk e hulumton më nëpërmjet njohjes ontologjike, të përbërjes së materies fizike sesa përmasës metafizike që e rrethon vetë atë. Përmes dëgjimit të një tingulli në horizont të horizontit të qiellit të mendjes, që e fton artistin të depërtoj membranën e kohës së bashkëkohësisë në të cilën ai jeton.

Antroposemiotika e shenjës është për artistin Luca impuls, poezi, gjë, e cila shpërfaq më shumë instinktin sesa racionalitetin e tij si krijues i një imazhi të ri pamor, brenda të cilit nuk gjejmë asgjë të ngjashme me jetën njerëzore në tokë. Antroposemiotika në pikturën e Bujar Lucës është zhbërja, mohimi i antropologjisë urbane njerëzore dhe rikompozimi i saj nëpërmjet semiotikës; shenjës si dëshmi e gjurmës së ekzistencës së artistit në të tashmen, por edhe për të shkuarën e largët për brezat e së ardhmes dhe qasjes së tij konceptuale në raport me realen fizike. Janë imazhe brenda të cilave mungon tërësisht dhimbja, zhgënjimi, varfëria, sëmundjet, viruset vdekjeprurëse, shfarosja, intrigat, ligësitë, zilia, smira, refuzimet racore, përbuzja, amoraliteti, përdhunimet, luftërat ideologjike e fetare dhe gjithçka ka të bëjë me mëkatin zanafillor të Adamit dhe Evës në Kopshtin e Edenit.

Antroposemiotika në imazhin e ri të Bujar Lucës na shpien për të depërtuar konceptin e hapësirës, në përmasa të pa mata të kohës, ku shenja merr një fuqi simbolike të përbotshme, duke u shndërruar në Kurorë Gjembash të Jezu Krishtit si për të thënë dhe për të demonstruar se ai sheh përtej të dukshmes. Falë zgjedhës përmbajtësore surrealkonceptuale, artisti na zbulon të padukshmen e tij, të vërtetën e tij midis tokësores dhe hyjnores. Jemi në brendësi të një pikture, ku horizonti është pa horizont, pa qiell, pa re, pa shira, pa erëra, pa dëborë e pa breshër, pa vetëtima, pa diell, pa yje, pa natë dhe pa ditë, pa zogj dhe pa kafshë, pa bimësi dhe pa peizazh, përballë tyre qendron vetëm heshtja. – Heshtja e një artisti, e cila flet me semiotikën e shenjës për zbrazjen e imazheve që ai krijon pa asnjë analogji të ngjashme me realen që ne të gjithë njohim. Brujar Luca vërtitet përmes shenjës në një orbitë tjetër, paralele me token; është hapësira e një universi të mbërritshëm vetëm nga ai, por falë veprave të tij na bën të mbërrijmë edhe ne "virtualisht" në brendësi të saj.

Artisti i ekzekuton imazhet me një larmi të pakrahasueshme formash, nga njëra tek tjetra, duke i dhënë tingull ndjeshmërive të atij çasti krijues. Shenjat janë tërësisht abstrakte, me një morfologji hermafrodite, plotësisht kozmike dhe surrealkonceptuale, gjithashtu krejtësisht të shkëputura nga çdo referencë ndaj figuracioneve paraekzistuese, qofshin ato të natyrës natyraliste apo shqisore psikike.

Megjithatë, përcaktimi se çfarë është dhe se çfarë përkufizon antroposemiotika për shenjën në pikturën e Bujar Lucës është një detyrë e ndërlikuar, por jo e pamundur. Përballja me të është të zhyturit në "Galaktikën e Gjestit", të rikrijimit të universit në zanafillë. Gjesti si veprim dhe veprimi si konkretizim i shenjës është aq i ndërlikuar sa rrezikon edhe vetë artistin të humbasë përgjatë procesit krijues. Pavarësisht gjithçkaje procesi njohës brenda vetëdijes së artistit as nuk detyron dhe as nuk kërkon pëlqimin paraprak të vëzhguesit kundrejtë veprës së tij.

Artisti Luca shkëputet me vetëdije nga realiteti fizik, si mënyra e vetme për t'i shpëtuar ndikimit të mendësisë së masës shoqërore që e rrethon, duke u strehuar brenda mureve të tij të mishta për krijimin e alfabetit antroposemiotik, të pakufizuar në forma, që i përket vetëm atij dhe që buron nga thellësia e nënvetëdijes së ndjenjave që e formësojnë atë si materie frymore. Alfabeti antroposemiotik i Bujar Lucës është i përbërë nga emocionet, ndjesitë dhe përvojat e jetës së jetuar, që në realitet janë thelbi i morfologjisë të së padukshmes për sa i përket ekzistencës së tij si qenie njerëzore.

Në këtë këndvështrim shenja e "rizbuluar" dhe e interpretuar nga artisti nuk i përgjigjet një shijeje të caktuar sesa një arsyejeje, e cila e bën shenjën të barasvlefshme me konceptin e lirisë në hapësirë. E gjitha kjo ngre një marrëdhënie funksionesh

shqisore të cilat përfshijnë gjithmonë diçka të papërshkrueshme me fjalë, që i përket vetëm sferës më intime të artistit, por në të njëjtën kohë është në gjendje t'u përcjellë vëzhguesve të veprës së tij një përjetim, që merr formën e një shenje dhe përmbajtjen e një materjeje të mbinatyrshme.

Kur flasim për të mbinatyrshmen në pikturën e Bujar Lucës kemi parasysh marrëdhënien e pashmangshme midis subjektives dhe objektives, të dukshmes dhe të padukshmes. Ndaj, përkthimi i objektives në shenjë bën që shenja të jetë njëherazi çelësi i çkodimit të koordinatave ndjesore të së padukshmes që ekziston brenda artistit. E mbinatyrshmja është pararendësja e poezisë së shenjës në krijimtarinë e Lucës, ashtu si Joan Miró, i cili zgjodhi si paradigmë të pikturës së tij format e harkuara surreale, sepse ato mbartin në përbërjen e tyre lakime ndjeshmërishë të vërteta dhe të thella.

Në ikonografinë e pikturës së Bujar Lucës është e dukshme nevoja për të shprehur të padukshmen, që gjendet brenda hapësirë së tij të atrofizuar nga erozioni i përjetimeve : për të shenja është një mënyrë për të shprehur një shtypje dhe një shtytje të fortë emocionale, një tendojse ekstaze muskulare, një mënyrë për të ndjerë realitetin pa iu referuar domosdoshmërisht me referenca konkrete. Hapësira në ndërveprim me shenjën për Lucën, nuk është vetëm ajo që ai prek dhe percepton në natyrë. Hapësira në pikturën e tij përkon me hapësirën si koncept shqisor të cilës ai i mbivendos shenjën, që është thelbi i thelbit të imazhit të ri pamor. Të një imazhi, që i referohet sferës së të perceptueshmes si përfytyrim i të padukshmes onirike. Shumësia dhe ngërthimi i shenjave mes tyre dhe hapësirës janë për artistin Luca mjeti për të shprehur tensionet, emocionet, ankthet, harmonitë, ekuilibrat, çekuilibrat, pajtueshmërinë dhe papajtueshmërinë me fenomenologjinë bashkëkohore të një shoqërie apatike.

Piktura e Bujar Lucës ka kuptime apokrife. Është e vështirë të thellohesh në zbërthimin grafemave[1] të Lucës, sepse ai zgjedh me zgjuarësi e deri diku me "dinakëri", të na ftoi brenda labirintit të imazheve të tij, në dukje të ngatërruara e surrealkonceptuale, por që në të vërtetë mbartin thjeshtësinë e zanafillës së jetës. Në veprat e artistit Bujar Luca shenjat shtrihet mbi sfonde grafike njëngjyrëshe, herë mbi të bardhën verkuese si simbol i pastërtisë absolute puritane, herë mbi të kaltërtën hyjnore, herë mbi të zezën ankthndjellëse misitike e herë mbi të purpurtën ëndërrimtare. Të gjitha këto gama njëngjyrëshe pa vëllim të cilave artisti u mbivendos shenjagrafemat ekspresive krijojnë një skenë të atillë narrative me një ngarkesë poetike të jashtëzakonshme.

Antroposemiotika e morfologjisë të së padukshmes është një qasje që synon të krijojë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me vëzhguesin: për artistin është e rëndësishme që publiku ta vëzhgojë pikturën e tij, duke depërtuar në të, si mënyra e vetme për të bashkëndarë të gjithë materien e tij si artist në krijimin e shenjagrafemave të tij. Është një pikturë që lind nga ndjesia dhe që ushqehet nga emocioni.

1 Grafema – Termi grafemë tregon shenjën elementare të sistemeve të shkrimit. Grafema është një shenjë abstrakte kaligrafike dhe e ndryshme nga një alfabet në tjetrin. P.sh. germa A në alfabetin latin dhe germa A në alfabetin armen Ա

Fjalë për letërsinë e Petro Çerkezit

Rritja prej Temës dhe Formës

Nga Thanas Dino

Fati që më ka zgjedhur të kem shokun më të ngushtë të jetës Petro Çerkezin më ka mundësuar të shoh rrugëtimin e tij si një nga poetët, prozatorët dhe përkthyesit më aktivë e të njohur nga rradhët e penave të grekëve të Shqipërisë, duke filluar nga mosha e vjershave të para në gjimnaz, pastaj në Universitet dhe në dekadat e tëra të jetës. Vepra e tij e gjerë është një kontribut më vete në kulturën bilingue që shkruhet në greqisht e shqip dhe një histori letrare e jetës së minoritetit grek në Shqipëri.

Ndryshe nga disa të tjerë prej nesh Petro Çerkezi pati një formim letrar më të shpejtë, e gjeti veten më lehtë në letërsi, fillimisht në poezi. Ai nuk i ndjeu aq shumë përplasjet nga një ekstrem estetik te tjetri, gjë që ndodhte sa nga presioni ideologjik i kohës aq dhe nga rezistenca e dobët që bënte ndaj përçudnimit artistik letërsia dhe në tërësi kultura jonë. Petro Çerkezi ishte më i lirë dhe jetonte më i çliruar. Esenini i thoshim jo vetëm prej pamjes, veçanërisht krehjes së flokëve, po edhe prej sjelljeve, kontaktet me letërsitë e huaja, bagazhi i madh i vjershave që njihte, dinte përmendsh dhe imitonte. Disa sjellje të tij ishin aq rebele sa ngjanin me një kontestim politik. Ai u derdh shpejt në formën e tij poetike, kallëp që ndryshoi pak gjatë kohës duke kërkuar një gjë, përsosjen dhe përkryerjen.

Mendoj që rritja më e madhe e Petro Çerkezit erdhi kur ai kaloi në prozë, nisi të shkruajë tregime dhe romane. Poezia vazhdoi ta furnizojë me lirikë prozën e tij, po ajo vetë, nën shembullin e prozës së madhe greke e ruse që ai i njeh kaq mirë dhe nën ndikimin e drejtpërdrejt të estetikës së Kadaresë, mik i tij i hershëm, shumë vepra të të cilit ai ka pasur mundësi t'i njohë që në lindjen e idesë, në projekt, i shtoi epikën dhe dramën. Tarreni ishte i gatshëm. Autori ishte lindur mbi kufijtë e prerë shqiptaro – grekë dhe në mes të jetës migroi në një shtet të vogël ishullor me kryeqytet të prerë nga kufijtë qiprioto – turq. Në vepra u shtua sfondi i madh, kontradikta dhe karakteret njerëzore që mund t'i pikturojë vetëm romani. Gjirokastra p.sh, aq shumë e përshkruar nga disa autorë, nën optikën e Petros merr një kolor tjetër, veçanërisht me dhënien e botës së krishtere të saj, siç ndodh me romanin "I megali eksodhos" – "Eksodi i madh".

Më i lirë se ne të tjerët në gjithçka, Petrua ishte më i lirë edhe etnikisht, në raportet e individit me kombin, gjuhën amtare dhe, në rastin e krijuesit, të realizuarit në të. Kjo ishte Tema e Brendshme, e Jetuara e tij. Komplekset e njeriut të pakicës ishin kapërcyer shpejt prej tij, duke mbetur temë për letërsinë e tij. Ajo që Sartri e quan "Ferri janë të tjerët", u ndje më shumë në dhjetëvjetshat në Qipro ku dramat etnike e të kufijve, të shpeshta në Ballkan, atje ishin shfaqur në një formë më vete. Këto tema orientuan jo vetëm krijimtarinë e tij të mirëfilltë letrare, po edhe përkthimet, zgjedhjet në autorët qipiot, siç ngjau p.sh. me tregimet e Kristos Haxhipapas, "Dashnorë nga raca armiqësore", poezinë e Mihali Pjeris "Metamorfozë qyteteshe" dhe këtë vit me romanin e shkrimtarit Emilios Solomu "Fluturoi shpejt si harabel" i vlerësuar me çmim evropian dhe i shumëpërkthyer tek ne etj. Këtu dua të theksoj atë që quhet "diplomaci kulturore", me insistimin e tij për përrkthimin dhe botimin e poezisë shqipe në shtetin fqinj, Greqinë. Në katër vjetët e fundit ka botuar në Athinë katër vëllime poetike bilingue: Miranda Için, poete gjirokastrite që rron në Bruksel, Moikom Zeqon, Natasha Lakon dhe këtë vit poetin laurat Rudolf Marku.

Mosha dhe fuqia e shkrimtarit nuk është gjithmonë në raport me moshën e tij biologjike, natyralen. Nga lidhjet e pandërprera që kemi ruajtur di se subjektet më dramatike dhe librat më me vlerë nuk janë shkruar ende nga Petrua. I tillë është p.sh. ajo që e flisnim "Romani i Dropullit", shkruar që në sistemin e kaluar, recensionuar e redaktuar, por që nuk u botua nga rënia e tij, të cilin në reçensën e tij Kadareja e vlerëson: "Kjo vepër është një tablo shoqërore me ngjyra të ndezura, një fushë e gjerë e lëruar nga parmënda deri në rrënjët më të thella, duke na dhënë personazhe dhe peizazhe të epokës së konflikteve të mëdha...". Një vepër për fshatin e lindjes, Poliçanin me manastire e shenjtorë që në shekullin e 11 – të dhe disa subjekte nga Qiprua, që mund të jenë një vështrim dhe kontribut i veçantë i autorit në letërsitë dhe kulturat bilingue dhe trajtimin e temave me në qendër etnitë dhe etniket. Është tamam koha për t'u shkruar e publikuar ato.

Rritja prej formës, siç e tregojnë dhe dy librat më të rinj poetikë të sapobotuara nga "Neraida", "Ti më këshillon të blej një bilbil" dhe "Qiell barok melankolie", vihet



re më lehtë në poezi, ndoshta se kjo është gjini më e ndjeshme, por edhe në prozë po të kemi parasysh suksesin e romanit të tij më të fundit "Sonatë për violinë dhe vaj" – «ΣΟΝΑΤΑ για βιολί και θρήνο» botuar në Athinë.

"Studioja e parë poetike, siç pohon poeti, ishte tradita e lirikës popullore, ajo polifoni pogonite kaq e njohur, tashmë e njohur edhe jashtë kufijve, që të rrëmben shpirtin dhe të bën poet".

Petro Çerkezi u bashkua që në fillim të lirisë, pas viteve 90 – të, me atë grup poetësh që punuan dhe punojnë për t'i dhënë një fytyrë të re moderne vjershërimit shqip. Poezia më e mirë e tyre tejkaloi një thjeshtësi naive e vargëzim të lehtë të poezisë së kaluar, i zgjeroi asaj përmasat dhe hapësirat, shtoi figuracionin dhe shtresat kuptimore të fjalëve, vuri në qendër dilemat shpirtërore të individit të sotëm etj. Në dy librat poetike që kemi në duar fokusi i poetit profilizon me tërësi ndjenjash dhe konceptim të qartë kompleksitetin kohor të njeriut bashkëkohor, labirinthin dedallor ku endet dhe udhëkryqin ekzistencial me një poezi që rezonon me bukurinë dhe agoninë për ecurinë drejt ndryshimeve epokale. Poeti vë në blancë të vërtetat jetësore të një bote të hapur dhe të lirë me atë poetike me dimensione njerëzore. Në finesën e poezisë së tij sa reale, por herë-herë rebele modelon intimitetin e natyrshëm, shartimin e suksesshëm që ka bërë me brilantet e lirikës popullore, na sjell identitetin individual ku vihen re luhatjet psiqike me shqetësimet substancore për një shoqëri humane të së arthmes. Sot shkruhet shumë poezi dhe tepërimet kanë bërë që eksperimentimet të mos jenë të suksesshme në të gjitha rastet. Dëm, pas mendimit tim, kanë sjellë abuzimi me metaforinë dhe braktisja e muzikalitetit, që janë tipare të lindura të poezisë. Te Petro Çerkezi është pikërisht tema ajo që e ka mbrojtur vjershërimin prej tyre. Duke flakur ideologjizmat dhe politizimet, ajo nuk ka humbur socialitetin dhe lëndën e vërtetë. Kështu, duke dhënë e duke marrë, ka ndikuar proza te ky shkrimtar si trinitet letrar, poet, prozator e përkthyes.

2023

Arti i ruajtjes së masës, romani "Një engjëll veshë me frak" nga Stefan Çapaliku

Dr. Belfjore Zifla

Romani nis me epigrafin "Çdo përngjasim me persona apo ngjarje konkrete nuk është i rastësishëm" dhe duke e përmbysur formën origjinale të stërpërdorur të shmangies së ngjashmërisë me realitetin. Rrëfimi i Çapalikut mbart personazhe dhe ngjarje të njohura në jetën urbane të Shkodrës, të mbrujtura me frymën e rrëfimeve me të cilat këto subjekte ishin veshur nga rrëfimi dhe rirrëfimi paratekstual dhe letrar. Megjithatë, në roman nuk kuptohet qartë se ku fillojnë e përfundojnë realja, imagjinata kolektive dhe ajo personale e shkrimtarit. Eleganca e rrëfimit mbështetet edhe në moskuptimin e këtij kufiri, duke përforcuar fuqinë e rrëfimit si prirje e gjithëhershme e njeriut, si nevojë primordiale. Në këtë rast, personazhi i Pol Gjakovës dhe ai i Klara Dedës, si dhe i figurave të tjera rreth tyre, veç pak dallojnë fonetikisht nga personat realë, që dëshmon se autori jovetëm që nuk ka frikë se mos kuptohet se vepra e tij është shëmbëlltyrë e realitetit, por madje e synon këtë identifikim, duke e bërë romanin edhe një lloj homazhi për këto figura ekscentrike, origjinale të jetës së qytetit e që kanë krijuar gati një mitologji moderne. Loja postmoderne e rrëfimit të asaj që është rrëfyer pafundësisht dhe krijuar e rikrijuar edhe para vetë autorit, e bën rolin e artistit sa interesant aq edhe të rrezikshëm, pasi kur në pavetëdijen kolektive rrëfimet futen në një formë të caktuar, refuzohet pranimi i çdo varianti tjetër. Tejkalimi i një sfide të tillë me elegancë dhe duke ruajtur masat e duhura në trajtimin e temave, në paraqitjen e alegorisë (shfaqja, teatri si rebelim shpirtëror ndaj sistemit), në aksionin e ngjarjes dhe në gjendjet e personazheve; realizohen vetëm përmes një kujdesi të veçantë për të ruajtur masën. Ruajtja e masës zbatohet edhe kundrejt lexuesit, pasi asnjëherë autori nuk abuzon me përkushtimin dhe kohën e tij.

Mendonte se dashuria ishte çelësi i gjithçkaje... Keqkuptim ky, që në përgjithësi shoqëron një të ri të dashuruar marrëzisht. Ajo s'kishte si ta merrte me mend, se në kokën e Pol Gjakovës ekzistonte edhe një dashuri tjetër, një agape, një dashuri për gjithçka, për të gjithë, për botën... Në këtë pasazh kondensohen dy dashuritë që e konsumojnë me intensitetin e tyre Pol Gjakovën dhe që çojnë përpara rrëfimin në vepër.

Fryma e tërë qytetit pushtohet nga koncerti i Pol Gjakovës, i cili arrin të shndërrohet në obsesion për të gjithë personazhet e përfshirë dhe së fundmi kaplon hipnotikisht të gjithë qytetin. Ideja e metaforës së artit si rebelim kundër pushtetit totalitar dhe ngurtësisë së tij, fryma e mistikës në nevojën e të gjithëve për artin dhe të bukurën, si nevojë e pashpjegueshme dhe universale, kontrasti mes kaosit që sjell forca e artit në jetën e pjesëmarrësve në shfaqje dhe rregulli i jashtëm që synon uniformitetin, janë pjesë e motiveve të romanit, të paraqitura edhe këto në masën e duhur, në formë aludive dhe jo përfundimtare. Gjendja e ethshme e tërë personazheve që i kaplon magjia e shfaqjes është në qendër sidomos të kapitujve të parë të romanit. Alegoria nuk rëndohet me fshehje torturuese, por shpërfaqet përmes shenjave që i jepen lexuesit, një tjetër hollësi që përforcon artin e hollë të ruajtjes së masës. Mund ta kuptojmë në fjalët e Dhimitër Dines, një jugor i emëruar nga sigurimi në Shkodër *Çfarë e çmendte atë për shembull, ishte dëshira e marrë e këtyre njerëzve për t'u marrë me art, me muzikë veçanërisht. Nuk arrinte të kuptonte sesi një gjysëm psikopati si Pol Gjakova, i shëmtuar, si një kalë gërdallë, të arrinte të mblidhte pas vetes djemtë, dhe mbi të gjitha femrat më të bukura të qytetit. Ata, por jo vetëm ata, krejt qyteti i bindej atij si të qe perëndi.* Mendja e kufizuar e Dines nuk mund ta kuptojë si arti mund të ndryshojë jetën e njeriut, apo si nevoja shpirtërore mund të jetë më e fortë se gjithë pengesat e rendit material. *Ai mund t'i mbante gjithë natën në prova dhe ata pastaj të shkonin në mëngjes në punë, të pagjumë, të pangrënë dhe pa u ndjerë aspak si të përdorur. Kulmi.*

I përkorë si stili i Çapalikut në këtë roman, është edhe personazhi kryesor, Pol Jakova me pamje aristokratike dhe me natyrë të mbyllur, i cili edhe dashurinë e marrë për Klarën nuk arrin dot ta artikulojë dhe banalitetin e seksualizimit të saj nga meshkuj të tjerë e refuzon me heshtjen dhe apatinë e tij. Ekscentrik dhe njëherësh i pëlqyer nga i gjithë qyteti, ai nuk përfiton dhe as e ndjen "stardom-in" e tij, përkundrazi zhytet në procesin e punës dhe krijimin e tij e barazon me vetë ekzistencën. Boshi i tij pas realizimit të premierës është veçori e artistëve të mëdhenj, që nuk e shohin artin si aksesor në jetën e tyre, por veten dhe ekzistencën vetjake e shkrijnë me krijimin. *Pra duhet ta mësosh veten, se mbas premierës duhet shkuar në shtëpi. Hahahahaha, kulmi! Më mirë të vdesësh sesa të shkosh menjëherë në shtëpi. Aty fillon epoka jote prej urithi dhe kjo nuk durohet më. Nis e përditshmja jote prej tenje. E përditshmja është e padurueshme.*

Gjendja e turbullirës mendore që e çon Polin drejt vetëvrasjes, nuk përshkruhet me thellësi për mendimin tim, por duhet kuptuar që estetika e autorit shkon harmonikisht me tërësinë e romanit, ku mosteprimi me cilëndo temë, do thoja se është princip themelor. Megjithatë, shkaqet janë të qarta, boshi i artistit pas realizimit të veprës me të cilën e ka barazuar qëllimin e ekzistencës së tij dhe dashuria obsesive, që vuan nga paaftësia e tij për të komunikuar ndjenjat e tij përveçse muzikalisht, që ngarkohet me thashethemet e pavërteta për Klarën dhe xhelozinë e sëmurë që ai nuk ia pohon as vetes së tij. Lind kështu engjëlli i veshë me frak, një krijesë naive, që jeton jashtë banalitetit të domosdoshëm për të siguruar ekzistencën në një kohë ku, si kafsha, instinktivisht, duhet të kesh përvetësuar cilësitë e përshtatjes dhe të kesh kuptuar armët e tua dhe vendin në zinxhirin ushqimor. Ndërgjegjja e njeriut në kohë të tilla nuk ka sesi të mos jetë e rënduar dhe romani përforcon disa momente ku gjatë rrëfimit jepet pesha që ndjen Maestro në ndërgjegje për shkak të persekutimit të të tjerëve rreth tij. *Do ia çoj Mihali Dardelit që t'i qepi një frak me rastin e premierës. Sot Maestro ishte edhe më i zbehtë se asnjëherë tjetër. Po ndodhnin gjëra të çuditshme te truri i tij. Po i bashkoheshin sendet, jeta ishte diçka tjetër nga arti, apo jo? Si një engjëll veshë me frak.* Titulli nuk është arbitrar, autori e lidh rrëfimin me të disa herë gjatë romanit.

Përgjithësisht, në romanet e Çapalikut ka një interes të veçantë për frymën e qytetit, që shprehet sa në mbrujtjen e subjekteve nisur nga histori të dëgjuara, gjallimin e personazheve që e krijojnë këtë frymë, por nga ana tjetër kërkimi i diçkaje përtej aspektit social të ngjarjeve, që do të shprehet nga ardhanaku Dine. *Prandaj Dhimitër Dine qe fiksuar që ta zbulonte me çdo mënyrë këtë mekanizëm të çuditshëm metafizik. Ai po përpiqej të kuptonte këtë qytet ose më mirë të thuash Qytetin m e "Q" të madhe. Shihej qartë se ishte inercia, gjendja e tij në lëvizje, që pavarësisht forcës ndaluese të komunizmit, vazhdonte të prodhonte dinamika nga më të çuditshmet.*

Njësoj si fraza e tij nuk rëndohet nga manierizmi dhe hiperfigurativiteti (shyqyr o Zot!), ashtu edhe tragjizmi dhe pesimizmi për kohën më të zymtë të Shqipërisë nuk e kaplon rrëfimin, i cili mbushet me komizëm, mirëdashje ndaj personazheve e tallje ndaj të tjerëve (vullnetarja e hekurudhës), humor dhe lehtësi, dashuri dhe pse jo edhe thashetheme. Nuk është turp të vendoset në qendër të romanit jeta në komunizëm, jeta dhe përditshmëria, e cila ka tragjizmin, padrejtësinë, shtypjen, shtrembërimin e njeriut e gjithçka tjetër që bëri dhe vazhdon të bëjë përmes pasojave të tij komunizmi në Shqipëri; por nga ana tjetër të tregohet edhe jeta dhe çastet kur njeriu ia ka dalë të jetë i lirë në format e shpikura prej tij në kësi rrethanash, të tilla si kjo shfaqje që elektrizon romanin. Edhe pse më vonë të gjithë pjesëmarrësit në të do pasohen nga dënimet, për një moment liria arrihet.

Jam veçanërisht e tërhequr nga raste kur shkrimtari përmes një skene në miniaturë arrij të tregojë gjithçka për sistemin, kohën dhe psikologjinë njerëzore. Për shembull një skenë e tillë më kujtohet përherë nga "Lehtësia" e Kunderës, kur në lokal Tereza ndërvepron me disa forma të pushtetit mbi të, të mishëruara nga meshkujt. Në romanin e Çapalikut, për mua, një skenë e tillë e ngjashme nga fuqia e kondensimit të kuptimit është ajo ku Dh. Dine vendos të shkatërrojë Dianën. *Ose ta linte Dianën të lirë të shkonte dhe vetë të mbetej në kornizën e një vagabondi ordiner, që kishte dashur të shfrytëzonte pozitën për të futur në dorë një vajzë, ose të merrte pozicionin zyrtar dhe ta çonte deri në fund maskarallëkun e vet. Dhe Dhimitër Dine vendosi të bënte të dytën.* Si forca e pushtetit, ashtu edhe kompleksi mashkullor shpërfaqen në një skenë tepër të shkurtër, shumëçka tjetër lexuesi mund ta marrë me mend. Dhe po, ky është një roman që e ruan masën edhe sepse e lejon lexuesin "të marrë me mend", të aludojë, hamendësojë, kuptojë dhe përfytyrojë.



Xhevair Lleshi

AMBASADORI SHËTITËS

dy fragmente nga romani në proces

1.

Përsiatja, përqendrimi i vullnetit, pendesat, agjërimet: ja çelësat që të hapin dyert e kësaj bote. Toni, duke iu drejtuar Dhjatës së Vjetër hebraike, e cila është e mbushur plot me profetë, krijon një përfytyrim të gjerë shpirtëror tek ata që parashikonin disa ngjarje shumë të mëdha historike nëpërmjet paralajmërimeve, kërcënimeve dhe simboleve, pa ndonjë mundim shumë të madh të vullnetit, me një ushtrim të vazhdueshëm të përqendrimit tek pikësynimet e larta shpirtërore, një mospërfillje dhe një përçmim ndaj rehatisë materiale me të cilën njerëzit e çdo epoke dhe të çdo vendi janë pak a shumë të mbërthyer. Zoti nuk ia fal hirësinë e tij veç atij që e ka hak atë, po ku është e mundur vallë të zbulohet Zoti përveç se tek ne vetë? Sekreti i jetës dhe i qenies qëndron në kishëzën tonë më të vogël, prandaj brenda nesh gjendet çelësi për t'ia dalë mbanë... Toni hodhi vështrimin lart ku qielli dukej edhe më blu, por mund të vije re fare lehtë një dritë të fshehur, që duket sikur shpërthen në sytë e njeriut më të dashur që ka pranë, me një butësi prej flatrash që bie pa lëvizur në pranverën e bulëzuar, ku ka mbështetur bërrylat dhe kryet në pëllëmbë. Meditimi i tij aq i njohur, prej parashikuesi të madh. Ai parashikim tronditi gjithë mediat. Një muaj më parë: «Më 28 shkurt 2022 Rusia sulmon Ukrainën!»

Gjatë jogës së tij ai vijonte meditimin. Në gjithë këtë lind edhe nevoja që të hapësh shumë sytë nga gabimi i përgjithshëm i cili bën të ndërhyjë një humnerë e pafund midis trupit dhe shpirtit dhe, në përmasa më të gjera, midis shpirtit dhe materies. Këto dallime, të cilat vlejnë për planin tonë jetësor, shpesh merren si ndarje absolute, edhe pse spekulimi filozofik modern dhe shkenca fizio-kimike e këtyre kohëve të fundit ka bërë gjithçka për t'i afruar. Në historinë e filozofisë kemi shembuj kuptimplotë dhe që flasin vetë për mjetet dhe - le t'i quajmë kështu - për mënyrat të cilave qenë të detyruar t'u drejtoheshin spiritualistët tradicionalë (për të cilët qëndronte ende në fuqi kjo ndarje) që të arrinin të gjenin një shpjegim të pranueshëm të ndërkëmbimit të ngushtë të pamohueshëm midis dy elementeve për të cilët bëhet fjalë. Mjafton të kujtojmë të famshmen «harmoninë e paracaktuar» të Laibnicit...

Por këtë nuk e bën dot ai që nuk sheh se «trupi» ka një rëndësi shumë të madhe në përgatitjen që duhet për të fuqizuar aftësitë tona, deri në atë pikë sa të tejkalojnë kufijtë shqisorë dhe mendorë të dhënë për personalitetin njerëzor. Kjo sepse s'mund ta cilësojmë sesi një tejkalim të këtij lloji fuqinë për të paraparë dhe për të parathënë atë që ende nuk ka ndodhur, atë që gjendet ende jashtë rrethit të ndodhive. Atëherë, mendonte Toni, ideja lulëzon dhe vallëzon nëpër drurin e fatit, që befas bëhet tryezë buke dhe mundet violinë, ku mendimet përplasen e puthen, duke rënë pa peshë e gati pa frymë.

A nuk duhet, në raste të tilla, të mbahet parasysh psikoza që krijohet tek personaliteti i besimtarëve fetarë, të cilët janë të prirë për vetë natyrën e tyre t'i besojnë asaj që dikush i interesuar mund t'u thotë rreth vërtetësisë së hamendësuar për një ndodhi të paraparë dhe të parathënë? A nuk kemi të bëjmë këtu me gjëra që, në përgjithësi, i shpëtojnë kontrollit të njerëzve, megjithëse ato shfaqen në shikim të parë si jo të vështira për t'u vërtetuar? Situatë jo aq trishtuese, i thoshte vetes Toni, më tepër është gazmore sikur do të japë një kumt, që vjen tek unë dhe shkëputet prej meditimit të thellë, ndërsa bie ndajnata në kishëzën time me shumë dritë. Ndaj dhe parashoh. Së këndejmi duket e thjeshtë. Por ja që është e pamohueshme se përcaktimi në mënyrë empirike i pranisë së gjërave të tilla nuk është i lehtë, edhe pse elementë të shumtë ndërhyjnë dhe ndihmojnë për të shkaktuar iluzionin e përfytyrimit, të dëgjimit, të nuhatjes, të shijes dhe të prekjes. Dhe është gjithashtu e vërtetë që midis njerëzve, me përjashtim të fanatikëve, të atyre që vuajnë nga halucinacionet, të të mashtruarve, ka çrregullime, po aq sa dhe ndoshta edhe më të shumta, tek falsifikuesit dhe tek besimtarët e rremë, të cilët bëjnë gjithçka që është në dorën e tyre për ta veshur gënjeshtrën me rrobën e së vërtetës, dhe këtë e bëjnë për të kënaqur qëllimet e tyre vetjake dhe sektare. Edhe pse humbasin dhe platiten në dritën e fundit dhe errësira bie sërish, saqë vërtet çmendesh prej bukurisë së mrekullueshme e të ndritshme të parashikimit të së ardhmes, pa pikën e komplikimit.

Toni thoshte me vete: mund të jesh i trishtuar prej dëshirave, duke i dëbuar krejt nga jeta dhe të merresh me errësirën me dritë blu të errët të meditimit, që natyrisht është një trishtim më vete, ndoshta edhe prej frymës drithëruese që të tundon brenda paraparjes së të ardhmes, të ngjarjeve që të rrethojnë apo pritet të ndodhin tek akcili, bashkë me dëshirat, dëbuar nga jeta e tij. Për çdo gjë ai kish arritur të komunikonte mendërisht me të dashurën e tij, Janën:

«E kemi fjalën për të panjohurat që na presin.» (Mendoi Toni dhe e shënoi në telefon. E diel. Ora 12.23.) «Mezi e përmbaja një valë të lehtë nervozizmi nga lodhja dhe as që doja t›ia dija që ai mendim është i panjohur.» (Mendoi Jana dhe e shënoi në telefon. E diel. Ora 12.28.) «Vetëm si qyq s'hahet drekë, apo jo?» (Mendoi Toni dhe e shënoi në telefon. E diel. Ora 12.33.) «Jo, mua për vete më pëlqen!» (Mendoi Jana dhe e shënoi në telefon. E diel. Ora 12.38.) «Zakonisht unë përgjoj natën me një ndjeshmëri prej ujku!» (Mendoi Toni dhe e shënoi në telefon. E diel. Ora 12.44.)... (Kur do të takoheshin do të këmbenin shënimet me njëri-tjetrin.)

Ç›punë qenkej kjo e parashikimit? Toni mërzitej shpejt kur ishte pa Janën. Nuk shtyhet tërë kohën e perëndisë duke parashikuar të nesërmen. Punë e bukur por tepër e vështirë. Ndryshe mund t'i biesh kokës me grushte e të mallkosh ditën që ke lindur. Se ajo që parashohim flet me muret, përsëritet në të njëjtat parafytyrime vend e pa vend dhe ngatërrohen punët bëhen lëmsh. Një hata që shtohet e shtohet nga sekonda në sekondë dhe njerëzit rrinë zgjuar, ose flenë me sy hapur. Parashikimet janë si ëndrrat, kapërcejnë detin, shkapërderdhet qiell e tokë bashkë, vegime të pamundura, flet me gjuhë të pabesueshme, hingëllin në kasollet që bëhen auditorë, jep alarme, bën luftë me viganët e mëdhenj, fluturon në skena cirku, bën vokalica me tinguj zërash të padëgjuar kurrë, u jep të puthura dashnoreve që s'i ke pasur kurrë, por ama ai që dashuron e ka të shkruar në ballë...

- Ky shpik, i ziu, po kur flet për vendet që s'i ka parë, prapëseprapë të vështirë e ka...

- Ashtu më vjen. E ndjej... Edhe e nesërmja vetë është një vend që s'e ke parë.

- E po me atë që s'ka ndodhur nuk flasim dot, apo jo?

- Flasim sot dhe dëgjohemi ditën që e kemi lënë...

- E kujt i ngjan kjo?

- Yjeve të shuar që na vijnë pas miliona vitesh...

- Epo...., ne atëherë nuk do të jemi...

- S'ka gjë. E shkruajmë në letër, vëmë emrat tanë, e vendosim në shishe plastike, se këto rrojnë mijëra vite!) dhe e hedhim në det. Pas asaj kohe të gjatë dikush i asaj ere të largët do ta gjejë shishen dhe do ta lexojë shënimin tonë... Gjë e bukur...

2.

Përsëri e njëjta gjë. Rri e mendoj. Femra dhe reklama lëbyrëse. Mendohem thellë, thith ajër të freskët nate dhe teshtij. E di, të gjitha të takojnë ty, e dashur. Po ja që unë jam gatuar ndryshe. E përhapëm vetë namin e fallit dhe hajt përmbaje tani. Se falli parashikim është. Ç'do të bëhet, se ç'është bërë e dimë. Si premtimet e mia, po të mos i kisha thënë, do të qenë ndryshe parashikime, e shtrenjta ime! Pas realizimit të atyre që të kam premtuar ti më fal një buzëqeshje.

- Mjafton gruaja e parë, këshilltare, që do t'i bësh autopsinë e parashikimit, Toni!

- Ia kam frikën këtij përqendrimi, se mos e përpij, - u përgjigj ai duke qeshur.

- E kemi fjalën sa ujë do të pijë parashikimi...

- Epo këtu do të ketë vend edhe plani im dhe kështu bëhet politike.

- Pak fjalë, siç bëjnë arixheshkat...

- Të njoftoi këshilltarja, apo ende jo? E kërkoi vetë, këtu në fshat?

- Siç e lamë, këtu në fshat! Ka të bëjë edhe mjedisi frymëzues. Se parashikimi do frymëzim. Unë të kuptoj mirëfilli. Pooo, cili qenka plani yt? Ai, politiku, de!

- Nuk thuhet, përndryshe filmi digjet. Mirë?

- Bukuri. Ashtu të bëhet. Unë aty do të jem pas gardhit. Se mos e bën si me vjehrrin e Dakut, Breshko beun nga Ferrasi, që, me të qeshur, me të ngjeshur, ia nxore lakrat sheshit...

- Jo, pa merak, Jana. Dhe mos harro këshilltare dhe jo këshilltar. Më tepër se kaq: këshilltare ministri... Numri i tyre është gjigant...

Kur Toni i përmendte emrin, do të ishte sinjal, paralajmërim. Boll. Lëre me kaq. Dhe përsëri u krodh në të thella. Ishte hera e parë që vepronte ashtu. Vret më shumë, thjesht me pambuk. Mirëpo një burrë i fortë që e nxjerr arin prej gurit, që nuk e vë në kandar moralin, s'ka pse merret me të tilla plane. Troç. Saktë. Prerë. Tri fjali. E ardhmja me një sy që nuk i dridhet qerpiku. Zbërthim në faktorë. «Se dashuria s'ka moral po vetëm pasion të verbër...» shkruan poeti. Fjalia e parë një ngatërresë e paqartë. Fjalia e dytë synimi i fshehtë i asaj që do parashikohet, fati i saj i madh, miliona euro në dorën e saj. Fjalia e tretë: mbulesa. Letër karameleje... Unë e di se ç'them e ç'bëj. I di të gjitha ato që kanë planifikuar fondet e Bashkimit Evropian për fshatin dhe bujqësinë, prandaj dhe parashikimi, falli, hidhet në fshat. Tri fjali, tri shtylla mbështetëse që mbajnë në këmbë historinë e bukur të së ardhmes...

E nesërmja erdhi shpejt dhe pa u ndjerë. E zonja e bujtinës ku po kalonin ato ditë, ishte marrë vesh që më parë se çfarë u pëlqente të hanin në mëngjes. Toni pëlqente një kupë verë mjalti dhe një shkurtë. Bujtina e saj rriste shkurta dhe thëllëza. Vezët pikaloshe ishin një mahni gatimi. E zonja e bujtinës i ngjyente shkurtat me mjaltë dhe ato krijonin pamje spektakulare. Aty sikur gatuhej zemërgjerësia e mëshirës. Është pikërisht kjo ndjesi që s'të lë të turpërohesh...

Matanë kasolles u dëgjua zilja e celularit të Janës. Dhe biseda e saj me përgjigje të shkurtra. Po mbërrinte këshilltarja. E di që kjo këshilltare i ka sytë disi të turbullt? Sigurisht që e di. Sy më sy bëhet analiza dhe sinteza bashkë. Aty vritet gjahu. Pastaj korr e mos lidh. Jo! Korr edhe lidh. Fjalët e tepërta janë fukarallëk. Ndjesi e fortë. Mendimi i shkurtër godet në shenjë...

Takimi ndodhi siç qe parashikuar. E pa fort. Ajo u rrëqeth dhe ai e ndjeu.

Ai: Mirë se erdhe!

Ajo: Përshëndetje!

Ai: S'dua ta vras mendjen si ndodh kjo që do të them, por ajo që do të shoh në sytë e tu. Sy të kthjellët fare. Sy që shohin dhe e kapin mendimin që rreh larg. Unë do të them ç'shoh. Do përcaktojmë, me marrëveshje fjale: ana sentimentale, e pasurisë apo e profesionit, e begraundit?

Ajo: E pasurisë. Më pëlqen.

Në të vërtetë ai e kishte menduar të thurur me kujdes se do të thoshte të njëjtat gjëra për të projektuar atë që do të ndodhte, veshur me rrobat e interesit të saj.

Ai: Të gjitha janë rregulluar sipas mekanizmit të sahatit...

Ajo: Ç'po sheh?

Ai: Sytë e tu e shprehin hapur atë që do të ndodhë. Zot!... Çfarë pasurie shoh! Një hapësirë e pamasë! Para e madhe që vjen nga larg. Të huton. Siguri e madhe. Shtëpi fshati, stalla lopësh e viçash. Serra pa fund. Sy të mbuluar me parà. Fshatarët shohim ne padurim dhe janë krejt të hutuar. Ata që të duhen i krijon vetë. Dhe ujët kalon nën dyshek pa u ndjerë...

Ajo: Si t'i kuptoj këto?

Ai: Ashtu siç janë, një mrekulli.

Ajo: Varen nga unë?

Ai: Vetëm nga ti. Këtë e shprehin qartë sytë e tu. Nuk është dëshirë, por siguri. Ka për të ndodhur se s'bën! E shoh përqendrimin tënd të jashtëzakonshëm...

«E kuptova», mendoi ajo dhe këmbët iu drodhën sikur ta kishte kapur sëmundja e tokës. Në të vërtetë ajo ishte në ethe, por jo nga e papritura. «Ato janë fondet e BE, por ky qyqari, nuk e di. S'ka si ta dijë...» Këshilltarja u ngrit. Mori të dhënat që duheshin, numrin e llogarisë së OJF-së së tyre dhe donte të hynte brenda në makinë, të cilën e mbante hapur një djalë i gjatë, shoqëruesi.

- Jo, - i tha Jana, - ne nuk punojmë me numër llogarie. Nuk ua kemi kujt as nge dhe as borxh. Vetëm me parà në dorë...

Si duket ata i kishin marrë masat. Shoqëruesi i la zarfin në dorë Janës.

Sytë e këshilltares ishin zmadhuar aq sa s'mbanin më dhe drita e fshehur e ndriçonte të tërën, me një tymnajë të kaltër si një harresë fenomenale. Ashtu ndodhi, siç e kishin parashikuar, ndërsa Toni mezi e përmbante veten nën efektin e një zhgënjimi trullosës.

Më në fund u ulën në tryezë dhe hëngrën ato që u bujti e zonja e bujtinës. Qeshnin, llafosnin për hallet e fshatit me të, më the e të thashë, si njerëz që e ndjeni dhe e kuptonin njëri-tjetrin...

Zonja e bujtinës i tha Tonit një falemnderit (dhe jo *faleminderit*) po sytë nuk iu zmadhuan me atë dritën e këshilltares. Mos duhet t'i parashtronte edhe asaj të ardhmen. Gratë vdesin për një çikë paraparje fati, që ua zgjon zemrën nga dremka. Ai nuk mund të harronte që gratë duan gjithnjë e më shumë vëmendje të ëmbël, se ende duan të shtyhen pafund gjer në infinit...

Ra celulari i Janës.

- Kush ishte?

- Një deputet i shumicës, - pëshpëriti ajo.

- Po, më ngjan se funksionoi...

Kështu kaloi dimri. Një nga një këshilltarët e panumërt, pararendësit e ministrave dhe deputetëve ranë në rrjetën e Tonit. Ai nuk i shtyu, nuk i trazoi për ndjenjat rreth liderit, por u mor me parashikimet e fatit. Asgjë. Një parashikim shtatëqind mijë lekë të reja. Në dorë. Në pranverë pritej edhe shpërthim i lëngjeve të pemëve, por edhe shpërthim social...

Roland Gjoza

Të gjitha u thinjët ju dashnore të shirave

poezi

TË GJITHA U THINJËT JU DASHNORE TË SHIRAVE

të gjitha u thinjët ju dashnore të shirave
dhe dëbornave të auditoreve
kur putheshim
me aq besim te dashuria
sa mund të nxirrnim diellin prej reve
me buzët
dhe gjuhën që shtyhej
gjer te psherëtima
harronim çantat me libra nëpër takime
se ishte koha e poezive
koha e shpirtit
tani jeni thinjur
blini bojë me çmim të lirë
për hir të kujtimeve
gjysma e vitrinave për ju janë krijuar
ishit aq të bukura
sa nuk na besohet që u vyshkët si lulet
dhe jeni në kohën që do të bini
edhe sikur kjo të ndodhë
gjysma e vitrinave për ju do të mbetet
dhe gjysma tjetër për vajzat tuaja
na harruat
se na humbi djalëria
s'dinim më të puthnim
mjaftonte shkopi dhe një kapele
një kafe diku që të gremiseshim në kujtime
për gërmadhat s'mund të ketë vitrina
ju
edhe duke rënë si petlat që bien nga vazoja me lule
prapseprap lule mbetët
ju heq kapelen
dashnore të auditoreve
të kohës së poezive
dhe të shpirtit.

EJA NE NJU JORK

eja në nju jork në orën që lind
dhe ora që lind është kur zogjtë cicërojnë
dhe grataçielave iu rrëshqet dielli foshnje
dhe oqeani është vendi ku pagëzohet
dhe një meshë fëshfërimash dëgjohet
mbi kapelet e grave
dhe pulëbardhat e mëdha të oqeanit mbi fashion avenju
Iu bien tambureve të ajrit për psalmet
edhe këtu si kudo
veç madhështia të kujton perënditë
kur iu shfaqeshin njerëzve të zgjedhur
dhe ti je e zgjedhur
prandaj u shpikën grataçielat
se e dinin që ti do të vije
këtu një puthje është sikur ke vënë buzët në qiell
po më mirë ti eja kur ora rritet
dhe njujorkezët nxitojnë sikur marrin vrull të ngjiten për të pritur mesinë
po nga banka në bankë shkojnë, s'kanë rrugë tjetër
me fytyra jeshile si dallari i prerë freskët
ne të dy s'kemi punë me dollarin kërcitës
po me dashurinë
le të puthemi në cirkuid kolomb
duke provuar se edhe puthja është e rrumbullakët si bota
këtu puthjet rëndom janë me pagesë
po ne i paguajmë duke këmbyer zemrat
e dashur, më mirë eja kur ora vdes
atëherë kur heminguej bëri vetëvrasje nga depresioni I thellë
kur muzgu bie përmes grataçielave si një vajzë që hidhet nga kati dyqind e pesë
po nuk vdes
se e presim ne
ngaqë ti vjen me vetëdijen e jetës
dhe unë gjithashtu si një shkrimtar që s'gëzoi asgjë në kohën e vet
dhe bën vetëvrasje para syve të tu të zgjuar
duke ta përseritur shpesh si ide
se nju jorku nuk mund të shijohet pa dramacitet
po unë e di, ti do të vish kur ora lind
dhe diellit foshnje që pagëzohet do t'i vesh emrin tënd
dhe unë s'do të jem ky që jam
po ai djaloshi tetëmbëdhjetëvjeçar që të tha I pari; të dashuroj!
ti më mirë eja kur ora lind
se atëherë është koha e dashurisë

NXITIM NJUJORKEZ

këtu
në nju jork
njerëzit nxitojnë
nxitojnë
o zot
sa shumë që nxitojnë!
dhe varrezat i kanë pranë banesave
për të mos humbur kohë.

DO TE BEHESH POET?

do të bëhesh poet?
eja në amerikë
këtu do të gjesh mërzinë dhe vetminë
dy bija të parnasit metalik
po ti s'vjen
ta di kokën
amerikën e shikon kur kthen me fund gotën!
mëngjeset e praruara
gjinkallat që çirren dhe japin frymën buzë bulevardeve
ty s'të bëjnë përshtypje më
ke mbetur te vargu që shkrove para njëzetë vjetëve
tani përdor shprehjen; varja, plako!
s'vë re as perëndimin
aq të freskët
sikur dielli ka ndërruar vend me agimin
pantallona të shkurtra
zbathur
shtyn ditët ne plazh dhe në muzg
kthehesh si turtulli në fole
në tiranën e zhurmshme me pluhur
ndoshta ndërron mendje dhe vjen
po ta dish
këtu të presin piramidat
dhe sfinksi
egjipti i ri ende s'ka mbaruar
kurrizin do të thyesh në punë
shefit do t'i bësh lajka
se ndryshe të flakë në rrugë
si këlysh bushtre
ta di kokën
ti s'vjen
amerikën e shikon kur kthen me fund gotën!
më mirë që s'vjen
rri aty ku je
mes zhurmës dhe pluhurit të tiranës
ku përditë te papunet shkruajne nëpër mure
jeta o qef!..
dhe ti e shtyn si mundesh
më mbeti të grindem i vetëm me dy bijat e parnasit
dhe të pëshpëris atë shprehjen tënde; varja, plako!
se edhe unë prej poezisë s'nxora gjë
në botën e dollarit

NJU JORKU SI LEONARDO DA VINÇI

jam si ajo mola në kostumin që shkoi për oskar
gjithsesi dhe çmimet e mëdha
e kanë nga një varrmihës të padukshem

. . .

i jam futur nju jorkut, jo si mag
as si turist
që e përshkon atë për një javë dhe s'e kupton
i jam futur nju jorkut si një krimb që ta kalb
të bjerë dhe të lulëzojë sërish
jo si morgan
po si leonardo da vinçi

. . .

e zgjidha përfundimisht
nuk do të udhëtoj më për amerikë
është kaq e thjeshtë
me një boing inxhinjerik
në ajër
mbi ujëra
e ç'me pret atje?
një numër!
do të udhëtoj brenda vetes
të përshkoj shekujt së prapthi
gjersa të arrijë te krishti.

. . .

me një migjen si kostum
me një kapele si mjedë
me një bastun si poradec
do t'i hyj nju jorkut mespërmes
i pakuptueshëm do të jem
si një vend i vogël që s'përkthehet
dhe s'e njohin të mëdhenjtë
(talentet piqen dhe kalben në degë
dhe bien dhe treten në pleh)
kokëfortë këndoj si ata!
nostalgjia i lë prapa ballkanasit
s'më do të tillë uitmani!

E ZBEHTË ISHE MBRËMË

e zbehtë ishe mbrëmë
po e kaluam me një heshtje prej mbrëmjeje
i zbehtë isha unë
po shkoi ashtu si lumi nën urë
s'tregojmë më asgjë për vete
ç›kishim e dhamë për fëmijët që u rritën
dy qënie pa brendësi
dy boshësi që plotësojne dy plotësi
tani s'kemi ç'japim më
e zbehtë ishe mbrëmë
po e kaluam me një heshtje prej mbrëmjeje
i zbehtë isha unë
po shkoi ashtu si lumi nën urë
kur të vijë vdekja kemi vdekur qëkur

SHPIRT, MOS U TRISHTO

shpirt, mos u trishto
shpirt
ti ishe grua e bukur shumë
tani je prishur
hiret të shkuan bashkë me sapunin dhe ujin
ilaçin e enëve
stufën që të shkriu si qiriri kur gatuan
ç›t›i bësh,
bashkë me pleqërinë
zoti të merr dhe bukurinë
po duhet ta falenderojmë, e dashur
t'i heqim kapelen
se na shtoi dashurinë
ti për mua je një bijë më tepër
unë për ty një bir
u ngatërrua kjo punë
lëmsh u bë dashuria
dhe kjo ndodhi, e dashur
se humbëm bukurinë
vyshkja e lulkës së buzkës
dhe rrudhkat si shi
na shëmtuan
po na shtuan dhëmbshurinë
në jetë jemi hije ne dritë
në kujtime realë si dielli
ata që kujtojmë kur flasim nën drurë
të famshmit e asaj kohe
kanë vdekur qëkur
po ne me ata ndjehemi të lumtur
le të shpikë ipod jobs
microsoft bill gejts
për ne shpikja më e madhe
është kujtimi

dhe sa gënjejmë
dhe sa na shkon gënjeshtra
ushqim zogjsh për dashurinë

thërrime
jeta!

JAM NJË PROBLEM AMERIKAN

jam një problem amerikan
sepse nuk konsumoj si më parë
gris këpucë më pak
nuk eci shumë dhe kostume s'ndërroj më
se takimet më të shpeshtë i kam me zogjtë dhe pemët
po këtë e mbaj të fshehtë
se përndryshe do të më quajnë të çmendur
jam antikonsumist
dhe antikonformist i pandreqshëm
më mirë të shkoj
të thyej qafën

të mos merrem me kujtime dhe të kruaj
xhepat e zbrazur
jam në vendin e parasë
në qarkullimin e saj atletik të rekordeve të
mëdha
jam një mundësi për bypass
një problem amerikan
të kuptosh që ke vdekur kur s'nxjerr më
para
jam një problem amerikan

KAM PUNË ME NATËN

e lashë mëngjesin
dhe mesditën
me natën kam punë
s'ka njerëz
të gjithë flenë
fillikat i vetmuar endem nën yje

anjë yll s'fitova në jetë
po yje të rremë sa të duash
thonë atje lart më presin shpirtrat
unë pres të më dalin
flatrat nën sqetull

do fluturoj?
kurrë s'fluturova në jetë
po si krimb u zvarrita dhe si krimb po e
mbyll
në një rrokaqiell në manhattan
në një rrugë të madhe
që i thonë fashion avenue

po s'jam i trishtuar
as i zhgënjyer
sa frymë nuk lindën dot?
unë e pata këtë fat
të shoh më në fund amerikën
dhe stiv jobs

jo
s'është pak
po vonë është për mua, tepër vonë
të ndërroj fjalën e bukur me dollarin
po duhet ndërruar
që të më heq kapelen
dhe të më nderojë
mister morgani

njerëzit flenë dhe unë i vetëm
pres të marr pasaportë nga nata
dhe të nisem për andej
ndoshta udhës takoj krishtin
unë ngjitem
ai zbret

atje poshtë prap e pret ndeshkimi
populli si dele
që thirri dje mesia
do ta kryqëzojë në shtyllë përsëri
krishti do të japë shpirt si bandit
barabë banditi do të shpallet i lirë

t'ia them?
ai s'dëgjon njeri
po ndoshta ma vë veshin dhe kthehet
pa krisht a jetohet në qiell?
në tokë e pata të vështirë
po shëmbulli i tij më ndoqi
të paktën
nëpër shkrime

pres të ngjitem në natën me yje
me një mundësi krishti në qiell
po sikur dhe atje ta kenë kryqëzuar
ta gjejë në golgotë duke dhënë shpirt?

jo, o zot
në sytë e tu të ndodhë kjo mynxyrë?
mos qoftë!
i vetmi ngushëllim në këtë natë me yje
s'kam tjetër
dhe po të kisha
prap krisht do të qe!

NDIZ NJË QIRI PËR VETEN

të lënë të gjitha
as me vetveten s'gjen qetësi
s'ka asgjë besnike në këtë jetë
dhe shkrimi të lë një ditë
dhe kur vdes
zoti të ka braktisur
prandaj
ndiz një qiri për veten
kur shkruan poezinë më të mirë
dhe kujto fundin e pashmangshëm që të
pret
ndonëse sepjet e ftohta me limon dhe vera
e kuqe e kilit të shijojnë shumë
dhe gruaja që ke pranë
seksin të jep me epshin më të bukur
mos harro
ndiz një qiri për veten
dhe kur je më i gëzuar se kurrë
dhe kur lavdinë ke prekur

MË VJEN ZËRI I NËNËS

më vjen zëri i nënës
me çfarë e do bukën, landush?
unë po lexoja eseninin, ishte mbrëmje me
hënë
më lerë rehat, nënë
lere librin dhe më kthe përgjigje
me çfarë e do bukën, po të pyes
me qumështin që derdh hëna mbi
beriozkat,
jo me qumësht, se hënën po e pijnë kuajt
nëna i thoshte babait kur vajtën për të
fjetur
yt bir ka rrjedhur, ti i ke fajet, ta dish
kështu ka lindur, çyryk, ia kthente babai
c't'i bëj unë i ziu?
çoje për vizitë te mjeku që nesër
shpjegoja doktor luzit si e qysh
po sikur ta shtrojnë te pesa?
kush i dëgjon fqinjët cmirëzinj
kushedi ç'nofkë do t'i ngjisin djalit
mund ta quajnë dhe budalla të lindur
m'u bëfshin kurban, m'u bëfshin
ata të shikojnë të tyret
lere, mos ma nga landushin
me okë le t'i thotë marrëzirat
ia dëgjon kjo kockë dhe s'pyes për njeri
i hedh ca kripë në baluket e verdha
që të mos ma marrin më sysh
unë qeshja
ata të gjorë s'kish si ta dinin
se esenini me lirikat ishte pesa
dhe unë vërtet isha i çmendur
si të gjithë poetët

KOHA E MISHIT

kudo që shkoj vitrinat si sirenat, po homer
nuk shoh
klubet e natës digjen nga uiski dhe xhini
me flakë varieteje
dhe teatrot e broduejt banalizojnë
shekspirin
libra gjej nëpër trena dhe stola
në parqe publikë
gruaja vjen nga afërdita dhe burri nga
marsi
e kanë lenë përgjysmë
me një shenjë puthjeje
romanin
e rëndë puna dhe e ndyrë
s'durohet
për 15 dollarë ora të lashë dhe të fshish 25
wc, kthehu nga atlantic city dhe luaj
për fitore
pirro bie më shpesh me një tullë pas koke
kush është më me fat
fiton si cezari
te moma një makinë e vjetër
plot me gazeta të ngjitura
dhe një nudo blu
në rrugë dhe metro
artistë nga amerika e jugut
kërcejnë tango për një dollar
të dehur, të bërë tapë
shurrojnë nën monumentin e edgar allan
poe
nju jorku i droguar
s'di ç'të bëjë prej qejfit
është gati të lerë yjet me barrë
s'ka asgjë tjetër përveç kënaqësisë
dhe instinktet luajnë jetën e lumtur
duke prerë damarët
ç'të bëjmë? asgjë!
përseritja e përgjigjeve nga gilgameshi gjer
te ulisi i xhojsit është ndërprerë

te gota e birrës dhe uiskit
kanë dalë jashtë mode hollivudi, shpikjet
teknologjike
syri i dehur shikon lart galaktikën
për ndonjë ronde vu me hawking që ka
ngecur te vrimat e zeza
të gjitha u shijuan
mishi u nginj, gati sa s'plas
shpirt s'ka më sepse vuajtja prej kohësh
është vrarë
take it easy
formula e bombës atomike të mishit
po të plasë
na vjen në ndihmë elon musk me raketat
planetare
turistike
koha e mishit!
take it easy!

KOHA IME

e kërkova në qytet, nuk e gjeta
askund tjetër nuk ishte koha ime
sa herë hapeshin ekspozita apo panaire
sa herë jepeshin çmime
koha e të tjerëve ishte
e imja s'ekzistonte
isha njeriu pa kohë
kështu mendova
po kujtimet tjetër gjë më tregonin
kujtimet e milionta
tani jam në amerikë dhe është e kotë ta
kërkoj
veç të rrëmoj se mos e gjej në dollarin që
djersin
në mallin e plagosur
fashuar gjer në grykë
një peshkaqen i verdhë ngriti bishtin me
dy shpata të kryqëzuara
në atlantik
dhe hapi gojën të më hante
pastaj u ngrit në ajër me flatra të flakta
prej ari
dhe m'u soll rrotull e rrotull pa u ndalur
gjersa më futi në rrethin e tij vrudullues
ai paskësh qenë
peshkaqeni i verdhë i kohës sime
që e hëngri me babëzi gjer në sekondën e
fundit
tani kisha mbetur vetëm unë
njeriu me kohë të mbaruar
e ç'donte akoma?
isha kockë e lëkurë
po kishte mbetur një pikë
një pikë në fund të kohës sime
e hëngri dhe atë dhe u zhduk

TYMI

shoh tym që del prej shtratit në agim
shoh tym që del nga librat, fletoret,
kompjuteri i ndezur
shoh tym dhe në lirikën më të bukur të
dashurisë që gjithmonë e shkruan
esenini
shoh tym
digjen ditët e mia bashkë me netët e mia
dhe unë mbetem kufomë pa takime në
netët me yje
në barin me vesë që i shtroja përsipër
xhaketën time
ku të shtrija sikur të ishe vetë afërdita e
sapodalë nga shkuma
mbetën kujtimet, po dhe ato nxjerrin tym
dhe harresa po dendësohet me një
shpejtësi prej furtune
ku shkuan, ku humbën?
fillikat vetëm
pres kohën që të bëhem skelet i bardhë
dhe të ngjitem vertikal në ajrin blu
po dëgjuat trak truk
qelqeve të dritareve në muzg
drurëve
jam unë
ngjitem në qiellin e harresës
le poshtë tokën e kujtimeve të bukura
që kthehen në humus për trëndafilat
e kuq

Odise Kote

E DIEL BALLKANI

Poezi

1- E diel ballkani ...

Kambanat e meshave tingëlluan kaq fort,
sikur vinin nga bota e përtejme,
zëra të ngjizur në zjarr e pezm.
Kryepeshkop' i botës shqiptare,
At Arthur Liolini
po ngjitet lart tek zotat,
Amen.
E diel.

Tokave të Ballkanit,
buzë greminave,
buzë humnerave,
rrënojave të trishta, skajeve të lumtura,
mbuluar me dafina,
mbushur me varreza plot lagështirë.
Rrëshket i papenguar, sovran,
Instikti vjetran i hakmarrjes.
Medet.
E diel.

Qiejve, të veriut në Kosovë,
trumba - trumba ikin,
në korridoret e lejuar,
ikin, ikin zogjtë shtegëtarê,
ikin lejlekë.
Bën ftohtë. Bêrrr bërr.
E diel.

Diçka është kalbur atje në Serbi,
do thoshte Sheakspeare*,
që zbeh inteligjencën e shefit të Europës,
Zhozef Borrell,
e pakuptuar, gjithëaq,
bën hapa të çuditshëm mbrapsht.
E diel.

Kokolepsur shekujve,
bashkim i përsosur kundêrshtish,
ende të paprekur,
makthet, mitet dhe erërat.
Drejtimiin erës mbase s'ia ndryshojnë dot,
por mund të rregullojnë velat...
Mbi shkrepa stuhish
ende fryn, gjakon e këlthet,
sharkia, lahuta, tupani.
E diel.
E diel ballkani ...

* W. Sheakspeare - Sinonim politik. Njê shtet që jeton me vesin, mbi krim.

2- Me avionin e linjës ...

Ti vërtitesh në kujtesë, e mjegullt, kaq larg,
pa adresë, trembem mos të humbas,
ndërsa një roman kushton një kg peshk,
dhe bileta e teatrit dy kg presh,
qytetit që ngjan si rrasë çatie gati të bjerë.

Kam mbetur vetëm me një djalkë,
i pavendosur, në stacionin e boshatisur
të autobuzëve që flenë.
Ai bën llogari:të blej një shtëpi,
por i duhet të punoj njëqind e tridhjetë vjet.

Qielli i këtij mëngjezi e zbuti disi,
fatalitetin e fytyrave tona plot trishtime,
pasi grumbulli i reve në skaj ngjasoi
me avionin e linjës heshtje, dhimbje, ikje ...

3- Do dështoj, do dështoj disa herë ...

Fytyra të zhubravitura në rrugë indiference,
me artikulim dembel ngaqë kishin kohë
pa lexuar asnjë rresht,
përqeshën dështimin tim të rradhës,
si një përrallë popullore
që ia thanë njëri tjetrit
pasi nuk iu ndodhi atyre.

Pinin dhe gogësinin,
aq sa më ngjau se kishin gjithë jetën aty,
mbi tavolinat e harresës
duke rrotulluar jetën e tjetrit
(të tyren e kanë braktisur prej kohësh)
si një lodër - fugë fëmijësh.

Kthehesha nga disa takime të errëta me fatin,
e çuditërisht buzëqeshja?!
Nuk doja zymti e trishtim në pore
pasi trishtimi është i lehtë,
është dorëzim,
ndaj këndoja me zë të lartë:
do dështoj disa herë, po kokën nuk e ul,
deri sa të gjej vijën e paprekur nga të tjerët...

Të njëjtat fytyra të zhubravitura,
ishin po aty edhe pas një jave,
(do jenë edhe pas një viti)
me artikulim edhe më dembel
kanë kohë pa lexuar asnjë rresht,
asnjë libër e dallohen qartazi
nga shikimet e babëzitura,
pasi është e pamundur t'i harrosh,
dhe e vështirë për t'i mbajtur mend,
derisa fitorja nuk është një gjë e lirë ...

4- Kjo mjegull që ra ...

Kjo mjegull që ra, sidomos atje
mbi ngrehinat e rrënuara, bosh,
na shkëputi me botën.

Pulëbardhat nuk dëgjohen më.

Vetëm dyshemetë rënkojnë,
tubat fishkëllijnë,
ndërsa fantazmat
që kanë jetuar aty më parë,
veshur me çarçafëë të bardhë,
bredhin e harlisen rrugëve...

Fantazmat e kanë lexuar
Librin e të Vdekurve
dhe e dinë që të gjallë e të vdekur,
takohen diku në fund të përjetësisë.

Kjo mjegull që ra ...
vello e çuditshme e mërzisë.

5- Kënga e të verbërve ...

Ata qëndruan në arë gjithë pranverën, verën dhe në vjeshtë
të keqkuptuar, të shtyrë, rrokullisur në vorbulla, u zhbartën.

Magjepsja, ëndërr - delir, prej hënës së plotë akoma nuk i lodhi,
thënë me gojë perëndie, asgjëja zëvendësoi format e imazhit.

Toka qënkish plot guriçka, tinës fshehur nën gurë sakrificash,
Ujërat e shirave ndrronin drejtim, duke iu vërsulur lumit egërsisht.

Në javën e shenjtë të pjellorisë, ia behën sorrat e zeza hileqare,
Njëra syresh mbante ditar dhe shkruante marrëzitë...

Ata qëndruan në arë gjithë pranverën, verën dhe në vjeshtë
të keqkuptuar, të shtyrë në heshtje e në vorbulla, u zhbartën.

Si një qiell me re të gjakosura, rrëzuar mbi kreshta tragjikisht,
dhe plasën, ah siç plas guri, plasën, plasën....

6- Pëllumbat nuk janë të shenjtë ...

Gjithë vjeshtën iu dërgova letra e poezi malli,
miqve e mikeshave që prisnin të udhëtonin,
në aeroportet dhe metrotë e botës.

Krahët e pëllumbave janë plagë,
që ende dhembin në eth,
nga fluturimet e gjata,
vizatimet e çuditshme nëpër qiej,
për të mbërritur në orën e caktuar,
para se të shuhej nga kujtesa,
një grindje e vjetër apo takim i harruar...

Mos m'i trembni as mos m'i vrisni këta pëllumba,
që gjithë paraditën diç të shkujdesur pëshpërisin,
gu,gu,gu ... si shigjeta flake,
bëjnë zigzage.
Ndonëse i duam shumë,
Pëllumbat nuk janë të shenjtë,
sepse shpesh ato
na i ndotin çardakët dhe dritaret ...

7- Bajame e egër ...

Veç bariu sypërskuqur prej katundi mjeran,
që kullot kopenë,
gjithë kumborë dhensh e zile dhish
kthen kryet nga bajame egër mbirë mes shkëmbinjsh.

Ditë për ditë ulet kundruall saj,
nuk ka çfarë t'i bëj asaj ndjesie të mirë,
i pëlqen mëvetësia, heshtja dhe aroma që lëshon,
kopeja vazhdon të kullotë polenin dhe vesën.

Fryn një erë e hollë, e hollë brisk, fishkëllen e fryn,
bariu sypërskuqur kacaviret,
i hedh përsipër bajames pelerinë,
sepse dëborërat dhe akujt maleve
ende nuk kanë shkrirë.

Çdo pemë ka brinjët e veta zbuluar,
shenjat e origjinës...

8- Vajza pret një djalë në breg ...

Në mbarim të agimeve e muzgjeve,
një anije në mes të detit fanitur.
Eh, eh, e...e, ku ka mbërritur?

Sirenat që vijnë çdo herë prej larg,
veshur me tinguj të butë harrese,
sjellin vetëdijen mbytur në thellësi.

Sikur pritja të mos qe kaq e gjatë,
të kishte të paktën një cak,
të nderej gjithë ai mallkim e shpagë,
oii, oii.

Ç›është në horizont ai pelikan vetmitar,
metaforë apo lajmëtar?

Dallgët shkalafyten baticë - zbaticë,
shpresë e vdekur, ikje - moskthim ...
eh, e....ehu që thërmon shkëmbinj.
Oii, oii.

Në mbarim të agimeve e muzgjeve ...

9- Ti ishe nga botë tjetër ...

Rikthimi yt nuk është histori balade,
kur vijnë papritur shirat e vjeshtës.
Si në koncert violinash duken sokakët,
nën ato dritare, nën dritat e zbehta.

Pikturoj shenjë në kanavacë të përhimtë,
kështu nis balada, zbulimin e vetes.
Flokëlagur nën shi, histori e pambarimtë,
ardhur ti nga qiell, nga një botë tjetër.

Pastaj, trupat preken, rrokullisje e pjerrët

avuj kërleshur, zjarr që pengje djeg, zjarr.
Ti puth si e çmendur, je mahnitje e freskët,
shkrumbon universi nën lëkurën e bardhë.

Ti nuk je kurrsesi si baladat e gjata,
me hollësi folklorike e një fund të trishtë.
Kur mbështjell me harresë, stinët, mallin,
në varr të thjeshtë, nën një qiparis.

Je hiri magjik ku flenë dhe zgjohen,
pasionet fillestare dhe mëkati i vjetër.
Miliona balerina shi, ç'muzikë pikëlore,
i sjell nga qielli, nga ajo bota tjetër.

10- Kjo kohë tinzare as verë - as vjeshtë...

Kjo kohë tinzare as verë - as vjeshtë,
ka zgjuar bef djajtë estetë të politikës.
Ngulur marrëfryme, as mish as peshk,
ekranesh bluar trashë të së përditës.

Diç e paqartë, pezull, gëlon kësaj ane,
si shkrimet etruske, e padeshifrueshme.
Fsheh tinës kuptimet e asaj kambane,
në ekuacione, konspiracione të bujshme.

Veshët e lodhur të njeriut që hesht,
përballë ekranit, me versione e thurrima.
Ç'të bëjnë me qëniet, as mish as peshk,
që ngjërojnë në mure mistere e vrima..

Pagesa të majme, trafik kombëtar dhe
kesh,
ëngjëj braktisur, nga lindja - perëndimi.
Shpirtshitur,qënie të vockëla, veç interes,
që kurrë nuk gjetën dot një rrugë kthimi.

Kjo kohë tinzare as verë - as vjeshtë,
e çmendi, shastisi, njeriun e ditës.
Ngulur marrëfryme, as mish as peshk,
ka zgjuar bef djajtë estetë të politikës.

11- E takova Drinin e Zi këtë mesvjeshte...

Drinin e Zi e kam takuar qindra herë,
në romane, poezi e këngë lahute,
përrallat që thuren netëve në katunde,
matanë kufirit të rrëfimeve, stacione
kalimtare,
nëpër stërhollime ndjenjash e dredhore,
gjeta gjurmë e shenja, tejza të panjohure,
ngashnjime e agjërime, ëndje e dhembje.

Lumë, o bir i liqenit të Ohrit,
Liqen o fytyrë e shpirtit identitar,
shpirt që nuk ke si të jesh dashuri
shtegëtare...!
Drinin e Zi e takova edhe këtë mesvjeshte,
mbuluar mjegull e gjethe. Mellanore -
gjethe,
a ngjyen penën aty njëmijë poetë? Ç'thanë
pemët?
është përpunuar stil folklorik diç i
gënjeshtërt...
Koha e mosdëgjimit të lumit tjetërsoka
njeriun,
e bëka kapërdirës, që ndryshon në zigzage,
sa s'dallon vijat e sharkisë, plagët dhe
faktet.

Ç'kërkon qetësia kur t'i ngjitesh e zbret,
grykave,
në plotësi? Lumë o lumë që tërbohesh fare.
Shpirt që nuk ke si të jesh dashuri
shtegëtare...!

E takova Drinin e Zi këtë mesvjeshte...

Ylli Ajdini

HIJE DHE DRITË

Tregim

Realisht me Daidjanën njihem prej disa vitesh. Po për fat të keq me të s'jam takuar ndonjëherë. Sidoqoftë, e njoh shumë mirë prej të dhënave që më jep imagjinata, por edhe prej preceptimeve që kam marë nga disa imazhe të pakta që ajo ka postuar në faqen e saj në fb. Ajo ka sy të qelqtë. Ka një të qeshur që të nxit për dëshira të mirëkuptueshme. Ka gjithashtu dhe një trup që të kujton se pse duhet të egzistosh. I braktisa emocionet dhe i dërgova dashamirëses së letërsisë me ngut një tregim të shkurtër, të cilit, sa i kisha dhënë dorën e fundit. Mbi ekranin e celularit lexova:

- Uaaauuuu! Interesante! Çfarë libri është?- Nuk arita ta falënderoj sepse pashë të më shkruaj përsëri në vazhdim: -Super shkrim! Më pëlqeu shumë!

Të them të drejtën, më lumturoi çiltërsia e të shprehurit të saj. Po ndjeva gjithashtu edhe se s'më kish kuptuar. Janë orë të vona për komunikim, po mua m'u desh ta sqaroja mirë sepse pas një pauze tjetër që e mora edhe disi si një mosbesim, lexova përsëri :

- E ke shkruar ti !? (Ajo kurrë nuk më drejtohet me emër, si p.sh., të më thotë: "shkruan shumë bukur, X") Sidoqoftë, nuk se vuaj prej mosbesimit të saj, sepse unë asnjëherë nuk i marë në konsideratë dyshimet, ngaqë nuk mendoj se egziston arsyeja për të mosbesuar. Pak çaste më pas, pasi mora gotën me ujë që e mbaj te komodina në anën e majtë të krevatit dhe piva pak mbi gjysmën e ujit të mbetur, i ktheva menjëherë përgjigje:

- Po, po. S'e e kam shkruar unë pa ta dërgova.-Pastaj: -Ti e di shumë mirë që unë shkruaj.

Heshtje. Dhe nuk e di pse heshta! Me Daidjanën komunikoj gjithmonë në momentin kur nuk jam nën vëzhgimin e askujt. Po kësaj radhe më shumë se sa më pyeti, ndjeva se u çudit. Çudia e saj më lehtësoi ngaqë duket se diçka me kuptim kam shkruar. Dhe nuk them se s'u gëzova nga kjo ndjesi pozitive, por ndoshta s'është kjo ajo arsyeja reale që më bëri të ndjej atë tjetërsim emocionesh, por unë, atë kuptova realisht. Sidoqoftë, e falënderova edhe unë qetësisht, por dhe çiltërsisht. Përsëri heshtje... Mungesë së shkruari ...Pritje... Ndoshta dhe ajo po i shmanget vështimit të dikujt. Po kësaj radhe heshtja e saj nuk ka durim.

- I re ziles. Jam në shtëpi dhe... nuk jam vetëm,- lexova të më shkruajë pas pak prerazi, po ëmbëlsisht. Pavetëdijshëm, kisha bërë një gabim: i kisha rënë ziles ndërkohë që duhej t'i shkruaja. I ngula sytë kujtesës po nuk dija si ta shpjegoja nxitimin. Ndoshta nga kënaqësia për t'i thënë se kam shkruar diçka enkas për të, a ndoshta pavetëdija instiktivisht gjeti rast për të shfaqur dëshirat e veta të fshehta, nuk e di. Kuptohet që Daidjana nuk e ngriti receptorin. Gjithmonë kam vënë re se ajo di t'i kontrollojë emocionet, por faktikisht edhe unë di t'i menaxhoj ato deri në imtësi. Dhe është pikërisht aftësia e zotërimit të vetvetes që kam, që më bën t'i shmangem disi një faji të ndërgjegjshëm. Së bashku kemi bërë një marëveshje, ose më qartësisht me mirësjellje është ajo që më ka kërkuar të mos komunikojmë në telefon, veçse të shkruajmë. Por edhe për kaq, vetëm atëhere kur kjo është e nevojshme. Sa e çuditshme por dhe e pranueshme! Sidoqoftë, e kam pranuar këtë lloj kontrate sepse në thelb më tërheq më shumë karakteri i qënies njerëzore, se sa lodrat e dëshirave, qofshin këto dhe të kuptimta.

-"Më fal për shqetësimin", –ndërhyra pas pak.

Gjithësesi padurimi jo gjithmonë e ka emrin gabim. Me këtë nuk dua të mëshiroj aspak veten, as dhe ndjesinë e "aventurës", por as në parafytyrim nuk guxoj ta shoh fytyrën e saj sepse e di që ky proces psikologjik nuk më sjell asgjë reale kur nuk jam në të. Pavetëdijshëm shikimi më vajti te ora e murit. Akrepat e saj nuk po lëviznin. Mendova: "Ndoshta ka mbaruar bateria". Në çast ndjeva nevojën për t'u mbushur me ajër të freskët. U ngrita nga ku isha dhe tërhoqa tërheqësen e grilave. Hapa dritaren e vetme që ka dhoma ime e gjumit, ngrita kokën, njëkohësisht dhe vështrimin, po askush nuk po më vështronte. Ndërsa unë, çuditërisht, pashë qartësisht qiellin tek vazhdonte të ishte ende pa yje. Ndërkohë një rrymë e freskët ajri më kujtoi se egzistoj.

Përsëri mëngjes! Po nuk jam i qartë pse ky mëngjes këtë ditë erdhi më shpejt se nga çdo herë tjetër. Tek meditoj ndjej një boshllëk të qënies. Si për ta plotësuar dal nga shtëpia dhe po eci shpërfillur përmes mjegullës që fatmirësisht sa vjen dhe bëhet më trasparente. Ndoshta ecja dhe ballafaqimi me natyrën si gjithmonë do të më ndihmojnë të largoj disi mendimet negative të mbartura nga e djeshmja. Shpresoj. Ndërkohë ngrihem dhe ulem në ato pak stola të montuara rreth stadiumit si për t'i provuar se deri në ç'masë ato e mbajnë peshën e një mërzie të "panevojëshme". Përse jam këtu?! Ah, po. Po pres ashpërsinë e paqartësive të bëhen më të qarta, më të kuptueshme.

–Kalofsh bukur! -më përshëndesin të njohurit, por unë askujt s'i kthej përshëndetjen. Ndoshta vetëm instiktivisht dikujt mund t'i bëj ndonjë gjest mirësjelljeje, dhe vetëm kaq. Po vendi nuk më mban. I braktis stolat dhe ngrihem të eci përsëri për të larguar nga vetja ato pak grimca të bezdisshme trishtimi. Në kodrat përball qytetit duket qartë gjelbërimi me nuanca të ndryshme. Disa re të ulta qëndrojnë mbi faqen e malit thuajse pa lëvizur. "Çudi, sa indiferent që janë njerzit",- mendoj pasi e shkëput vëmendjen nga thellësitë e hapësirës. Por fundja dhe nuk se është e thënë që kujtdo gjithçka duhet t'i duket siç më duket mua. Gjithashtu si masë ndëshkimi ndaj vetes po anashkaloja edhe thirjen e pasionit për të ndjekur çfaqjet teatrale që do të zhvillohen këtë javë në kinoteatrin e ri të qytetit. Vazhdoja të ecja. Gabimi vjen nga padija, por boll e pashë në sy edhe vetminë, ndaj guxova ti shkruaj:

- Pëshëndetje! Të uroj një fundjavë të bukur!

Po prisja. I kisha ngulur sytë e lodhur mbi ekranin e bardhë të celularit dhe nuk e di se për ç'arsye s'po guxoja t'i largoja ato prej atij xhami të ftohtë. Mendova se gabimi do të kishte pasoja më të mëdha, po gjëndja e këtyre paqartësive nuk zgjati shumë, përgjigjja nga Daidjana erdhi:

- Përshëndetje! Edhe unë ty!

Kjo përgjigje e menjëherëshme më seleksionoi mendimet dhe një ngrohtësi më përshkoi gjithë trupin. Ecejaket në rrugicat e keqkuptimit më në fund morën fund. Menjëherë pas atyre fjalëve përshëndetëse të saj kuptova se mirënjohja është vlerë vetëm e njerëzve me shpirtit njerëzor. Dhe më pas fatmirësisht nuk pati kohë në heshtje. Ajo ishte e gjitha e jona, ndoshta dhe vetëm e imja. Për këtë arsye nuk kam më nevojë të hamendësoj dhe as të mendoj, por ngrita menjëherë jakën e xhaketës për tiu shmangur ftohtësisë së ajrit, dhe nga lumturia e ringjallur humbas në labirintin e mendimeve duke u larguar nxitimthi, po nuk e di për ku. Tek eci ashtu shpërfillur mes mbrëmjes që duket se ka marrë atë pamjen e vet normale, të rënat e sahatit të madh të kalasë së qytetit më detyruan të shikoja vrullshëm akrepat e orës së dorës. Pa hequr akoma shikimin nga ora e dorës mora frymë thellë, dhe menjëherë largohem me nxitim nga jashtësia ku isha, sepse edhe drita e ditës ndërkohë e si asnjëherë tjetër kishte mbaruar pa u kuptuar, porse edhe fare natyrshëm kishte ardhur edhe momenti për t'u rehatuar tashmë në shtëpi. Edhe qyteti tek po e vështroja si me sytë e një turisti të huaj, sikur po më dukej më ndryshe nga çe kisha parë këto dy ditë.

– *Mesdames, une pile pour l'horloge murale, s'il vous plait.* (me shitësen e kinkalerisë, kur përballemi, komunikoj me frëngjishten time të folur jo mirë). Bëra pagesën dhe u nisa me nxitim drejtë shtëpisë. Ndjeva dëshirën për të fjetur.U shtriva në krevat. Por nuk e di nëse do të kem kohë për gjumë. Sidoqoftë, arsyen e këtij dyshimi e kuptoj shumë mirë: Lumturia nuk ka as kohë dhe as durim të merret me shkaqet e saj. Nga përtej dritares nuk dëgjohet asgjë njerëzore, veç rënkimeve e jehonës së mendimeve të pakuptueshme të ndonjë pijaneci të vonuar. Për një çast përqëndrova vështrimin në faqen e murit. "Tik-tak, tik-tak". Akrepat e mbyllura brenda fushës së bardhë të orës filluan ti japin kuptim kohës. Për vetëm pak orë do të sundoj qetësia. Së shpejti zbardh dita. Por më në fund, jo vetëm!

"Edipi në folklor: libër studimor", botim i Universitetit Wisconsin, (1985), hapet me studimin e Margaret Hasluck "Edipi mbret në Shqipëri", i botuar për herë të parë në revistën "Folklori", Volumi. 60, Nr. 3, shtator 1949.

EDIPI MBRET NË SHQIPËRI

Nga Margaret Hasluck

Përktheu: Granit Zela

I. Hyrje

Përmbledhja interesante e gjëegjëzave të incestit të zotit F. J. Norton[1] në revistën "Folklor", mars 1942, më kujton katërvargëshin e mëposhtme në shqip:

Nina nina bir!
I biri i t'em bir!
I biri i s'em re!
S'ati vjehërr i ke le[2]

Në përrallat popullore shqiptare ky katërvargësh i këndohet fëmijës së saj nga një grua ndërsa të dy vdesin nga dora e djalit të saj të madh, me të cilin është martuar pa e ditur. Në fakt është përfundimi i historisë së Edipit siç tregohet në Shqipëri.

Kuptimi i dy rreshtave të parë nuk kërkon koment, kurse ai i të tretit, një të vogël; si gruaja e djalit të saj të madh, gruaja, është nusja e të birit për nënën e tij, domethënë për veten. Si pasojë, fëmija është fëmija i nuses së të birit të saj. Rreshti i katërt është jashtëzakonisht i ngatërruar. Si nëna e djalit të saj të martuar, gruaja është vjehrra e nuses së tij, e cila përsëri është vetë ajo. Si burri i saj, djali i saj i madh është vjehrri kurse ajo është vjehrra, dhe meqenëse ajo vetë është vjehrra e vetes, ai është vjehrri i saj. Rrjedhimisht, foshnja është fëmija i një burri që është bir, bashkëshort dhe vjehërr i një gruaje e cila është e njëjta, dhe ajo përsëri është nusja e të birit (reja) dhe vjehrra e vetes.

Strofa, siç do ta shohim tani, është një gjëegjëzë e njohur në Shqipëri, por është edhe më e zakonshme si ninullë. Dy fjalët e para, të cilat ndryshojnë nga *nina nina* në Shqipërinë e Veriut në *nani nani* në jug, janë të llojit ndërkombëtar të përfaqësuar, për shembull, nga *nini, baba, nini* ("fli, fëmijë, fli") të industanishtes dhe *nani nani* i arabishtes. Nënat i këndojnë nën zë ato pa pushim derisa përsëritja e bashkëtingëlloreve të buta zanore - *neena neena ose nahnee nahnee* duke u shqiptuar - e vënë fëmijën në gjumë. Më befasues është fakti që nënat shqiptare shpesh i shtojnë një rresht ose më shumë strofës së Edipit. Për shembull, në qytetin e lindjes së gruas së Tajar Zavalanit, Fier, Shqipëri e Mesme, zakonisht këndojnë:

Nani nani biri im!
Vellaj i burrit t'em

Nuk ka nevojë të thuhet, as që e mendojnë se çfarë thonë. Megjithatë, ata e dinë shumë mirë historinë që qëndron prapa fjalëve. Një nënkuptim ogurzi që rrjedh nga legjenda e Edipit i bashkëngjitet dy fjalëve të para, siç më informon më tej zonja Zavalani. Nëse një mysafir pyet për një djalë ose një djalë të ri që ka bërë një gabim, - të afërmit e tij femra - ndoshta edhe ajo që sapo i ka kënduar fëmijës së saj për ta vënë në gjumë me dyvargëshin e jashtëzakonshëm të sapo cituar- përgjigjet me dy fjalët e para të ninullës, pa mbaruar strofën. Kështu ata i japin të kuptojnë se ai është një shpirt i humbur, por megjithatë ata nuk mund ta heqin nga zemrat e tyre.

Strofa është gjithashtu një gjëagjëzë e parapëlqyer midis djemve të vegjël shqiptarë. Por shqiptarët janë mendjehollë dhe shmangin të dukshmen. Pra, ka një dredhi në gjëagjëzë, të cilën zoti Dervish Duma e shpjegon kësisoj: gruaja është martuar, jo me të birin e vet si te historia e Edipit, por me birin e gjetur nga gruaja e parë. Ajo ishte gruaja e dytë e burrit të saj të vdekur, ai kishte pasur një djalë me gruan e parë, dhe ishte ky djali me të cilin u martua ajo pas vdekjes së tij. Duke vepruar kështu, vetëm iu bind ligjit sipas të cilit një djalë, duhej të martohej me të venë e babait të tij.

Duhet thënë se kjo zgjidhje e gjëagjëzës nuk bën më shumë sesa një argëtim shtesë shqiptarët e zakonshëm. Ajo prish të gjithë dramën e historisë së vjetër - incesti i padëshiruar, tmerri përftuar pas zbulimit të tij dhe pasojat tragjike. Sepse nëse do të kishte qenë e ligjshme që mbretëresha e ve të martohej me mbretin e ri, nuk do të kishte asgjë që t'i pengonte të jetonin të lumtur përgjithmonë. Ajo bie gjithashtu në kundërshtim me të gjitha ligjet shqiptare. Ligji zakonor i Shqipërisë nuk e lejon një burrë të martohet me të venë e babait. Edhe ligjet fetare e ndalojnë po aq rreptësisht. Të krishterët duhet t'i binden urdhëresën në tekste të tilla si Libri V i Testamentit të Vjetër XXII: 30 ("Një burrë nuk do të marrë për grua gruan e babait të tij") dhe muslimanët urdhëresës në Kuran, Sure IV, 26 ("Mos u martoni me gra me të cilat janë martuar baballarët tuaj, sepse ky është një turp, dhe një veprim i keq dhe i urrejtshëm"); Referencën e fundit pati mirësinë të ma dërgojë zonjusha Margaret Smith. Shqiptarët e zakonshëm, të nxitur nga prirja kombëtare për të kërkuar të ndërlikuarën dhe jo të thjeshtën, duket se kanë ekzagjeruar me elasticitetin e rregullave të martesës që pasuan shfaqjen e Islamit pas pushtimit turk të Shqipërisë në shekullin e pesëmbëdhjetë.

II. Historia

Versioni më i dobishëm i historisë siç tregohet në Shqipëri është në "Gramatikën shqiptare" të zotit Stuart Mann, f. 90-2. Kjo vjen nga një prej fiseve të Dukagjin në Shqipërinë e Veriut dhe u botua për herë të parë në Shkodër në periodikun katolik "Hylli i dritës" rreth vitit 1929. Përkthimi im i cili ndryshon në mënyrë thelbësore nga i zotit Man (f. 136- 8), është si më poshtë:

Mallkimi i zanës

Një burrë një herë shkoi me të zbardhur agimi majë alpeve për të prerë disa dërrasa për një djep, sepse gruaja e tij ishte gati t'i jepte një fëmijë nga Zoti ynë. Ndërsa po priste një bredh, ai dëgjoi një zanë duke i thirrur shoqes s saj nga ai mal.

"Qofsh e bekuar!" tha ajo: "Ai djalë i varfër pret t'i lind djalë. Çfarë emri do t'i vëmë?"

"Oh, na the ç'na the", u përgjigj tjetra. "S'kam për ta vra mendjen për këdo që lind".

Por ajo që foli për herë të parë nuk hiqte dorë aq lehtë. Ajo i thirri dy ose tre herë më shumë, dhe pastaj e inatosur jo u përgjigj: "Babën e vraftë me nënën u martoftë!"

Kur burri dëgjoi mallkimin e zanave, ai në fillim u trondit. Pastaj ai nuk i kushtoi më vëmendje dhe vazhdoi me punën e tij.

Pasi e bëri djepin, e çoi në shtëpi dhe atje e gjeti fëmijën të lindur. Nëna e vuri në djep dhe i vendosi gjerdanin e zakonshëm në qafë si një shenjë.

Kur fëmija ishte rritur pak, i ati, i pazoti ta hiqte mallkimin e zanash nga mendja, i tregoi ngjarjen gruas dhe vendosi ta largonte të birin. Kështu ai bëri një kuti, e futi fëmijën brenda, dhe e la **në** det. Valët e morën me vete, duke e çuar larg, shumë larg, dhe më në fund e lanë në breg. Atje Zoti ynë i çoi një dhi e cila vinte çdo ditë dhe e linte djalin të pinte qumësht.

Një ditë të bukur një udhëtar që po kalonte, hasi fëmijën dhe i erdhi keq, prandaj e çoi në shtëpinë e tij. Atje e rriti si të ishte i familjes. Kur fëmija u rrit dhe u bë një djalosh rreth të gjashtëmbëdhjetave apo më shumë, atij iu ngulit në kokë se ishte djalë mbreti. Kështu që nuk pranoi të qëndronte më me mirëbërësin dhe nisi të bridhte në të gjithë botën për të zbuluar se djali i cilit mbret ishte dhe të shkonte dhe të jetonte me të atin.

Kaluan shumë e shumë vite duke u

1 Margaret Hasluck (1885-1948), një specialiste e folklorit në Ballkan, i referohet, "I burgosuri që shpëtoi jetën me një gjëagjëzë", të F.J. Norton -iit botuar në "Folklor", 53 (1942), 27-57, shtysa për të shkruar tekstin për Edipin shqiptar. (Shënim në "Edipi në folklor: libër studimor" me redaktor: Lowell Edmunds dhe Alan Dundes, Universiteti Wisconsin, SHBA, 1985).

2 Kjo strofë, ashtu si edhe strofat e tjera ilustruese janë në shqip në origjinal kurse përralla është përkthyer.

endur. Pastaj ai ndodhi të kalonte në një vend ku banorët flisnin shumë kundër mbretit të tyre. Ndërsa ai e njihte veten të ishte shumë i zoti, u bashkua me grupin që kundërshtonte mbretin, duke menduar të gjente një mënyrë për ta zhdukur nga faqja e dheut dhe për t'i zënë vendin.

Ndërsa ditë pas dite pyeste veten se si mund ta përmbushte dëshirën e tij, krejt papritur, ai hasi tre karroca në të dale të qytetit. Pasi disa njerëz I kishin treguar me gisht karrocën në të cilën ishte mbreti, ai vajti drejt tij sikur donte t'i thoshte diçka. Kur u afrua, e goditi me topuz dhe e vrau. Pastaj u fut në karrocë, u grahu kuajve me galop dhe hyri në qytet. Pa shumë poterë, njerëzit e zgjodhën atë mbret dhe i dhanë mbretëreshën e ve për grua meqë ata e pëlqenin njëri –tjetrin

Para se të kalonte një vit, Zoti ynë u dha e një djalë dhe ata dukeshin të lumtur. Por ishte një gjë që i shqetësonte. Kurdoherë që burri fliste me gruan e tij, pa e kuptuar as vetë se si ndodhte ai përfundonte duke e thirrur "nënë", dhe ajo i drejtohej duke i thënë të shoqit "bir"! Për të zbuluar se çfarë fshihej pas kësaj pune, të cilën ata nuk e shpjegonin dot, ata pyetën një fallxhore. Ajo u përgjigj se ata duhej të kishin lidhje gjaku dhe sihin të afërm me njëri -tjetrin. Pasi u tha kjo nga fallxhorja, ata filluan një ditë të bisedonin gjerë e gjatë për jetët e tyre. Sidomos për shkak se burri i tregoi gruas së tij gjerdanin që nëna ia kishte vënë në qafë kur ishte i vogël, e kuptuan se me të vërtetë ishin nënë dhe bir, dhe se ai e kishte vrarë padashur babën e vet.

Në kulm të dëshpërimit burri i nguli thikën në zemër në fillim gruas së tij, pastaj të birit, dhe në fund fare edhe vetes.

Ndërsa gruaja e tij po jepte shpirt, ajo i këndoi fëmijës së saj që po vdiste:

Pusho, pusho, biri im!
Biri i birit tim!
Djali i nuses së birit tim!
Lindur prej vjehrrit tënd!

Me sytë e ngritur lart, ajo pa se si shtëpia po u shembej mbi krye për t'u kthyer në varrin e tyre.



III. Koment

E tillë është rrëfenja e Edipit mbret në Shqipëri. Arma e përdorur për të vrarë mbretin në karrocën e tij tregon se është goxha e vjetër. Kjo ngaqë topuzët, armët klasike të jeniçerëve dhe spahinjve të Turqisë Mesjetare, dolën nga përdorimi kur nisën të përdoren mushqetat.

Përralla ndahet në tre pjesë: mallkimi, largimi dhe martesa me incest. Secili pjesë është një tërësi në vetvete dhe rishfaqet në histori të tjera, e dyta është më popullore. Por nuk duket e sigurt që të treja ishin lidhur së bashku në tregimin popullor në Shqipërinë e Veriut. Në kohën kur u botua historia siç e kemi botuar këtu, disa shqiptarë praktikonin shkrimin e tregimeve dhe rrëfenjave folklorike. "Vasha kërcimtare e Dukagjinit" në librin e zotit Man, f. 92-100, është një shembull dhe ky version i "Edipit mbret" lexohet si një histori tjetër.

Fatkeqësisht as zoti Man dhe as unë nuk e mbajmë mend kush e botoi atë te "Hylli i Dritës" dhe për shkak të krijimit të një qeverie komuniste në Shqipërinë të vetmet kopje të këtij periodiku që mbeten në dispozicion për të huajt në Evropë janë në Romë, ku për momentin unë dhe zoti Man e kemi të pamundur t'i kemi në duar. Pamundësia jonë për të identifikuar botuesin e saj të parë e bën të pamundur vlerësimin e saktë të aspektit folklorik të tregimit në tërësi. Por mund të thuhet me të drejtë se secila pjesë, e marrë në vetvete, është folklor i vërtetë shqiptar.

Pjesët nuk përputhen plotësisht. Në të parën se babai është një fshatar i lindur midis maleve të Shqipërisë së Veriut, të njohura si alpe, bredh, bërja e djepit dhe frazeologjia katolike që na tregon gjithçka. Në të tretën ai është një mbret dhe udhëton në një mënyrë mbretërore në një karrocë, e cila nënkupton një vend shumë më të rrafshët se Shqipëria e Veriut dhe kështu krijon një ndjesi të pranueshme se sa larg kishte shkuar fëmija pasi u largua në fillim dhe pastaj duke u endur.

Pjesët ndërlidhen prej fillit të mallkimit të pashpjegueshëm. Që nga momenti kur flet zana idhanke, fëmija duhet të **p**ërballet me profecinë e pazakonshme. Babai, më merak për ta shmangur vrasjen e tij, por duke mos dashur t'ia marrë jetën pasardhësit të tij të rrezikshëm, e hedh në det, për të vdekur ose për të shpëtuar, sipas vullnetit të Zotit, ashtu si do të kishte vepruar një banor vendas i Ballkanit, me një qen ose ose mace të padëshiruar. Providenca deshi që i dëbuari të shpëtohej, duke dërguar së pari një dhi për ta ushqyer dhe më pas një njeri të mirë për ta birësuar. Në këtë mënyrë babai fshatar shpëton prej mallkimit, por në të vërtetë **është** i biri ai që e trazon; fati i babait është vulosur me lindjen e tij dhe nëse nuk ishte dënuar të vdiste nga dora e të birit, duhej të ndahej pre tij. Te njerku djali pushtohet nga ideja e marrë se ka gjak mbretëror dhe vihet në kërkim të babait mbret. Ai mendon vetëm të jetojë në paqe me të derisa të vdesë dhe më pas të hip në fron. Por mallkimi do që të pushtohet nga ambicia gjë që do të ndryshojë rrjedhën e ngjarjeve, kur i merr jetën një mbreti të panjohur dhe martohet me mbretëreshën vejushë, për të zbuluar më pas se mbreti ishte i ati dhe mbretëresha e kishte lindur.

Megjithëse rrëfenja për Edipin duket të jetë mjaft e zakonshëm në rajonin e Ballkanit, ky është versioni i vetëm shqiptar të cilin ne njohim. Karakteristika më e pazakontë e rrëfenjës është ndodhja e atvrasjes në një karrocë. Ndërsa në mënyrë të habitshme ngjan me episodit përkatës te Sofokliu, elementi i karrocës është jashtëzakonisht i rrallë në traditën orale.

Më 1623 botohen plot tridhjetë e gjashtë pjesë teatrale të Shekspirit, nga të cilat, gjysma e tyre pa dritën botimit për herë të parë

VITI 1623 : NJË PËRMENDORE PËR SHEKSPIRIN

Nga Feride Papleka

Më 1623, plot katërqind vjet më parë, filloi procesi i vërtetë që monumentalizon tekstet e Shekspirit dhe përjetëson dramaturgun, i cili kishte vdekur shtatë vjet më parë. Është fjala për të famshmen in folio, *e quajtur* "Folio e Parë" *(sepse u pasua nga të tjera). Dy aktorë, John Heminges dhe Henry Condell, që kishin luajtur në skenë me të, shpëtuan nga humbja e pakthyeshme dorëshkrimet e tetëmbëdhjetë pjesëve të shkruara me dorën e tij.*

Jeta

William Shakespeare (1564-1616), është dramaturg, poet dhe aktor anglez. I mbiquajtur "Bardi i pavdekshëm" ose thjesht "Bardi", ai shikohet si njëri ndër më të mëdhenjtë poetë dhe dramaturgë të gjuhës angleze. Vepra e tij e përkthyer thuajse në të gjitha gjuhët e botës përbëhet nga 39 pjesë teatri, 154 sonete dhe disa poema.

Shekspiri ishte i treti nga tetë fëmijët e një familjeje me gjendje të mirë ekonomike në Stratford dhe më i madhi nga djemtë që u mbijetoi sëmundjeve të fëmijërisë. Shumica e biografëve të Shekspirit mendojnë se ai me siguri u shkollua në *King›s New School*, edhe pse asnjë regjistër i kësaj kohe nuk ekziston. Kjo shkollë u hap në kohën e mbretërimit të Eduard VI më 1553 në Stratford, shumë afër shtëpisë së John Shakespeare-it, të atit të William-it. Shkollat angleze të asaj kohe mbase kishin cilësi të diskutueshme, por ato zbatonin të njëjtin program me dekret mbretëror, i cili mbështetej kryesisht në studimin intensiv të gramatikës latine klasike dhe të letërsisë latine.

Pas shkollimit, 18 vjeç ai martohet me Anne Hathaway 26 vjeçe dhe pati tre fëmijë, një vajzë që lindi në fillim dhe pas një viti e gysmë dy binjakë, një vajzë dhe një djalë, i cili vdiq kur kishte mbushur njëmbëdhjetë vjeç nga shkaqe të panjohura. Megjithatë pas lindjes së dy binjakëve, për disa vjet Shekspiri nuk u pa në teatrin londinez dhe pastaj u rishfaq si aktor dhe si autor. Një fermë që mbahet si shtëpi e familjes së saj në Shotery, është shndërruar në pikë turistike për fshatin edhe pse nuk ka siguri që është e familjes Hathaway. Kritika e sotme ka vënë në dukje, se biografët e Shekspirit ngaqë nuk zotëronin dokumente për vitet e mungesës së tij në teatër, kanë sajuar histori apokrife.

Nuk dihet data e saktë, por mendohet se Shekspiri e nisi karrierën si aktor dhe autor në Londër pranë trupës teatrale *Lord Chamberlain's Men*, duke u bërë edhe aksioner i saj. E ndihmon Ana që trashëgon një pasuri të madhe nga familja e vet. Në atë trupë teatrale u luajtën disa drama dhe komedi të tij.

Pjesën më të madhe të veprës ai e shkroi midis viteve 1589 dhe 1613. Krijimet e para ishin sidomos komedi dhe drama historike dhe pas tyre ai iu përkushtua tragjedive *si Hamleti, Otello, Mbreti Lir, Makbethi* etj. Më 1599 themeloi teatrin e tij Globus, me të cilin u bashkuan shumë aktorë të trupës së mëparshme. Aty ai vuri në skenë dramat më të rëndësishme të tij dhe vazhdoi të luante vetë edhe role kryesore. Gjithsesi ai gjatë gjithë kohës që ishte në Londër, shkonte herë pas here në Stradford pranë familjes. Vitet e fundit të jetës shkroi kryesisht tragji-komedi duke bashkëpunuar edhe me dramaturgë të tjerë. Sa ishte gjallë, një numër i madh pjesësh teatrale të tij u botuan pa cilësi të mirë teknike. Më 1613 ai u kthye përfundimisht në Stratford dhe kaloi aty vitet e fundit të jetës. Disa dokumente vërtetojnë se më 1614 ai shihet sërish në Londër, por shkon te vajza e tij e madhe, Suzana. Shekspiri vdiq më 1616, në Stratford, 52 vjeç, një muaj pasi kishte bërë testamentin. Ai u varros në kishën *La Sainte-Trinite* të Stratfordit (Stratford-upon-Avon), dy ditë pas vdekjes. Mbi varrin e tij është shkruar një epitaf i përgatitur nga vetë Shekspiri. Ndërsa Ana vdiq në gusht 1623, pa e parë përmbledhjen e veprës dramatike të Shekspirit botuar në një vëllim të vetëm.

Botimi i veprës

Më 1623, plot katërqind vjet më parë, filloi procesi i vërtetë që monumentalizon tekstet e Shekspirit dhe përjetëson dramaturgun, i cili kishte vdekur shtatë vjet më parë. Eshtë fjala për të famshmen *in folio*, e quajtur *"Folio e Parë"* (sepse u pasua nga të tjera). Dy aktorë, John Heminges dhe Henry Condell, që kishin luajtur në skenë me të, shpëtuan nga humbja e pakthyeshme dorëshkrimet e tetëmbëdhjetë pjesëve të shkruara me dorën e tij. Kur formuluan me botuesit titullin : *Mr. William Shakespeare's Comedies, Histoires and Tragedies,* ata përjetësuan imazhin e autorit dramatik William Shakespeare. "Folio e Parë" është një libër me rreth nëntëqind faqe, shtypur në A4, në dy kolona me shkrim të ngjeshur edhe për arsye të çmimit të shtrenjtë të letrës së blerë në kontinent. Botimi i librit u krye falë bashkëpunimit të tyre me një shoqëri shtypshkruesish dhe me tre librarë botues: William Blount si dhe William dhe Isac Jaggard, ati dhe biri. U desh më tepër se një vit e gjysmë që kjo punë të mbaronte; duke nisur nga fillimi i vitit 1622 deri në nëntor 1623, sepse botimi u ndërpre disa herë për arsye financiare. Të gjitha dramat u botuan me deklarimet paraprake "sipas kopjeve origjinale dhe të sakta" që shpreh edhe shqetësimin për një tekst të denjë për përjetësinë duke u quajtur botim përfundimtar. Për të siguruar suksesin e librit, ata që morën përsipër botimin e tij, i cili ishte vërtet si një kantier i madh pune, nuk i lanë gjë rastësisë. Pra, parateksti: portreti i autorit në faqen e parë, që u kthye në ikonë; në faqen e majtë, bri portretit, një poemë e Ben Jonson-it me lëvdata, bashkëkohës i autorit, mik dhe rival i tij, dramaturg; fjalët: *"Lexues, kushtoji vëmendje librit të tij, jo portretit"*; dy letra në vargje të Heminges-it dhe Condell-it si dhe nderimi edhe për *mecenët* besnikë të Shekspirit dhe pastaj tërë vepra e tij dramatike. Një ndërmarrje e tillë botimi ishte e panjohur deri atëherë. Madje një kopje e vitit 1623 u gjet së fundi më 2014 në fondet e bibliotekës Saint Omer, në Pas-de-Calais, përveç 200 e ca kopjeve që ruhen në British Library, të cilat nuk u shitën në atë kohë, nga 800 që u shtypën gjithsej.

Pra, më 1623 botohen plot tridhjetë e gjashtë pjesë teatrale të Shekspirit, nga të cilat gjysma e tyre pa dritën botimit për herë të parë. Pa këtë in-folio, tetëmbëdhjetë vepra dramaturgjike, mes të cilave: Makbethi, Jul Qesari, Nata e Mbretërve, Stuhia etj., mund të ishin zhdukur njëherë e përgjithmonë. Ky akt i dy miqve të tij i nxori ato nga harresa. Botimi mbetet edhe risi në fushën e botimit, jo vetëm ngaqë e vendos portretin e tij në faqen e parë dhe përuron kështu dramaturgun e madh, por e pajis veprën me disa vlerësime që janë si parathënie nga Ben Jonson-i që profetizon karakterin e përjetshëm të Shekspirit duke themeluar një vështrim të ri të veprës së tij për dyqind vjetët e ardhshëm, një vështrim kritik, i cili do të pasohet në shekujt XIX dhe XX me studime të shumta. Vepra e tij dramatike do të vazhdojë të vihet në skenë, do të përkthehet dhe ripërkthehet, do të përshtatet, rizbulohet dhe do të riintrepretohet në kontekste kulturore dhe politike të ndryshme.

Me gjithë monumentalizimin e veprës së Shekspirit që u bë pak kohë pas vdekjes së tij, kur kujtimet për të ishin të gjalla, me elemente konkrete dhe origjinale si: portreti i gdhendur, poemat e kushtimit me lëvdata, emrat e dy aktorëve, botuesve dhe mecenëve si dhe fjalët e adresuara "për lexuesin e të gjitha shtresave", që janë edhe hollësi të pakundërshtueshme, spekulimet që e shihnin Shekspirin si aktor, por jo si autor të veprës, vazhduan si të mos ekzistonte një vepër e materializuar në një botim historik.

Për shumë kohë sa ishte gjallë, Shekspiri ishte botuar krahas autorëve të tjerë. U bë përpjekje të botoheshin me emër duke përfshirë dy ose tri pjesë teatrale të tij, ndërmarrje e ndonjë botuesi qysh më 1597, por u ndërpre nga arsye të ndryshme që lidhen me rrethanat e kohës. Fillimisht veprat e ndryshme të Shekspirit janë botuar në *pamflet*, domethënë fletë të qepura. Kështu u botuan edhe sonetet. Këto botime të paformatuara si libër dhe të palidhura, ishin të kërcënuara të griseshin dhe të humbisnin.

Emri i Shekspirit si dramaturg, si në të gjitha botimet e kohës së tij nuk jepej, por vetëm titulli i pjesës, emri i trupës dhe vendi i shfaqjes. Më 1593 u botua në pamflet *Venera dhe Adonisi*, por pa emër. Për herë të parë emri i Shekspirit u shfaq më 1598 dhe nisi interesimi në rritje për veprën e tij. Botuesit përfshinë edhe pjesët teatrale që ishin botuar më parë pa emrin e tij. Por kishte edhe librari që nxirrnin ende libra të tij pa emër autori. Ndonjë bibliotekë si ajo Sir John Harrington, më 1598 përmblodhi në njëmbëdhjetë vëllime 135 pjesët teatrale të vëna në skenë në Londër, nga të cilat shtatëmbëdhjetë pjesë të Shekspirit ishin shpërndarë sipas tematikës, pa i dhënë ndonjë rëndësi atij si dramaturg.

Ndonjëherë ka ndodhur edhe e kundërta si më 1599, që në një antologji poetike poshtë titullit shkruhej *"Par W. Shakespeare"*, në një kohë që ai kishte vetëm disa krijime si autor mes të tjerëve. Kjo dëshmon se emri i tij po fitonte një autoritet në rritje. Dëshmi e autoritetit në rritje të Shekspirit jepet më 1608 në botimin e pjesës *Mbreti Lir,* i vetmi i këtij lloji, ku shkruhet: *" Mr. William Shakspeare: HIS True Chronicle Historie of King Lear"*.

Botimi *in folio,* i vitit 1623 bëri të mundur që për herë të parë të shihej i përmbledhur korpusi i veprave dramatike të Shekspirit me emrin e tij. I bazuar në dorëshkrimet origjinale, kjo ndërmarrje është dyfish e përkryer, sepse sjell në trajtën e pastër edhe veprat që kishin pasur pasaktësi në botimet e mëparshme.

Vepra e Shekspirit u ribotua në shekujt që erdhën duke pasur pamje të ndryshme, por në botimet më të mira është dhënë vepra origjinale dhe teksti i saj i saktë. Në shekullin XVIII, Edmond Malone është i pari botues që e shoqëron tekstin letrar me një jetëshkrim dhe me rendin kronologjik të pjesëve dramatike. Jeta e Shekspirit, e bazuar në dokumente origjinale të ruajtura në arkivat e Londrës e të Stratfordit, duhej t'u jepte fund mbledhjes dhe përpilimit të anektodave edhe nëpër botime. Alexander Pope më 1752 hapi rrugën e një botimi të veçantë duke nxjerrë në krye të botimit me thonjëza disa vargje ose disa skena nga më të bukurat e krijimtarisë së Shekspirit. Ky botim u ndoq nga botime të tjera të këtij lloji, si ai me përmbledhje të vërtetash universale në veprën shekspiriane, apo ai me shprehjet më të bukura të stilit, të moralit, apo botimi që jep një Shekspir filozof, moralist dhe poet, etj. Kjo jetë tekstore me pjesë të zgjedhura dëshmon veçanësinë absolute të gjenisë poetike të Shekspirit, të autoritetit të tij moral dhe të urtisë së tij filozofike.

Shekspiri dhe Europa

Teatri i Shekspirit ishte pararendës i idesë europiane, sepse trupa e tij qe e para që erdhi të luante në kontinent dhe kështu ky teatër mbase shqiptoi i pari idenë e një Europe të bashkuar në epokën moderne. Në vitin 1590 „bari ishte vërtet më i blertë për artistët që lanë Londrën për të ardhur në kontinent", shkruan Richard Wilson[1] në një artikull të botuar në revistën Europë,

1 Richard Wilson, Guerre et paix dans l'Europe d e Shakespeare (Revista Europe, 2022).

prill 2023. Duke shkuar nga qyteti në qytet aktorët shëtitës të Shekspirit qenë Europianët e parë. Në tragjeditë e tij flitet për „kështjella që mbrojnë Europën“ për „shkaqe lufte“ dhe për ushtri që ecin dhe hapin varre në „një copë toke“ të braktisur. Në tragjedinë *Hamleti*, dy fuqi udhëtojnë në drejtime të kundërta. Hamletit i bën përshtypje demonstrimi i forcave ushtarake dhe pas ikjes së ushtarëve, ai mendon pasojat, prandaj mendimet e tij „do të jenë të përgjakura“. Takimi mes Hamletit dhe një ushtrie profesionale që udhëton drejt Polonisë është një moment qendror, në të cilin tragjedia e Shekspirit takon historinë e kohës së vet. Pjesa dramatike qe shkruar për një publik anglez që kishte filluar ta quante veten „ne Europianët e tjerë“, siç shkruante Francis Bacon[2]. Nuk është e habitshme që dramat e Shekspirit dhe tragjedia *Hamleti* në veçanti, kanë ushtruar trysni artistike për të formësuar vetëdijen kolektive të Europës më tepër se çdo vepër tjetër. Në këtë kohë dhe më pas, rreth viteve 1600, sipas studimeve të historisë europiane, fjala Europë filloi të zëvendësonte fjalën „Krishtërim“ dhe u bë termi që do të bashkonte një kontinent të tërë.

Portreti që u bën Shekspiri aktorëve, sipas historianit Peter Burke, një historian britanik i kulturës europiane në epokën moderne, frymëzohet nga kultura dhe mendësia popullore ; aktorët në të vërtetë nuk i ndalte kufiri politik. Madje, duke menduar se gjeografia në një pjesë dramatike si *Hamleti* është e gjerë : Danimarkë, Norvegji, Poloni, Gjermani, Angli, Francë, kjo gjë krijon imazhin se „tërë bota luan teatër“.

Tema zotëruese e tragjedisë *Makbethi*, në të cilën shkruhet se „koha e paqes universale po vjen“, që e hasim edhe te *Antoni dhe Kleopatra,* e shpie këtë optimizëm gjitheuropian në apogje, shkruan Richard Willson. Nuk është rastësi që këto drama kanë mundur të përputhen me qëllimet mbikombëtare si ato të dukës Silly në Francë që ia kishte transmetuar planet Henrit IV në mbështetje të një Europe, në të cilën „njësitë e mëdha territoriale do të pajiseshin me institucione federale“, ose ato për projektin e krijimit të një tregu „të përbashkët të lirë, me të drejta dhe taksa“.

Në *Rrëfime dimri*, lulet e bathrës „magjepsin“ erërat e marsit me bukurinë e tyre. Një studiues i Rilindjes Europiane i vendos veprat e Shekspirit në qendër të lëvizjes që synonte të afronte poetët dhe muziktarët e besimeve fetare të ndryshme për t'i nxitur të mësonin këtë lloj bukurie si një estetikë e re e pajtimit dhe lëshimeve të ndërsjella. Te *Endërr e një nate vere,* flitet për artistë që luajnë „të qetësojnë shpirtrat e shikuesve“. Por nuk harrohet të pasqyrohet aty as marrëzia kolektive. Aktorët e Shekspirit përshkojnë Europën që paraqiste simptomat e një histerie kolektive pas shfaqjeve të armiqësisë kundrejt të huajve dhe intolerancës së saj përballë pakicave, siç ndodhi me ndjekjen e çifutëve apo me të ashtuquajturin gjah të magjistricave në qytetet ku zbarkuan aktorët londinezë. Ata ishin bartës të një kumti, sipas të cilit "heretik është ai që përgatit turrën e druve" (*Rrëfime dimri*). Kështu i shenjonin ata njerëzit që nuk kishin asnjë lloj respekti për idetë e kampit tjetër.

Hamleti bëhet tërheqës, sepse i jepte një besim pagan fatit dhe tregonte neveri përballë botës „së mërzitshme, të zbërdhulur, të dështuar e të shterpët“. Walter Benjamin shkruan : „Hamleti është i vetmi spektator i dramës […] ; megjithatë nuk është shfaqja e luajtur për të që e bën të shfrejë pasionin, por fati i tij dhe asgjë tjetër. Vetëm në këtë jetë prej princi, melankolia e tij mund të konsumohej duke gjetur vetveten. Pjesa tjetër është heshtje"[3]. Kritiku gjerman shton se ndërsa „Rilindja shqyrton botën, baroku shpëton bibliotekat“, ashtu si thotë Prospero i dramës *Stuhia*, mendimi i të cilit merr formën e një libri.



Më 1623, plot katërqind vjet më parë, filloi procesi i vërtetë që monumentalizon tekstet e Shekspirit dhe përjetëson dramaturgun, i cili kishte vdekur shtatë vjet më parë. Është fjala për të famshmen in folio, *e quajtur* "Folio e Parë" *(sepse u pasua nga të tjera). Dy aktorë, John Heminges dhe Henry Condell, që kishin luajtur në skenë me të, shpëtuan nga humbja e pakthyeshme dorëshkrimet e tetëmbëdhjetë pjesëve të shkruara me dorën e tij.*

Tragjedia *Hamleti* ishte në përputhje me idetë e teatrit shekspirian. Kur Poloni vrapon për të lajmëruar ardhjen e aktorëve, skena e hapur në gjysmëhije ndriçohet menjëherë dhe në çastin që kështjella mbushet me zhurma dhe ngjyra, me shkëlqim dhe kostume farfuritëse të aktorëve, „harrohen tradhtitë dhe shpërdorimet ; në të vërtetë Hamleti i pret aktorët si „kronikanë të kohës“ si përhapës të kumteve të reja. Më 1626, teksa trupat ushtarake të Danimarkës marshonin drejt një beteje të përgjakshme në rrethinat e Hamburgut, u takuan rastësisht me trupën e aktorëve dhe ushtarët, si të thuash, u çarmatosën në sajë të asaj dhune simbolike që panë në skenë.

Në tragjedinë *Makbethi* dëgjohet klithma e habisë së Malkolmit përballë mënyrës së Reformimit, nga i cili vendi i tij „qan dhe pikon gjak“. Kjo temë shtjellohet gjerësisht në komedinë *Shumë zhurmë për asgjë,* kur autori përshkruan një natë paranojake, thuajse të çmendur, sepse vihet në gjendje arresti një individ që nuk ishte Reformuar sa duhej ; është koha e reformave fetare. Kjo komedi ngjitej në skenë krahas tragjedisë *Romeo dhe Zhuljeta,* në të cilën mallkohen ngjyrat politike që përçajnë : „Rëntë murtaja mbi të dyja shtëpitë tuaja“. Në *Rrëfime dimri*, ai e pajisi Boheminë me një vijë detare imagjinare, por ka dhënë edhe një ndryshor romanesk të mbretërisë çeke, sepse krijohet një vend ku gjendet zgjidhja për krizën europiane. Në pjesën *Komedia e gabimeve*, Shekspiri u drejtohet bashkëkohësve europianë : „Ne kemi ardhur në botë si vëllezërit me vëllezër. Tashmë, le të ecim përpara dorë për dorë“.

Në të vërtetë trupa *Globus* e Shekspirit po e fitonte luftën kulturore dhe eksportonte në kontinent modelin e një teatri me të gjitha shijet, në të cilin përfaqësoheshin të gjitha shtresat e shoqërisë. Në tragjedinë *Hamleti* dhe në të tjera jepej modeli i një fryme të re, një dritë që shpërndahej përpara se të vinte Shekulli i Dritave. Aty shihej se çfarë do të ishte arti i nesërm që do të lejonte të farkëtohej një bashkësi e re në Europë. Filozofi Jurgen Habermas e quan teatrin *Globus* „sferën e parë publike të Europës“. Atje, pranë e pranë, kurtizanët dhe tregtarët, shërbëtorët e thjeshtë, ushtarët, çirakët e punësuar, po ashtu si proletariati fare i varfër, ishin gati të bëheshin të pranishëm në shfaqje dhe kishin mundësi „të mbronin „urtësinë e tyre të thjeshtë dhe zgjedhjen e tyre“, ashtu si qahet hidhur Koriolani te drama me të njëjtin titull.

Disa muaj pas vdekjes së Shekspirit, trupa që drejtohej nga John Green-i dha shfaqje në Dantzig dhe tregoi se ajo donte të vazhdonte konceptin shekspirian, sepse aty shihej sesi çdokush gjente zërin e vet në gjuhë dhe në zakone të ndryshme ; dramat e tij ishin një pasqyrë e kthjellët e jetëve njerëzore. Teatri i Shekspirit përuroi një vështrim të ri që hulumton brenda njeriut dhe jep botën e tij të brendshme.

Shekspiri bëhet shumëgjuhësh dhe e ndërkombëtarizon dramën e tij si te *Troiloi dhe Kresida,* në të cilën jepet një përzierje krijuese „e marrëzisë dhe filozofisë“. Ka një lloj dije skenike të Shekspirit autor dhe aktor siç e vënë në dukje edhe Walter Benjamin-i, edhe Bertolt Breht-i në studimet e tyre për dramën shekspiriane.

Ligjërimi simbolik

Në veprën e Shekspirit gjejnë vend thuajse të gjitha temat e jetës së njeriut në familje, në jetën shoqërore politike dhe kulturore, si dhe roli i shkencës dhe funksionet e saj në gjithësi. Shumë studime tregojnë ndikimin që kanë ushtruar në imagjinatën e Shekspirit përmbledhjet me thënie dhe përfundime universale që duken sidomos te dramat *Perikliu, Titus Andronikusi, Troiloi dhe Kresida...* Ligjërimi simbolik futet në teksturën dramatike, sepse në kulturën e shekullit XVI imazhi përmban një pushtet edukues të fuqishëm dhe mund të pranohet që Shekspiri të ketë qenë i ndjeshëm dhe të ketë nxjerrë nga dokumentet, referime krejtësisht të njohura prej shikuesve. Bie fjala, shprehjet simbolike: "*Ex bello pax"* (Pas luftës vjen paqja); "*Amicitia etiam post mortem durans*" (Miqësia është me e fortë se vdekja) etj., i japin ligjërimit trajta universale. Ligjërimi i Henri V para ushtarëve paqyron një rrymë mendimi që lidhet me organizimin e rendit shoqëror dhe të krejt shoqërisë me një lloj mirëkuptimi qytetar. "Pa hierarki shoqërore" pushteti zhbëhet dhe prandaj duhet që të riafirmohet me fuqinë e fjalës ose me detyrime "fizike".

Shekspiri është një shkrimtar i gjithanshëm, mjeshtër i monologut: "Të rrosh a mos të rrosh » (Hamleti) ; "Miq, romakë, bashkëqytetarë » (Jul Cezari), monologu i Zhuljetës, monologu i Makbethit, i mbretëreshës Margaritë; mjeshtër i maksimave ; mjeshtër i shprehjes poetike : Hamleti e quan Ofelinë « trëndafil e shpresë » ; mjeshtër i epigrameve ; njohës i këngëve popullore angleze të rralla, si kënga e Desdemonës, apo kënga e Ofelisë etj. Në të vërtetë disa pjesë të tij dramatike të shtypura filluan të qarkullonin në Angli qysh më 1594. Në shekullin XVI kritiku nuk ekzistonte. Lexuesit dhe shikuesit e dramave të tij i kanë shprehur mendimet e tyre në dorëshkrime trajtesash të ndryshme dhe në ditare. Mendimet e tyre janë vetjake, por disa lexues kanë luajtur një rol publik vendimtar në ruajtjen e emrit dhe veprës së Shekspirit. Në British Library ruhet një dorëshkrim autentik i një lexuesi me mbiemrin Scott, student në fakultetin e Drejtësisë që pasi kishte lexuar

2 Francis Bacon (1561-1626) - Shkencëtar, filozof dhe burrë shteti anglez.

3 Walter Benjamin, Origine du drame baroque allemand (Origjina e dramës baroke gjermane), f. 169.

poemën narrative *Rrëmbimi i Lukrecias* dhe dramën *Rikardi II,* shkruan se ”a*jo që është mbresëlënëse dhe shumë e çmuar te autori”*, është se ”*ajo që ka shkruar, është dhënë me një stil që është i kuptueshëm dhe të magjeps*”. Shekspiri është një autor, vërtet shkrimtar që sipas tij ” ka shkruar për lexuesin, për intelektin e lexuesit”. Ai çmon shumë tragjedinë *Otello,* sepse *”autori ka arritur një nivel të lartë rrëfimi dhe cilësi letrare të veçanta*”; në fund të shënimeve përdor terminologji kritike*: ”një pjesë dramatike e shkëlqyer, si për tekstin edhe për intrigën dhe sidomos për intrigën”.*

Periudha e viteve 1608-1612, është koha kur shkruhen pjesët më të qeta, edhe pse personazhet janë pikturuar me po aq forcë, si në tragjeditë e mëdha. Por ka edhe vepra të kësaj kohe që përshkohen nga kriza shpirtërore të fuqishme si te *Antoni dhe Kleopatra*, ku vdekja e dashnorëve të pavdekshëm jepet me një bukuri të rrallë. Te *Henry VIII* dhe sidomos te *Stuhia* apo *Rrëfime dimri*, duket sikur dëgjohet lamtumira e Shekspirit ndaj poezisë dhe jetës. Më vonë në tragjeditë pesimiste deri në dëshpërim si *Jul Qesari, Hamleti, Othello, Mbreti Lir, Makbethi*, pasqyrohen dhimbjet e shekullit shekspirian dhe filozofia e trishtuar e jetës, që përftojnë trajta universale.

Sonetet

Ato janë pasqyrimi i shpirtit të poetit. Wordsworth-i, poet romantik, thoshte se ai ka hapur zemrën e tij me çelësin e soneteve. Disa pasazhe kanë një sinqeritet të madh. Poeti dashuron me një dashuri që ngushëllon nga të gjitha vuajtjet, një dashuri më e fortë se vdekja. Aty gjejmë gjithashtu atë ngushëllim sipëror, sigurinë që vargjet e tij do të mbeten të pavdekshme, edhe kur ai vetë do të jetë shndërruar në pluhur. Vitet 1600-1608 janë nga më trishtuarat e tij dhe mbase më tragjiket që e shohim në sonete. Edhe komeditë që ai i quan romaneske janë me subjekte të trishtuara; *Troiloi dhe Kresida* janë aq të pasigurt, të pavendosur në tonet e zërave të tyre sa lënë një përshtypje të ndërlikuar, më shmë melankolike dhe zhgënjyese sesa gazmore.

Shekspiri në sytë e mendimtarëve dhe artistëve të mëdhenj

Dekarti e pa Shekspirin të luhej në skenë gjatë qëndrimit në Londër më 1649 dhe qe mahnitur aq shumë, sa parafytyroi themelet e një shkence të pakrahasueshme. Kurse filozofi gjerman Herder, sa herë që shihte një pjesë të Shekspirit në skenë, thoshte se „aktorët dhe dekori qenë sjellë nga stuhia e historisë“. Kompozitori Hektor Berlioz pohoi se tragjedia *Hamleti*, e luajtur në Odeon më 11 shtator 1827 ishte një moment vendimtar në jetën e tij. “Shekspri më ra papritur, si rrufe“ - shkruan ai. Bodleri e quajti Shekspirin „socialist“. Marksi e ka pasur në mendje veprën e tij ; kjo gjë u duk sidomos në librin për Lui Bonapartin, në të cilin ai thotë se historia është dramë. Te *Jul Qesari*, dy personazhe, Kasiusi dhe Bruti pyesin veten se „edhe sa shekuj / Do ta mbajmë dramën tonë në skenë ? “...

Sigurisht, bashkëkohësit e Shekspirit u drejtoheshin shpesh simboleve të dramave të tij për të maskuar luftën e tyre. Dramaturgu thoshte se lloji më i mirë i kumteve janë iluzionet, e megjithatë ”të këqijat nuk janë të këqija, nëse imagjinata i korrigjon” (*Endërr e një nate vere*). Te drama *Timoni nga Athina* autori përmend të gjitha „mendjet e ndritura”, prandaj Paul Valery shkruante më 1919 se Hamleti europian „sheh miliona spektra“. Për Jane Austen, Shekspiri mishëron atë që është më kryesore te një anglez.

Referimet nga vepra e tij

Ato janë të shumta dhe lista do të ishte e gjatë po të shënoheshin të gjithë librat dhe filmat apo edhe forma të tjera artistike që ka ushqyer vepra e Shekspirit, por ajo shtrihet gjer edhe në dokumente të tilla, si bie fjala, ai që jep gjenealogjinë e Bashkimit europian, i titulluar *“Conquering Peace: From the Enlightenment to the European Union”,* botuar në Harvard University Press, 2021. Historiania Stella Ghervas që e ka formuluar, e merr titullin dhe epigrafin nga pjesa e dytë e *Henri IV* : „Paqja ka të njëjtën natyrë si fitorja / Sepse të dyja fuqitë u nënshtrohen rregullave me fisnikëri / Dhe asnjëra nuk është humbëse (*Henri IV*).

Historia e Europës që nga Traktati i Vestfalisë më 1648 që i dha fund Luftës së Tridhjetë vjetëve me një “pushim zjarri” praktik, është interpretuar me një retorikë pozitive nga kryemurgu shën Pierre-i, i cili botoi më 1713 një projekt për paqe të përhershme. Immanuel Kant-i botoi më 1795 studimin *„Drejt paqes së përhershme“,* duke pasur parasysh Europën dhe njerëzimin mbarë. Volteri atëherë shprehu mosbesimin e vet ndaj projektit të Shën Pierre-it dhe shkroi se ky ishte „një iluzion që do të mbijetonte mes princëve, po aq sa mund të mbijetojë paqja mes elefantëve dhe rinocerontëve, mes ujqve dhe qenve“.

Pastaj erdhën luftërat e pjesshme, Lufta e Parë dhe e Dytë botërore, Operacioni *Barbarossa* i tmerrshëm i Hitlerit më 22 qershor 1941... Ato treguan qartë se çfarë ishin themelet ideologjike të Europës. Por Shekspiri me dramat e tij lajmëronte paqe : „Lajmërojmë këtë paqe / Për të gjithë / Dhe të ecim / Në atë mënyrë që / Flamujtë romakë dhe bretonë të valëviten pranë e pranë si provë miqësie“. Ai vazhdon ta japë këtë kumt përjetësisht.

Shekspiri dhe figura e gruas

Nisur nga fakti se aktoret profesioniste dolën në skenë pas restaurimit të monarkisë më 1660, Shekspiri nuk krijoi role femërore vetëm në kuptimin klasik të fjalës, por një larmi rolesh, çka sipas një studimi e nxjerr në krye të epokës si një autor avangardë. Mjeti kryesor që kishte në dorë për ta paraqitur gruan në skenë, ishte imitimi që realizohej nga *boy aktress*, djalë i ri që nuk i ka ndryshuar ende timbri i zërit. Kështu ndodh në pjesët *Nata e Mbretërve* ; *Si t'ju pëlqejë* dhe *Tregtari i Venedikut.* Po kjo gjë mund të thuhet edhe për role të tjera si Kordelia (*Mbreti Lir)*, apo Ledi Makbeth (*Makbethi*), mbretëresha Margaritë (*Rikardi III*). Kishte edhe një mjet tjetër, shumë të rëndësishëm që e mësoi gjatë studimeve të nivelit të dytë për teatër në Stratford : përshkrimi i hollësishëm dhe dramatik i disa figurave të famshme në histori dhe në mitologji, si : Hekuba, Gertruda, Ofelia e të tjera. Te poema e gjatë ”*Rrëmbimi i Lukrecias”*, Hekuba shfaqet e rrënuar nga dhimbja. Ai e jep Hekubën edhe përmes një ankthi që shtohet te ajo së bashku me procesin e plakjes. Shkolla elizabetiane i ka mësuar aktorët e rinj të vendosen në planin retorik brenda situatës së vuajtjes së dikujt. Kjo lloj shkolle nistore për karakterizimin e gruas ka të bëjë edhe me formësimin e Shekspirit që shkonte më larg se përshkrimi i personazheve e i ngjarjeve dhe i kërkonte oratorit (aktorit) që t'u jepte jetë skenave. Kur qan Hekuba, në skenë duket një figurë e kërrusur nga një dëshpërim i lemerishëm. Ajo ka sjellë në jetë me Priamin shumë fëmijë dhe paraqitet si një figurë amnore e rraskapitur ; duke parë trupin e tij të copëtuar ajo është tronditur thellë. Hekuba e Shekspirit është si figurat e Rilindjes, mishërim i dhimbjes.

Hamleti i drejtohet një aktori që luan një rol femëror “Zonja ime e re”. Pra, imitimi i rolit femëror në skenë është strukturor dhe Shekspiri e ka përvetësuar këtë teknikë në shkollën e Stratfordit. Aty ai mësoi të deklamonte poemat epistolare të Ovidit, letra dashurie „të shkruara“ prej heroinave mitologjike ose legjendare, shumica e të cilave kishin përjetuar dashuri të humbur, ishin braktisur ose tradhtuar.

Fakti, që këto strategji të përshkrimit dhe të imitimit të grave të dëshpëruara, kanë qenë praktikë retorike e disiplinës mësimore të Rilindjes, sigurisht nuk e transformoi me magji Anglinë në modernitetin e parë, në një shoqëri, e cila luftoi qysh në krye të herës për barazinë gjinore. Vetëm një vend me kulturë të vërtetë kërkonte t'u mësonte nxënësve të shpalosnin formimin gjuhësor të përshtatshëm për të gjitha rastet që mund të paraqiteshin. Prodhimi i empatisë është një efekt i dorës së dytë në këto praktika, por nuk ishte detyra e tyre kryesore. Nëse dramaturgu nuk kishte rrugë tjetër përsa u përket imitimit të roleve femërore në skenë, sepse pa to nuk mund të ekzistonte vetë drama, përshkrimet e feminitetit *in extremis* nuk ishin të detyrueshme dhe i liheshin atij në dorë. Futja e tyre nga Shekspiri është, pra, zbulim. Rimartesa e ish-mbretëreshës Gertrudë, pak kohë pas vdekjes së mbretit, bën që të shpërthejë misozhinia e Hamletit. Martesa e saj është enigma e pjesës. Teksti nuk thotë gjë në e ka kryer ajo shkeljen e kurorës (adylterin) më parë, ose është apo jo në dijeni të vrasjes së mbretit, të atit të Hamletit dhe bashkëshortit të saj nga Klaudi, bashkëshortit të ri. Kësisoj ne kemi liri të madhe për interpretimin e personazhit, një liri që vërteton dhe e miraton modernitetin ; gratë e veja në veprën e Shekspirit rimartohen. Kjo është gjë e re, sepse sipas zakoneve mesjetare një grua e ve nuk rimartohej dhe kështu quhej grua e virtytshme. Nëse publiku nuk di si ta quajë gjestin e saj, ka një pikë të rëndësishme që e tregon të virtytshme kur shpreh dhembshuri për Ofelinë dhe nga fundi i dramës ne e marrim vesh se ajo do të kishte dëshiruar ta kishte Ofelinë nuse për djalin. Ajo thotë se kishte dëshiruar t'ia ”stoliste shtratin e martesës me lule, jo t'i mbulonte me to varrin”. Kurse i ati i Hamletit ka mbajtur qëndrim të ashpër ndaj lidhjes së të birit dhe është në antitezë me Gertrudën. Ajo uronte që ”urtia e bukur e Ofelisë” të ishte ”shkak i lumtur i zbutjes së Hamletit”. Kështu ajo donte që virtytet e Ofelisë ta vinin ”në rrugë të mbarë Hamletin. Për nderin e të dyve”. Fjalët e Gertrudës janë pjesa më lirike e tragjedisë, me gjithë strukturën patriarkale të shoqërisë së kohës së Shekspirit.

Shekspiri dhe mjedisi

“Do të doja që fytyra ime të ishte kopsht i lulëzuar / I njomur nga vesa... - thotë Venera e dashuruar marrëzisht pas Adonisit, te pjesa *Venera dhe Adonisi.* Shekspiri ndjek









këtu traditën e *Kënga e Këngëve*, në të cilin trupi i gruas jepet si një kopsht. Në të vërtetë kanë folur shumë për rëndësinë që i jep Shekspiri botës bimore në veprën e tij. Kritiku kanadez Northrop Frye përshkruan një lloj *locus amoenus* (vend kënaqësish) që karakterizon natyrën e komedive të Shekspirit. Sigurisht do të ishte e tepërt të mendonim se bashkëkohësit e Shekspirit ishin ithtarë të një lloj kulti për jetën e egër, përkundrazi, natyra atyre u duket pjellore dhe mbrojtëse kur është e punuar. Bujqësia shërben në fakt si një urë midis natyrës dhe kulturës. Sidoqoftë pylli shfaqet në shumë vepra të tij. Hermia dhe Lisandri të humbur në pyllin athinas (Ëndërr e një nate vere), përgatiten të flenë poshtë një peme. Te tragjedia *Makbethi*, që mendohet si vepra e fundit e dramaturgut, drurët kanë një përmasë të fuqishme simbolike. Makbethit i duket sikur pylli lëviz. Studimet astronomike të kohës u krijojnë mundësi bashkohësve të ditur të Shekspirit të kalojnë nga vizioni i kozmosit sipas Pitagorës në perceptimin kopernikian të tij dhe prandaj ata janë të aftë të lexojnë edhe lëvizjen e yjve si te *Jul Cezari.*

Shekspiri dhe feja

Shekspiri dhe bashkëkohësit e tij ishin mbrujtur me besim fetar, me ligjërime për krishtërimin, por duke lexuar veprën e tij, mund të thuash se dramaturgu ka treguar një aftësi të veçantë duke larguar dyshimet që mund ta çonin në burg ose ta ekzekutonin. Kur lexon veprat e tij mendon se ato janë profane, si të ishin shkruar pas periudhës së iluminizmit. Megjithatë Stephen Greenblatt, profesor i Humanizmit në Universitetin e Harvardit, që ka shkruar shumë edhe për Shekspirin, thotë se aluzionet fetare janë të pranishme nëpër dramat dhe komeditë e tij. Dramaturgu e prek në mënyrë elegante problemin e purgatorit duke qendruar midis profanizmit dhe fesë.

Shekspiri te ndonjë personazh i tij përkthen ndjesinë se përvoja njerëzore është më e ndërlikuar sesa duket. Sidoqë çdo njeri i asaj kohe e ka formuar imagjinatën e vet nga lidhje të forta me fenë, Shekspiri ka mundur të krijojë një hapësirë mbrojtëse mes fesë dhe veprës së vet**.** Veprat e Shekspirit në shekujt XVII, XVIII dhe XIX patën përhapje progresive, kurse në shekullin XX me hovin e teknikës ato nisën edhe udhëtimin drejt kinemasë dhe pikturës; në fillim të shekullit XX u realizuan regjistrimet e pjesëve kryesore për teatër dhe pastaj filloi përshtatja për film që nuk iu nda ekraneve. Sot numërohen rreth 1500 filma anekënd botës që mbështeten mbi subjektin e veprës së tij.

Shekspiri dhe Shqipëria

Në gjuhën shqipe qe i pari Fan S. Noli që shqipëroi Shekspirin. Në një artikull të vitit 1906, ai e quan mendjen e tij "të egër, të marrë, pa rregull, por të bukur si natyra". Ai e solli Shekspirin në shqip fillimisht me : *Otello,* pastaj pas dhjetë vjetësh solli njëra pas tjetrës *Hamleti, Jul Cezari* dhe *Makbethi*. Madje Konica pati hedhur idenë që t'i ndanin së bashku pjesët e Shekspirit për t'i përkthyer në shqip. "Ai pati vetëm një rezervë, që "Romeo e Zhuljeta" t'i jepej atij. Pranova menjëherë, me kusht që "Hamletin" ta merrja unë. Kështu filluam të dy"[4]. Noli me përkthimet e tij tregoi edhe pasurinë e gjuhës shqipe, edhe poezinë e shprehjes, edhe magjinë e fjalës. Noli i ka pajisur përkthimet me *Introdukte* (parathënie në formë eseje), në të cilat vë në dukje vlerat universale të veprës shekspiriane. Më 1964, duke iu përgjigjur thirrjes së Komitetit Kombëtar Anglez, drejtuar gjithë shekspirologëve të botës, për të dërguar nga një kopje të veprave të përkthyera të Shekspirit, shoqëruar edhe me kujtime sesi u « njohën » me dramaturgun e madh, përveç veprave të përkthyera, Noli dërgoi edhe dy shkrime në formë eseje: "*Shekspiri*" dhe "*Shekspiri dhe unë*", të cilat u botuan në revistën londineze "*The listener*", më 15 tetor dhe më 5 dhjetor 1964. Në esenë e parë ai nuk flet për madhështinë e Shekspirit si aspekt tepër i njohur i gjenialitetit të tij, por si duhet lexuar Shekspiri, që të kuptohen vlerat e tij. Në esenë e dytë, pasi tregon « njohjen » me Shekspirin kur ishte 15 vjeç, sepse u mësoi dy aktoreve analfabete në Athinë të lexonin tragjedinë *Hamleti* dhe si pagesë do të merrte bileta falas; si u bë *sufler* në tragjedinë *Otello* dhe si e uli perden kur dëgjoi « Desdemonën » të thërriste, se i shoqi që luante Otellon, për ta bërë sa më të gjallë lojën, gati sa s'po e mbyste; si u bë pastaj kopist në teatër; si luajti Hamletin, se aktori ishte sëmurë (sëmurë nga të pangrënët), etj. Kur erdhi në SHBA më 1906, takoi përsëri « mikun » e dikurshëm, në teatrin "Castle Square"; por këtë herë e pa Shekspirin në skenë anglisht. Në fund të esesë së dytë ai shkruan: « [...] unë e kam braktisur mikun tim të vjetër, Shekspirin këta 38 vjetët e fundit, për arsye të ndryshme, një nga të cilat ka qenë edhe Lufta e Dytë Botërore. Kam shpresë t'i kthehem përsëri duke dhënë disa kryevepra të tjera në shqip. Unë mund ta bëj këtë. Jam ende i ri. Jam vetëm 82 vjeç ». Por Noli nuk e realizoi dot këtë ëndërr të mbrame, sepse vdiq pas disa muajsh. Akademia Angleze e Shekspirit e ka përfshirë emrin dhe përkthimet e tij në Bibliografinë e saj shkencore. Botuesit, përkthyesit dhe regjizorët e veprës shekspiriane janë përballur dhe përballen përherë në punën e tyre me një vepër kanonike, universale e të papërsëritshme që ka përshkuar shekujt e shpërndarë nëpër tekste të shumëfishta. Shekspiri vazhdoi të bëhej i njohur në Shqipëri me pjesë të tjera dramatike në sajë të shqipërimeve të tjera të Skënder Luarasit, si vazhdues i shkollës noliane të përkthimit që i ka botuar Onufri në një kolanë me rastin e 450-vjetorit të lindjes së Shekspirit. Kolana që është një botim i përsosur, i përshtatshëm për veprën e klasikëve të letërsisë botërore përfshin: *Mbreti Lir*; *Rikardi II*; *Rikardi III*; *Tregtari i Venedikut*; *Komedia e keqkuptimeve*; *Si ta doni*". Vijnë pastaj Vedat Kokona, Alqi Kristo e të tjerë që e kanë pasuruar repertorin e veprës së përkthyer në shqip të tij me vepra si : *Gratë gazmore të Uindsorit; Shumë zhurmë për asgjë; Nata e dymbëdhjetë; Romeo e Zhuljeta; Mundimet e kota të dashurisë; Antoni dhe Kleopatra, Përralla dimri, Stuhia ....*

Vepra e Shekspirit fitoi jetën e vërtetë në skenën e Teatrit Popullor kur më 21 mars 1953 u shfaq *Otello*; më 1959, *Gratë gazmore të Uindsorit*; më 1960, *Hamleti*; më 1965, *Mbreti Lir*; më 1962, *Nata e dymbëdhjetë*, me aktorët e shquar duke filluar nga Pjetër Gjoka e Sandër Prosi e duke vazhduar me një plejadë aktoresh dhe aktorësh sipas brezave : Violeta Manushi, Drita Pelinku, Ahmet Pasha, Robert Ndrenika, Roza Anagnosti, Ndriçim Xhepa, Yllka Mujo e të tjerë të shquar, me regjisorë si: Besim Levonja, Pandi Stillu, Kujtim Spahivogli, Piro Mani dhe shumë të tjerë aktorë, kompozitorë, skenografë, kostumografë...

Burimet: *Europe,* 1964, 2023, Fondet / *William Shakespeare* në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë dhe në Bibliotekën Kombëtare, Paris.

4 Fan S. Noli, Shekspiri dhe unë.

Takim me Viktor Eftimiun në kampin e të burgosurve politikë të Tërgu- Zhiut

Nga Kiril Ekonomu

Përktheu nga gjuha rumune Pandi Bello

Ngarkuar me dy çanta të mëdha plot me "delikatesa" të blera nga Axhepsina Makri-Eftimiu në dyqanin shumë të njohur të ushqimeve dhe pijeve "Extra" të Dragomir Nikuleskut, që ndodhej në rrugën Viktoria, zura vend në vagonin e një treni me destinacion Tërgu-Zhiun.

Axhepsina Makri m'u lut t'i dërgoj pak ushqim të ftohtë Viktor Eftimiut në kampin e njohur të të burgosurve politikë,i cili ndodhej diku në periferi të qytetit gorzhean,në luginën e Zhiut.

Me të arritur në stacionin e trenit,hipa në një karrocë dhe i kërkova personit që tërhiqte kuajt të më shpjerë deri në kamp.Karrocieri nuk u befasua aspak,gjë që më bëri të kuptoj se këtë rrugë e bënte në mënyrë të natyrshme. Ishte udhëtimi i parë që bëja drejt këtij kampi (pas tij kam bërë dhe të tjerë) dhe provoja një ndjenjë të vagullt frike.

Atje u ndala para një porte të madhe metalike, të rrethuar nga disa roje të armatosur mirë me pushkë mitraliere.

-Zotëria juaj? – më pyeti me një ton të ftohtë njëri nga rojet.

-Kam ardhur me një porosi për kushëririn tim,Viktor Eftimiu, i cili është i burgosur politik këtu në kamp.

-Prisni!

Dhe u nis për diku. Erdhi pas pak,i shoqëruar nga një oficer.

-Keni ardhur për "maestro" Viktor Eftimiun? – më pyeti ky me një manierë plot mirësjellje, e cila më befasoi.

Pas një hetimi të shkurtër dhe shumë të qytetëruar, pasi tregova dokumentin e identitetit, urdhëroi një prej rojeve të mbajë çantat dhe të tre u drejtuam për tek zyra e zotit kolonel Leovesnu, komandanti i kampit.

Ky na priti me shumë përzemërsi.Ishte një figurë plot finesë,simpatike, komunikative, me një fjalë,të themi, një oficer elitar.

Urdhëroi oficerin "për të ftuar" tek ai maestro Viktor Eftimiun.

-Ta dini se këtu mjeshtri ndihet shumë mirë. Nuk jeton në qeli, por në një garsonierë. Ashtu si dhe mjeshtri Argezi, si zoti Ralea dhe si Zaharia Stanku. Të gjithë bëjnë pjesë në ajkën e spiritualitetit rumun. Zotëria juaj? – m'u drejtua direkt.

-Jam një aktor shumë i ri i Teatrit Kombëtar bukureshtean.

-Ju uroj sa më shumë suksese në karrierë dhe shpresoj të rishihemi një ditë.

Gjithçka më dukej aq e jashtëzakonshme dhe e pabesueshme sa që fillova të shqetësohem. Mos vallë koloneli po më ngre ndonjë kurth? Në të vërtetë ndodhesha para një komandanti të një kampi fashist,

Por dera e kabinetit u hap menjëherë dhe brenda hyri me vrull Viktor Eftimiu, i veshur me pallto, me një shall të pasur astrahani dhe një kapele të madhe në kokë. Në dorë mbante një taskë duhani, asimetrike, prej tunxhi, të cilën ma zgjati duke thënë : "Të shkosh dhe ti me një kujtim. Eshtë punuar nga ....."komunistët" e tu. (E ruaj edhe sot taskën).

Më përqafoi, ndërsa unë mbeta i çoroditur, pastaj Eftimiu u drejtua nga komandanti duke shtërnguar miqësisht duart dhe hodhi drejt kolonelit një bombë të vërtetë :

- O koloneli im, nuk më durohet të marr vesh çfarë ka thënë ... Londra këtë natë.

Komandantin e shqetësuar dukshëm, për shkak se ndodhesha unë atje, Eftimiu e qetësoi menjëherë: "Mos keni frikë, koloneli im, është kushëriri im dhe kur të mbarojë maskarada, e futim edhe këtë (domethënë mua) në llozhë. (Domethënë në një llozhë masonike)".

I qetë, koloneli i bëri të njohur gjithë çfarë kishte dëgjuar në Radio Londra.Ishin vetëm lajme të mira, inkurajuese.

-Bravo! - thirri Eftimiu. - Në këto çanta duhet të ketë gjëra të mira. Dhe për të ngrënë dhe për të pirë. Je i ftuari im për drekë. Do të ftoj edhe Ralean dhe Stankun dhe Argezin dhe të festojmë për lajmet e mira.

"Të bësh qejf në burg. o Zot" – thashë me vete duke dalë si plumb nga kampi.

BASHKIM HOXHA

VITO

OnufriRoman